



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP),

Në mbështetje të neneve 9 dhe 15.2.1 të Ligjit të AKP-së,

Në mbështetje të Shtojcës së Ligjit të AKP-së,

Miraton:

RREGULLORE NR. 08/2023 PËR POLITIKAT DHE PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

28 shtator 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	v
Neni 1 HYRJE.....	1
1.1. Qëllimi	1
1.2. Roli i Agjencisë	2
1.3. Baza ligjore për likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore	2
1.4. Kompetencat e Agjencisë mbi Ndërmarrjet Shoqërore	3
1.5. Kompetencat e Agjencisë për të likuiduar Ndërmarrjet Shoqërore	4
1.6. Kompetencat e AL-së	5
1.7. Përgjegjësia personale e anëtarëve të AL-së.....	5
Neni 2 FILLIMI I PROCESIT TE LIKUIDIMIT.....	6
2.1. Përzgjedhja e NSH-së për likuidim	6
2.2. Dokumentet informuese për Bordin e Drejtorëve.....	6
2.3. Fillimi i likuidimit.....	6
Neni 3 AUTORITETI I LIKUIDIMIT	7
3.1. Roli i AL-së	7
3.2. Emërimi i AL-së	7
3.3. Përbërja e AL-së	7
3.3.1. Ofruesit e Shërbimeve Profesionale (OSHP)	8
3.3.2. Anëtarët e stafit të Agjencisë pranë AL-së	9
3.4. AL-të i NSH-ve të cilat nuk kanë asete apo nuk kanë kërkesa kreditore	9
3.5. Roli i anëtarëve të AL-së	9
3.5.1. Roli i Kryesuesi të AL-së	9
3.5.2. Roli i Anëtarëve tjerë të AL-së.....	10
3.5.3. Roli i Zyrtarit i Rastit/lëndës	10
3.6. Detyrat e drejtpërdrejta të Autoritetit të Likuidimit pas emërimit.....	11
3.6.1. Krijimi i Arkivit të Likuidimit.....	11
3.6.2. Dosja standarde e arkivit të likuidimit.....	11
3.6.3. Krijimi i Arkivit të rastit/lëndës në Sistemin e Menaxhimit të Likuidimit.....	13
3.6.4. Shqetësimet lidhur me statusin e pronësisë apo aksionet në një NSH-je	13
3.6.5. Buxheti i likuidimit.....	13
3.7. Konfliktet e interesave	14
3.8. Datat e rëndësishme në procedurën e rasteve të likuidimit	14
3.9. Llogaridhënia dhe përgjegjësia e AL-së dhe anëtarëve të AL-së	15
3.10. Të drejtat dhe kompetencat e AL-së.....	15
3.10.1. Drejton ish-menaxhmentin e NSH-së	15
3.10.2. Klasifikimi dhe kërkimi i borxheve ndaj NSH-së	16
3.10.3. Kufizimet në transferimin e pronës	16
3.10.4. Heqja dorë nga pronat.....	16
3.10.5. Të inicioj dhe mbroj në procedurë ligjore në emër të NSH-së	17
3.10.6. Të pezulloj procedurat ligjore kundër NSH-ve	17
3.10.7. Anulimi i transaksioneve dhe anulimi i transfereve të pronës dhe aseteve	17
3.11. Emërimi i ekspertëve për të ndihmuar NSH-të në likuidim	18

3.12.	Sigurimi i NSH-së apo aseteve të saj.....	18
3.13.	Përgjegjësitë dhe obligimet e AL-së.....	18
3.13.1.	Asetet e NSH-së.....	19
3.13.2.	Inventari i aseteve dhe kërkesave kreditore.....	19
3.13.3.	Përgatitja e Raportit për Rezultatit e Parashikuar.....	19
3.13.4.	Inspektimi publik i inventarit të aseteve dhe diagrami i borxheve.....	20
3.13.5.	Shitja e aseteve me likuidim.....	20
3.14.	Udhëzimet nga DHPGJS.....	20
Neni 4	SISTEMI PËR MENAXHIMIN E LIKUIDIMIT.....	21
4.1.	Arkivi i likuidimit.....	21
4.2.	Regjistri i kërkesave kreditore.....	21
4.3.	Dokumentet standarde - formularët e likuidimit.....	21
4.4.	Sistemi i Menaxhimit të Likuidimit.....	21
4.5.	Të dhënat e Autoritetit të Likuidimit.....	21
Neni 5	NJOFTIMET PAS FILLIMIT TË LIKUIDIMIT.....	22
5.1.	Kërkesa e njoftimit në përgjithësi.....	22
5.2.	Njoftimi publik për likuidimin sipas Shtojcës së Ligjit.....	22
5.3.	Njoftimi publik për likuidimin sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme.....	23
5.4.	Njoftim për kreditorët e njohur.....	24
5.5.	Njoftimet për teprice teknologjike tek menaxhmenti dhe punëtorët e NSH-së.....	25
5.6.	Njoftimet për institucionet publike.....	25
5.7.	Njoftimi për bankat.....	25
5.8.	Njoftimi për pezullim të veprimeve kundër Ndërmarrjes në likuidim.....	26
5.9.	Njoftimi për pezullim të veprimeve të Përmbaruesve kundër NSH-së në likuidim.....	27
5.10.	Veprimet e Agjencisë pas dijenisë për Urdhërat Përmbarimor.....	28
Neni 6	MBLEDHJET E KREDITORËVE DHE KOMITETET E KREDITORËVE.....	29
Neni 7	ÇËSHTJE OPERACIONALE TË LIKUIDIMIT.....	30
7.1.	Sigurimi i librave dhe dosjeve.....	30
7.2.	Llogaria bankare e likuidimit në BQK.....	30
7.3.	Vijueshmëria e aktiviteteve afariste.....	31
7.4.	Pranimi ose refuzimi për vazhdimin e kontratave.....	31
7.5.	Paradhënie e parave të imëta.....	32
7.6.	Menaxhimi i të hyrave ditore dhe të aktiviteteve me arkëtimet me para në dorë.....	32
7.7.	Njoftimi për likuidim të të gjitha palët e treta.....	33
7.8.	Tatimi në pronë nga data e fillimit të likuidimit.....	33
7.9.	Tatimi mbi vlerën e shtuar.....	34
7.10.	Vulat dhe çelësat e arkivit.....	35
7.11.	Obligimet shërbyese të Ofruesve të shërbimeve publike.....	35
7.12.	Raportimi i përgjithshëm vjetor për likuidimin.....	35
Neni 8	DISA ÇËSHTJE SPECIFIKE PËR ASETET.....	37
8.1.	Asetet në duar të palëve të treta.....	37
8.2.	Mallrat në tranzit.....	37

8.3. Prona e mbajtur në emër të palëve të treta.....	38
8.4. Çështje kadastrale	38
8.5. Anulimi i transaksioneve	39
Neni 9 PUNA ME KËRKESAT E KREDITORËVE.....	41
9.1. Formulari i kërkesës kreditore	41
9.2. Regjistri i kërkesave kreditore	41
9.3. Prioriteti i kërkesave kreditore.....	43
9.4. Trajtimi i kërkesave kreditore.....	43
9.5. Çështje specifike lidhur me kërkesat kreditore	44
9.5.1. Kërkesat për kamata.....	44
9.5.2. Kërkesat në valuta tjera nga ajo e euros	44
9.5.3. Kërkesat për performancë të veçante	44
9.5.4. Precizimi i kërkesave që nuk e kanë arritur afatin e pagesës.....	44
9.5.5. Kundërshtimi në tërësi apo pjesërisht i kërkesave.....	44
9.5.6. Borxhet e dyanshme	44
9.5.7. Dispozitat kontradiktore në një kontratë.....	44
9.6. Bazat për refuzimin e kërkesave në tërësinë e tyre.....	45
9.6.1. Kërkesat e parashkruara.....	45
9.6.2. Afati i parashtrimit/dorëzimit të kërkesës.....	46
9.7. Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta.....	46
9.8. Kërkesat e siguruara	48
9.8.1. Shitja e aseteve të siguruara	49
9.9. Trajtimi i kërkesave kreditore lidhur me punësimin.....	50
9.9.1. Të përgjithshme	50
9.9.2. Kompensimi dëmshpërblim për ndërprerje të kontratës së punës	51
9.9.3. Kush ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të kontratës të punës	52
9.9.4. Identifikimi i punëtorëve me të drejtë në kompensim për ndërprerje të kontratës	53
9.9.5. Si t'i trajtoj kërkesat për kompensim për ndërprerje të kontratës të punës.....	54
9.9.6. Vendimi për kërkesat për kompensim për ndërprerje të kontratës së punës	54
9.9.7. Pranueshmëria.....	54
9.9.8. Kërkesa ka bazë ligjore.....	57
9.9.9. Llogaritja e shumës për pagesën e ndërprerjen e kontratës së punës	57
9.9.10. Përcaktimi i "viteve të shërbimit" në NSH.....	59
9.9.11. Pagat e papaguara	59
9.9.11.1. Tre pagat e fundit të papaguara	60
9.9.11.2. Kërkesat tjera për pagat e papaguara	60
9.9.12. Kush është i kualifikueshëm për pagat e papaguara	61
9.9.13. Vendimi mbi kërkesat për pagat e papaguara.....	63
9.9.14. Shqyrtimi i kërkesave për pagat	65
9.9.15. Vlerësimi i kërkesave të vlefshme	67
9.9.16. Vlerësimi i tatimit në të ardhura personale dhe kontributit pensional.....	68
9.9.16.1. Në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen:.....	68
9.9.16.2. Në të ardhurat e përgjithshme nga rrogat nuk përfshihen:.....	69
9.9.16.3. Për kontributet pensionale, të ardhurat bruto do të përfshijnë:.....	69
9.10. Trajtimi i kërkesave kreditore për transformimet pronësore	70

9.10.1.Qëllimi	70
9.10.2.Ligji i aplikueshëm për transformimet	70
9.10.3.Obligimi i regjistrimit në Gjykatë.....	72
9.10.4.Përmbushja e detyrimeve që dalin apo që ndërlidhen me aksionet	76
9.10.5.Transformimi nuk ishte as diskriminues dhe as nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	76
9.10.6.Përfundimi lidhur me trajtimin e kërkesave nga transformimet.....	78
9.11. Lista përfundimtare e kërkesave kreditore	80
Neni 10 ANKESAT DHE PADITË	81
10.1. Ankesat kundër vendimeve të AL-së.....	81
10.2. Paditë kundër AKP-së.....	81
Neni 11 GJOBAT DHE SANKSIONET NË DISPOZICION TË AGJENCISË	82
11.1. Obligimi për të bashkëpunuar me AL-në	82
11.2. Ndihma nga Qeveria e Kosovës	82
11.3. Autoriteti për të shqiptuar gjoba	82
11.4. Sanksionet për parashtrimin e dokumenteve të rrejshme të kërkesës.....	83
11.5. Sanksionet për përvetësimet e paligjshme dhe fshehja e aseteve	83
Neni 12 SHPËRNDARJET PËR KREDITORËT DHE TRANSFERIMI I FONDEVE TË LIKUIDIMIT NË FONDIN E KONSOLIDUAR TË REP. SË KOSOVËS.....	84
12.1. Fondet e rezervuara.....	84
12.2. Llogaritja e “fondeve teprice” të likuidimit - neni 19.3 i Ligjit.....	84
12.3. Llogaritja e “fondeve të mbetura” të likuidimit - neni 2.2.6 i Ligjit.....	86
12.4. Llogaritja e “fondeve të përkohshme” të likuidimit - neni 2.2.7 i Ligjit	86
12.5. Kthimi i fondeve të likuidimit nga Qeveria e Kosovës	86
12.6. Dokumentet mbështetëse për raportet e shpërndarjeve për kreditorët.....	87
12.7. Shpërndarjet për kreditorët e NSH-ve	87
12.8. Shpërndarja përfundimtare për kreditorët e NSH-ve.....	88
Neni 13 PËRMBYLLJA E NSH-së NË LIKUIDIM.....	89
13.1. Raporti përfundimtar i përmbylljes së NSH-së në likuidim	89
13.2. Veprimet pas dorëzimit të kërkesës në DHPGJS për mbyllje të NSH-së.....	90
13.3. Mbyllja e rastit të ekspedituar të likuidimit	91
13.4. Njoftimi për mbylljen e NSH-së në likuidim	91
13.5. Pasojat e mbylljes së rastit.....	91
13.6. Veprime tjera pas mbylljes së rastit.....	92
Neni 14 INTERPRETIMI I RREGULLORES.....	93
Neni 15 HYRJA NË FUQI.....	93
Shtojca - Lista e formularëve standard të likuidimit	94

SHKURTESAT

Shkurtesa	Përshkrimi
Agjencia apo AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
Aktet nënligjore të AKP-së	Aktet nënligjore të AKP-së të nxjerra sipas kompetencave ligjore
AL	Autoriteti i Likuidimit
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DE	Drejtori Ekzekutiv i AKP-së
DPV	Deklarata Përfundimtare e Vlerës
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit
KB	Kombet e Bashkuara
KPS	Kërkesa për Përcaktim të Statusit të NSH-ve
Ligji i AKP-së	Ligji nr.04/L-034 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me ndryshime. ¹
Ligji në Fuqi	Ligjet në fuqi në Kosovë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës
NR	Ndërmarrje e Re
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
OSBE – OSCE	Organisation for Security and Co-operation in Europe - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHP	Ofrues i Shërbimeve Profesionale
Regjistri i Biznesit	Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar të Kosovës
SML	Sistemi për Menaxhimin e Likuidimit
sh.a.	Shoqëri Aksionare
sh.p.k.	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
UA	Udhëzimet Administrative të UNMIK-ut
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZDE	Zëvendës Drejtor Ekzekutiv i AKP-së
ZR	Zyra Rajonale e AKP-së

¹ Në rastet kur është referuar në Ligjin nr. 03/L-067, në fuqi nga 1 korrik 2008 deri më 20 shtator 2011, atëherë referimi është bërë me numrin e ligjit 03/L-067.

Neni 1 HYRJE

1.1.Qëllimi

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në Ligjin e AKP-së.

Deri në shitjen ose zgjidhjen në mënyrë tjetër sipas këtij ligji, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe asete në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me Ligjin e AKP-së dhe legjislacionit në fuqi.

Brenda kufizimeve të burimeve të veta administrative, Agjencia ushtron aktivitete të arsyeshme ndihmëse për ruajtjen ose rritjen e vlerës, aktivitetit fitimprurës dhe qeverisjes së ndërmarrjeve dhe aseteve, deri në masën sa këto aktivitete nuk e pengojnë ushtrimin e detyrave të përcaktuara me ligj siç është shitja, transferimi ose likuidimi i ndërmarrjeve dhe aseteve të ndërmarrjeve në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të Ligjit të AKP-së, pa vonesa të panevojshme.

Në mënyrën dhe masën e paraparë me Ligjin e AKP-së, Agjencia përmbush pretendimet e vlefshme dhe të dorëzuara me kohë të kreditorëve dhe pronarëve lidhur me një ndërmarrje apo asete të caktuara, nga mjetet e realizuara nga shitja, transferimi, likuidimi ose zgjidhja tjetër e ndërmarrjes ose asetit; me ç'rast të gjitha këto të ardhura me përjashtim të "Fondeve Teprice" të likuidimit, "Fondeve të Mbetura" të likuidimit dhe "Fondeve të Përkohshme" të likuidimit do të mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët dhe do të ruhen nga Agjencia.

Qëllim primar i Rregullores për Politika dhe Procedurat e Likuidimit është që të pajisë personelin e Agjencisë dhe palët e interesuara me një sistem që lehtëson mbarëvajtjen e procesit të likuidimit dhe procedura për vendim-marrje efektive dhe efikase gjatë procesit të likuidimit.

Çështjet të cilat nuk janë të mbuluara me këtë rregullore, por që janë të parapara si detyra/përgjegjësi të Autoritetit të Likuidimit do të zbatohen në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit të AKP-së dhe Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Kjo rregullore është përgatitur me qëllim për t'u siguruar që të gjitha likuidimet e Ndërmarrjeve Shoqërore janë duke u ndërmarrë në pajtim me ligjin e AKP-së, ligjin në fuqi dhe në përputhje me praktikën e standardeve ndërkombëtare të insolvencës.

Kjo rregullore iu referohet gjithashtu "formularëve" të likuidimit. Këto janë letra standarde, dokumente, formularë dhe njoftime që janë pjesë e sistemit të AKP-së për menaxhimin e procesit të likuidimit. Këta formularë standard duhet të përdoren aty ku specifikohet.

Shënim: Kjo rregullore nuk merret me administrimin e kërkesave të punëtorëve të kualifikuar për 20% nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjeve të Reja dhe aseteve në likuidim. Administrimi i kërkesave të tilla kryhet sipas Rregullores së miratuar nga Bordi i Drejtorëve dhe legjislacionit në fuqi.

1.2.Roli i Agjencisë

Procesi i likuidimit të NSH-ve ka filluar në vitin 2005 nga AKM. Atëherë AKM-ja dhe tani AKP-ja, në cilësinë e tyre themelore si administrues i besuar, kryejnë veprimtari që janë projektuar për të ruajtur ose për të shtuar shanset për sukses, vlerën ose qeverisjen e NSH-ve në përputhje me ligjin e AKP-së.

AKP-ja ka autoritetin të shes dhe transferoj dhe/ose likuidoj NSH-të dhe asetet në pronësi shoqërore në përputhje me ligjin e AKP-së dhe mund të inicioj likuidimin e një NSH-je apo ndonjë pjese të saj, nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve dhe/apo pronarëve të NSH-së. Këto likuidime janë zhvilluar konform legjislacionit përkatës² gjatë periudhës nga viti 2005 e deri më 20 shtator 2011, ndërsa prej 21 shtator 2011 zhvillohen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin e AKP-së dhe në Shtojcën e Ligjit të AKP-së.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që sapo të fillohet likuidimi, ai të kryhet në mënyrë efektive dhe të shpejtë duke respektuar afatet ligjore dhe afatet tjera të caktuara me rregulloret e AKP-së.

Për realizimin e këtij synimi, AKP-ja sipas nenit 2.2.2 të Ligjit për AKP-në: shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme.

AKP-ja është e obliguar që gjatë procesit të likuidimit të veproj në përputhje me parimet e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj. Ky është një parim bazë që qëndron në themel të ligjit të AKP-së i cili është hartuar me kujdes që të siguroj mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve dhe pronarëve në të gjitha fazat e privatizimit dhe likuidimit.

Në të gjitha rastet, të drejtat e kreditorëve janë të mbrojtura plotësisht me drejtën e ankimimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe afate të arsyeshme brenda cilëve mund të parashtrahet ankesa. Të gjitha letrat/shkresat/formularët standard të likuidimit janë hartuar për të tërhequr vëmendjen e pranuesit për të drejtën e tij të ankimimit.

1.3.Baza ligjore për likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore

Baza ligjore mbi të cilën bazohet procesi i likuidimit është Ligji i AKP-së dhe Shtojca e këtij Ligji, Akti Themelues i Agjencisë, Statuti i Bordit të Drejtorëve, Rregullorja për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit dhe ligjet e aplikueshme.

Nr	Legjislacioni
1.	Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me ndryshime
2.	Akti Themelues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

²Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12, me ndryshime për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 për mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë së tyre nën Autorizimin Administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Nga 1 korrik 2008 e deri më 20 shtator 2011 ka qenë në fuqi Ligji nr. 03/L-067.

Nr	Legjislacioni
3.	Statuti i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit
4.	Rregullorja për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit (kjo rregullore)
5.	Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës së Shfrytëzimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore, e datës 9 maj 2003, e ndryshuar
6.	Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03-L-154, Gazeta Zyrtare RKS nr. 57, publikuar 4 gusht 2009, në fuqi 15 ditë pas publikimit
7.	Ligji i Punës nr. 03/L-212, në fuqi nga 16 dhjetor 2010
8.	Ligji për Tatimin në të Ardhura Personale, 04/L-101
9.	Ligji për Fondet Pensionale në Kosovë, 05/L-028
10.	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077, në fuqi nga 20 dhjetor 2012

1.4.Kompetencat e Agjencisë mbi Ndërmarrjet Shoqërore

Kompetencat e AKP-së mbi Ndërmarrjet Shoqërore para vendosjes së tyre në likuidim janë të përcaktuara në Ligjin e AKP-së dhe Politikën Operative të Agjencisë.

Kompetencat e AKP-së dhe Autoritetit të Likuidimit mbi Ndërmarrjet Shoqërore të vendosura në likuidim janë të përcaktuara në Ligjin e AKP-së, Shtojcën e Ligjit të AKP-së dhe këtë Rregullore për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit.

Autoriteti i Agjencisë për t'i administruar NSH-të ose asetet që ndodhen në territorin e Republikës së Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si një subjekt juridik apo jo, të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore më 22 mars 1989 ose pas kësaj date, nuk kufizohet në atë se a i janë nënshtruar ato transformimit apo jo³. Për më tepër, pa marrë parasysh nëse ndonjë NSH ka pësuar transformim, AKP-ja gjithashtu ka autoritet mbi interesat shoqërore dhe shtetërore në ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik⁴. Transformimi⁵ mund të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë të parapara me nenet 5, 6, 8 dhe 9 të Ligjit AKP-së, duke përfshirë autoritetin për të filluar procedurat e likuidimit, vetëm kur (i) transformimi bazohet dhe kryhet në përputhje të plotë me ligjin në fuqi, dhe (ii) kur transformimi nuk është as diskriminues e as në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Ligji për AKP, neni 5.4). Megjithatë, në përputhje me nenin 5.5 të Ligjit të AKP-së, kur është fjala për NSH-në apo asetin që ka pësuar një transformim, Agjencia ka të drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 5.4 të Ligjit të AKP-së, përveç nëse Agjencisë i gjinden në dispozicion dëshmi të qarta në bazë të të cilave ajo përfundimisht konstaton se transformimi i plotëson kërkesat e tilla.

Kur një transformim është konstatuar të jetë në përputhje të plotë me ligjin, është shumë e pazakontë që të gjitha aksionet në ndërmarrjen e korporatizuar t'u jenë shitur punëtorëve apo investitorëve. Në shumicën e rasteve, një grup pakicë aksionesh (shpesh pakicë e konsiderueshme në praktikë) do të mbetet në pronësi shoqërore që do të trajtohet përmes shitjes nga Agjencia.

³ Ligji i AKP-së, neni 5.1.1 dhe 5.1.2.

⁴ Ligji i AKP-së, neni 5.1.3

⁵ Neni 3.1.27 i Ligjit të AKP-së

Nëse një rregullore ose ligj që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë pas 10 Qershorit 1999 i cakton përgjegjësinë për administrimin e aseteve të përcaktuara në nën-paragrafi 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni një organi tjetër publik, Agjencia nuk do të ketë autoritet mbi këto ndërmarrje duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të atij ligji ose rregullore.⁶ Në këtë rast njoftohen institucionet publike sipas formularit nr. L31 me shënim që për arsyet dhe referencat ligjore të largimit të NSH-së nga autoriteti administrativ i AKP-së.

Kur asetet e NSH-së gjenden jashtë Kosovës, AKP-ja mund t'i ndërmarrë të gjitha veprimet dhe t'i ushtrojë ato të drejta dhe autorizime ashtu siç e parasheh ligji në fuqi në lidhje me atë pronë. Kur të vendosë mbi çështje të tilla, AKP-ja është e detyruar të marrë parasysh të gjitha politikat përkatëse që mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës. Varësisht rastit në fjalë, AKP do të njoftoj dhe/apo koordinoj sipas nevojës veprimet me Avokaturën Shtetërore, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Në rast se Agjencia ka ushtruar kompetencat e saj për ta shitur biznesin apo asetet e NSH-së, dhe më pas me sukses në Gjykatë është vërtetuar pronësia e ndonjë pale pretenduese, atëherë trajtimi i këtyre rasteve do të bëhet në përputhje me nenin 17.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe nenet 40, 41 dhe 42 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Sipas nenit 17.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së: Çdo person që pretendon të ketë interes të ligjshëm në cilëndo pronë që është shitur apo në mënyra tjera zgjidhur nga ana e Autoritetit të Likuidimit mund të aplikojë në Gjykatë për kompensim adekuat monetar brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditëve pas shitjes apo zgjidhjes së tillë. Nëse Gjykata nxjerr vendim në favor të këtij personi, Gjykata urdhëron pagesën e kompensimit adekuat monetar për këtë person, të barasvlershme me vlerën e arsyeshme të interesit të tij në pronën që është prekur negativisht nga ajo shitje apo zgjidhje. Kompensimi i tillë duhet të paguhet nga të hyrat e pranuar prej shitjes apo zgjidhjes në mënyra tjera të asaj prone. Nëse Gjykata konstaton se këto të hyra nuk janë të mjaftueshme për t'i ofruar personit në fjalë kompensimin adekuat monetar, ndryshimi do të pranohet nga personi në cilësi të kreditorit të pasiguruar në likuidim.

Ligji i AKP-së nr. 04/L-034 në mënyrë të qartë parasheh kompensimin e pronës e jo kthimin (restituimin) e pronës.

1.5.Kompetencat e Agjencisë për të likuiduar Ndërmarrjet Shoqërore

Agjencia duhet ta kryej likuidimin sipas procedurës së paraparë me Ligjin e AKP-së, Shtojcën e Ligjit për AKP-në, Ligjin në fuqi, Rregulloren për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit si dhe aktet tjera nënligjore të miratuara nga Agjencia.

⁶ Neni 5.2 i Ligjit të AKP-së.

1.6.Kompetencat e AL-së

Pas vendosjes së NSH-së në likuidim, të gjitha kompetencat e organeve të menaxhimit dhe kontrollit të NSH-së do t'i kalohen AL-së. Kompetencat e AL-së shpjegohen në hollësi në Nenin 3 më poshtë.

1.7.Përgjegjësia personale e anëtarëve të AL-së

Çështja e përgjegjësisë personale të anëtarëve të AL-së përcaktohet qartë në Ligjin e AKP-së.

AL-të dhe punonjësit e tyre nuk do të kenë përgjegjësi personale kur veprojnë në emër të Agjencisë.

Anëtarët e AL-së veprojnë në emër të AKP-së dhe të gjitha veprimet apo mosveprimet e AL-së konsiderohen veprime ose mosveprime të Agjencisë⁷.

Sipas nenit 18.5 të Ligjit të AKP-së: "Asnjë person i angazhuar ose i punësuar nga Agjencia dhe asnjë person i cili mban një pozitë menaxheriale ose të drejtorit në Agjenci ose në lidhje me Agjencinë, nuk mban përgjegjësi personale të çfarëdo lloji ndaj cilësdo palë të tretë për dëmet të cilat i janë shkaktuar ose pretendojnë të jenë shkaktuar nga pala e tretë si rezultat i një veprimi ose lëshimi të Agjencisë ose një veprimi ose lëshimi të personelit, menaxhmentit ose Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, nëse ky veprim ose lëshim është bërë gjatë zbatimit ose ekzekutimit të autoritetit dhe përgjegjësisë të Agjencisë të përcaktuara në këtë ligj ose cilitdo element tjetër të ligjit në fuqi në Kosovë ose si pasojë e zbatimit të një interpretimi të arsyeshëm dhe jo qëllimkeq të këtyre autoriteteve dhe përgjegjësisë. Të gjitha përgjegjësitë për dëmet e shkaktuara në këtë mënyrë janë përgjegjësi ekskluzive e Agjencisë. Agjencia është e detyruar që të sigurojë dhe mbrojë fuqishëm personelin, menaxherët ose drejtorët kundër të cilëve është ngritur një akuzë për këto dëme. Për të shmangur dyshimin, parashihet në mënyrë specifike që ky paragraf nuk e pengon veprimin e asnjë dispozite të asnjë kontrate ndërmjet Agjencisë dhe cilitdo person të angazhuar apo punësuar nga Agjencia, që krijon detyrime dhe të drejta të dëmshpërblimit dhe obligime për palët, vis-a-vis njëra tjetrës."

Megjithatë, niveli konkret i përgjegjësisë personale i nënshtrohet detyrimeve kontraktuale ndërmjet Agjencisë dhe OSHP që funksionon në emër të AL-së.

⁷ Ligji i AKP-së, neni 18.5

Neni 2

FILLIMI I PROCESIT TE LIKUIDIMIT

2.1.Përzgjedhja e NSH-së për likuidim

Agjencia fillon me procesin e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore në mënyrë që të mund të identifikohen kreditorët, të bëhet shqyrtimi i kërkesave kreditore, pagesa e kreditorëve sipas disponueshëmerisë së fondeve, pagesa e fondeve në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës sipas dispozitave ligjore dhe përmbyllja e ndërmarrjes, respektivisht pushimi i ekzistimit të ndërmarrjes si subjekt juridik.

2.2.Dokumentet informuese për Bordin e Drejtorëve

Zyra rajonale ku gjendet NSH-ja duhet të përgatisë dhe dorëzoj në njësinë organizative përgjegjëse për likuidimin një dokumentacion për informim [formulari L01] për Bordin e AKP-së për të mbështetur propozimin që një NSH/Aset do të përzgjidhet për fillimin e procedurës së likuidimit. Dokumenti përfshinë:

- i) Analizë e shkurtër mbi përcaktimin e statusit ligjor të NSH-së.
- ii) Një përmbledhje të aseteve dhe detyrimeve (të njohura).
- iii) Mënyrën e propozuar të shitjes së aseteve.
- iv) Një përmbledhje të kërkesave (të njohura) të kreditorëve, ku përfshihen edhe kërkesat e të punësuarve (punëtorëve deri në vendosjen në likuidim , në pushim pa pagesë, në skemën sociale) dhe të ish-punonjësve (duke përfshirë ata që kanë mbetur pa punë si tepricë teknologjike pas shitjes së Ndërmarrjes së Re).
- v) Një vlerësim të shumës së parave të gatshme për buxhetin dy vjeçar të likuidimit që kërkohen për mbulimin e shpenzimeve të vlerësuara.

2.3.Fillimi i likuidimit

Procesi i likuidimit konsiderohet si i filluar që nga data e vendimit mbi fillimin e procedurave të likuidimit të përcaktuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve.

148

Neni 3 AUTORITETI I LIKUIDIMIT

3.1.Roli i AL-së

AL-ja i ushtron kompetencat ashtu siç e parasheh Ligji i AKP-së dhe Shtojca e Ligjit të AKP-së.

Për të arritur këtë qëllim, AL-ja është e pajisur me kompetenca të gjera, ndërsa ka edhe mbështetje teknike e profesionale nga personeli i AKP-së (siç është për shembull Zytari i Rastit).

Sipas Ligjit të AKP-së, neni 9.2, të gjitha kompetencat e organeve të menaxhimit dhe kontrollit të NSH-së të tilla i barten AL-së me rastin e emërimit të anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Autoriteti i Likuidimit vlerëson vlefshmërinë, shtrirjen dhe prioritetin e kërkesave dhe pengjeve apo kolateraleve të ndërlidhura të paraqitura ndaj Ndërmarrjes dhe njofton kërkuessit në fjalë lidhur me rezultatet e atij vlerësimi⁸.

3.2.Emërimi i AL-së

Për secilën NSH emërohet nga një Autoritet i Likuidimit.

Megjithëse kompetenca për të emëruar AL-në i takon Bordit të Agjencisë sipas nenit 12 dhe 13 të Shtojcës së Ligjit, në Dokumentin Informues të Bordit dhe në vendimin e Bordit përcaktohet që Menaxhmenti autorizohet të bëjë emërimin e Anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit si dhe të bëjë zëvendësimin e kohëpaskohshëm të tyre.

Në përputhje me vendimin e Agjencisë për të likuiduar një NSH, Agjencia e cakton Autoritetin e Likuidimit për ta ekzekutuar likuidimin e NSH-së.

3.3.Përbërja e AL-së

Do të emërohet një ose me shumë Ofrues të Shërbimeve Profesionale që të shërbejnë si Autoriteti Likuidues për cdo likuidim përveç kur objekti i likuidimit është një ndërmarrje që nuk ka asnjë pasuri ose kundër të cilës nuk është paraqitur asnjë kërkesë kreditore brenda afatit ligjor, në këto raste anëtarët e Autoritetit të Likuidimit mund të emërohen nga radhët e personelit të AKP.⁹

Një apo më shumë anëtar të personelit të Agjencisë mund të caktohen për t'i ndihmuar Autoritetit për Likuidim në secilin rast veç e veç. Aty ku pritët që një numër i madh i kërkesave kreditore të kenë të bëjnë me transaksione komplekse, numri i njerëzve që punojnë si pjesë e një Autoriteti të Likuidimit mund të ndryshohet në mënyrë që puna të shpërndahet në mënyrë më efektive.

⁸ Ligji i AKP-së Shtojca, neni 37.4

⁹ Ligji i AKP-së Shtojca, neni 13.1

Agjencia mund të emëroj anëtarët e Autoritetit të Likuidimit nga radhët e personelit të Agjencisë, në rastet kur administrimi i ndërmarrjes në likuidim rrezikohet në mungesë të angazhimit të Ofruesve të Shërbimeve Profesionale.¹⁰

Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit (përfshirë Kryesuesin e AL-së) i emëron Menaxhmenti i AKP-së sipas autorizimeve të deleguara në Vendimin e Bordit për fillimin e procedurës së likuidimit.

Anëtarët e AL-së emërohen me formularin standard të vendimit. [formulari L02].

Zëvendësimi i anëtarëve të AL-së bëhen sipas formularit nr. [formulari L03].

Zëvendësimi i përkohshëm i Kryesuesit bëhen sipas formularit nr. [formulari L04].

3.3.1. Ofruesit e Shërbimeve Profesionale (OSHP)

Sipas nenit 2.1.13 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, **“Ofrues i shërbimeve profesionale**, do të thotë një individ apo subjekt i angazhuar në ofrimin e shërbimeve profesionale për Agjencinë”.

Agjencia mund të nënshkruaj një Kontratë me qëllim të angazhimit të shërbimeve si “Ofrues të Shërbimeve Profesionale”.

Në rast se OSHP angazhohet si subjekt juridik (kompani apo konsorcium), atëherë Termat e Referencës duhet të miratohen paraprakisht nga Bordi dhe të emëruarit do të angazhohen nëpërmjet procesit të prokurimit publik sipas Ligjit për Prokurim Publik.

Në rast se OSHP-të angazhohen si individë (kontraktorë individual) që nuk janë aktualisht të punësuar në Agjenci, atëherë Termat e Referencës duhet të miratohen paraprakisht nga Bordi dhe të emëruarit do të angazhohen nëpërmjet Rregullave të Prokurimit për Shërbime të Vecanta të miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik më 22 shtator 2020.

Për t'u kualifikuar për emërim si OSHP në Autoritetet e Likuidimit në përputhje me Kontratën, firmat dhe/apo individët me kualifikime të duhura sipas nenit 15.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së ftohen nëpërmjet një tenderi të konkurrojnë për t'u caktuar Kontraktorë.

Ofertuesit duhet të plotësojnë kriteret e parapara në Termat e Referencës dhe në Dosjen e Tenderit, duke përfshirë këtu CV-të për të gjithë personelin e OSHP-të, diplomat e kualifikimeve. Varësisht dispozitave të zbatueshme të Ligjit të Prokurimit Publik, AKP-ja e rezervon të drejtën të kërkoj referenca të pavarura dhe/ose të bëj verifikimin e përvojës së punës sipas zgjedhjes së vet para përzgjedhjes së kontraktorit.

Pas nënshkrimit të kontratës, emërohen këta Kontraktorë të cilët pastaj i ofrojnë shërbimet e individëve të kualifikuar për të ofruar shërbime si Ofrues të Shërbimeve Profesionale (OSHP).

¹⁰ Ligji i AKP-së Shtojca, neni 13.3

OSHP-të përzgjidhen më pas nga AKP-ja për t'i marrë detyrat tek Autoritetet e caktuara të Likuidimit në bazë të njohurive dhe përvojës¹¹. Në rastin e ndërmarrjeve vecanërisht të ndërlikuara, përveç Zyrtarit të Rastit, mund të emërohen personel profesional mbështetës shtesë i AKP-së si anëtar të AL-së.

Kushtet e parapara në nenin 15 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së duhet të plotësohen para emërimit të anëtarëve të OSHP-së si anëtar të Autoriteteve të Likuidimit.

3.3.2. Anëtarët e stafit të Agjencisë pranë AL-së

Menaxhmenti i AKP-së i emëron anëtarët e stafit të Agjencisë si Zyrtar të Rastit për t'u caktuar si anëtar të AL-së.

3.4. AL-të i NSH-ve të cilat nuk kanë asete apo nuk kanë kërkesa kreditore

Menaxhmenti i AKP-së i emëron anëtarët e stafit të Agjencisë për t'u caktuar me detyrë tek AL-të.

Autoritetet e Likuidimit të NSH-ve që nuk kanë pasuri dhe kundër të cilave nuk janë paraqitur kërkesa kreditore në afat, nuk do të përfshijnë Ofrues të Shërbimeve Profesionale të jashtëm. Autoriteti i Likuidimit në raste të tilla do të përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të emëruar nga personeli i AKP. Njëri nga anëtarët do të emërohet të kryej detyrën e Kryesuesit.

Anëtarët e AL-ve në këto raste emërohen nga Menaxhmenti i AKP-së me anë të formularit përkatës për zëvendësimin e anëtarëve të AL-së [formulari L03].

3.5. Roli i anëtarëve të AL-së

3.5.1. Roli i Kryesuesi të AL-së

Kryesuesi i AL-së është personi i ngarkuar për të vepruar në emër të Autoritetit të Likuidimit të një NSH-je.

Roli i Kryesuesit të AL-së është:

- i) Të menaxhoj me procesin e likuidimit të NSH-ve;
- ii) T'i ndajë detyrat midis anëtarëve të tjerë të AL-së;
- iii) Të mbikëqyrë anëtarët e tjerë dhe stafin mbështetës të AKP-së të caktuar me detyrë pranë AL-së;
- iv) T'i nënshkruajë të gjitha vendimet që i lëshon AL-ja;
- v) Të sigurojë që puna e AL-së është në përputhje me ligjin e AKP-së dhe ligjet tjera në fuqi dhe të sigurojë përmbushjen e të gjitha afateve kohore dhe afateve të raportimit.

¹¹ Ligji i AKP-së Shtojca, neni 15

Në rast të mungesës së kryesuesit për një periudhë të përkohshme kohore, Menaxhmenti i Agjencisë me procedurë urgjente do të nxjerr vendim për të emëruar një Kryesues të AL-së që do të shërbej përkohësisht si zëvendësues. Zëvendësimi me rastin e pushimeve vjetore ose udhëtimeve të përkohshme jashtë vendit do të bëhet me anë të formularit përkatës për zëvendësimin e Kryesuesit të AL-së [formulari L04].

3.5.2. Roli i Anëtarëve tjerë të AL-së

Roli i anëtarëve të AL-së është:

- i) T'i ekzekutojë detyrat të cilat i cakton kryesuesi i AL-së;
- ii) Të marrin pjesë në mbledhje e thirrura nga AL-ja;
- iii) T'i sigurojë mbështetje teknike AL-së;
- iv) Të ndihmojnë në shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave duke përfshirë hartimin e letrave të përgjigjeve dhe korrespondenca të tjera të nevojshme;
- v) T'i verifikojnë të gjitha faktet materiale dhe dëshmitë e përdorura si bazë për vendimet të cilat i lëshon AL-ja.

3.5.3. Roli i Zyrtarit i Rastit/lëndës

Zyrtari i rastit duhet të jetë punonjës i AKP-së NSH.

Detyrat detaje të Zyrtarit të Rastit janë të përcaktuara në dokumentin Përmbledhja e detyrave dhe përgjegjësi të Zyrtarit të Rastit si Anëtar i Autoritetit të Likuidimit, të miratuar nga Menaxhmenti.

Në këtë pjesë paraqitet roli primar i Zyrtarit të Rastit.

Roli primar i Zyrtarit të Rastit është menaxhimi i dosjeve të rastit në baza ditore të cilat i kryen ekipi përgjegjës për likuidimin. Zyrtari i Rastit është përgjegjës:

- i) Për përcjelljen e ditarit të procesit të likuidimit të cilin e harton AL-ja në fillim të rastit, të sigurojë përmbushjen e të gjitha afateve kohore (duke e njoftuar menjëherë AL-në për afatet e ardhshme dhe afatet e raportimit);
- ii) Të ndihmoj në dërgimin e letrave tek kreditorët dhe të të gjitha letrave tjera standarde dhe formularëve të përgatitura nga AL-ja dhe të siguroj që ata të lëshohen me kohë;
- iii) T'i regjistroj kërkesat në bazën e të dhënave dhe të vendosë të gjitha informatat relevante në lidhje me kërkesat;
- iv) T'i rishikoj kërkesat dhe të bëjë verifikimin nëse nevojiten informata tjera (e cila nuk i kërkon informatat e AL-së), për shembull për qëllime të regjistrimit;
- v) Të ndihmoj në përgatitjen e raporteve për AL-të duke përfshirë Deklaratën e Punës dhe Deklaratën e Rezultatit;
- vi) T'i mirëmbaj dosjet e likuidimit si në letër ashtu edhe në mënyrë digjitale (arkiv);
- vii) Të kryejë çdo detyrë tjetër të cilën ia cakton AL-ja.

3.6.Detyrat e drejtpërdrejta të Autoritetit të Likuidimit pas emërimit

3.6.1. Krijimi i Arkivit të Likuidimit

Krijimi i Arkivit të Likuidimit është përgjegjësi e Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit , por dosjen e lëndës vetvetiu e mirëmban Zyrtari i Rastit i AKP-së. Zyrtari i Rastit duhet të mbledhë të gjithë dokumentacionin që duhet të përfshihet në Dosjen e Likuidimit.

Arkivi i Likuidimit përmban të gjitha shënimet e likuidimit dhe fizikisht ndodhet në Zyrën Rajonale përkatëse. Ka mundësi që disa shënime të ruhen në ZQ të AKP-së, siç është korrespondenca me gjykatë dhe korrespondenca me pretenduesit/kreditorët apo përfaqësuesit e tyre ligjor, por të gjitha korrespondencat me Gjykatën dhe/apo palët tjera duhet të arkivohen në SML.

3.6.2. Dosja standarde e arkivit të likuidimit

Dosja standarde e arkivit të likuidimit duhet të përmbajë së paku informatat në vijim:

Historiku i NSH-së

- Dokumente rreth historikut të ndërmarrjes

Korrespondencat e përgjithshme

- Hyrëse
- Dalëse

Procesverbali i takimeve të AL-së me palët e interesuara

Transaksionet e privatizimit/shitjes

Shitja 1, shitja 2, shitja 3 etj

- Dokumentacioni i shitjes
- AP/IM/CLOR
- Shpalljet
- Regjistrimi i ofertuesve
- Kontrata e shitjes/vendimi i bordit

Fillimi i likuidimit

- Dokumentet informuese për Bordin dhe vendimet e Bordit
- Emërimet e AL-së
- Letra për tepricë të punëtorëve
- Master kopja e Ditarit të Likuidimit

Lajmërimet dhe Shpalljet

- Njoftim për Gjykata
- Njoftim për kreditorët
- Njoftim për regjistrin e biznesit,

- Njoftim për bankat
- Shpalljet në gazeta

Llogaritë bankare

- Kërkesë për të hapur xhirollogari bankare
- Korrespondenca e bankës/urdhrrat për transfer.
- Pasqyrat bankare nga banka

Financat e AL

- Raportet financiare të departamentit për financa dhe buxhet të AKP-së
- Faturat e shitjes
- Faturat e blerjes
- Dokumentet e prokurimit

Marrëveshjet e AL

- Marrëveshjet për ofruesit e shërbimeve
- Marrëveshjet e qirasë
- Marrëveshjet tjera

Regjistrimi i aseteve dhe lista e detyrimeve

Indeksi arkivues i NSH (Lista e arkivës në NSH)

- Gjendja e bilancit në datën e fillimit të Likuidimit
- Listat e Aseteve të mbetura
- Detyrimet
- Tabela përfundimtare e aseteve dhe detyrimeve
- Shitja e aseteve

Vendimet për kërkesat kreditore dhe ankesat

- Kërkesa për informata shitesë (letra)
- Kërkesat e vlefshme/aprovuara (letra)
- Kërkesat e refuzuara (letra)
- Ankesat për vendimet mbi kërkesat
- Ankesat në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS
- Vendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS për ankesat

Shpërndarjet kreditorëve

- Shpërndarjet e parakohshme
- Lista përfundimtare e shpërndarjes
- Korrespondenca me Financat e AKP-së
- Dokumentet për Informim të Bordit dhe vendimet e Bordit për shpërndarje të kreditorëve

Transferimet e fondeve të likuidimit në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës

- Transferimi i Fondeve Tepriçë (neni 19.3 i Ligjit)

- Transferimi i Fondeve të Mbetura (neni 2.2.6 i Ligjit)
- Transferimi i Fondeve të Përkohshme (neni 2.2.7 i Ligjit)

Dokumentet ligjore

- Kërkesa për veprim
- Opinioni ligjor
- Rastet e gjykatës
- Të tjera.

3.6.3. Krijimi i Arkivit të rastit/lëndës në Sistemin e Menaxhimit të Likuidimit

Agjencia e ka arkivin e rastit për të gjitha likuidimet.

3.6.4. Shqetësimet lidhur me statusin e pronësisë apo aksionet në një NSH-je

Në rast se AL-ja ka dyshime të arsyeshme apo shqetësime për statusin e pronësisë të një NSH-je apo aseti në bazë të provave origjinale apo dëshmive tjera ose parashtrësive të cilat i dorëzon një parashtrues i kërkesës kreditore, e në të cilat raste në përputhje me nenin 5.6.1 të Ligjit AKP-së do e parandalonte Agjencinë t'i ushtroj kompetencat e veta në pajtim me nenin 9 të Ligjit të AKP-së, AL-ja menjëherë e informon Bordin e Drejtorëve të AKP-së dhe Menaxhmentin e AKP-së për një çështje të tillë dhe të pezullon çdo veprim në lidhje me NSH-në e tillë ose asetin e tillë derisa të mos sqarohet statusi i pronësisë me vendim nga Bordi i Drejtorëve.

Sipas nenit 5.6.2 të Ligjit të AKP-së, në mungesë të këtyre provave, për ato ndërmarrje Agjencia do të vazhdoj të ushtroj të drejtat dhe kompetencat e saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji.

3.6.5. Buxheti i likuidimit

Në fillim të likuidimit, buxheti i likuidimit është burimi i vetëm i financimit të procedurave të Likuidimit.

Kodet buxhetore të buxhetit të likuidimit duhet të përgatiten në bazë të planit kontabël të fondeve në mirëbesim të përgatitur nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit të AKP-së.

Buxheti i miratuar, rialokimet e buxhetit si dhe buxheti i rishikuar/rritur duhet të regjistrohet në SML dhe të dorëzohet edhe në formë elektronike në Departamentin e Financave dhe Buxhetit të AKP-së dhe Departamentin e Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve.

AL-ja duhet të përpiqet t'i mbaj shpenzimet e likuidimit (përfshirë edhe shpenzimet e parave të imta) në nivel të arsyeshëm.

AL-ja duhet të shqyrtoj dhe azhurnoj rregullisht (mundësisht në çdo tre muaj) Raportin e Shpenzimeve të Likuidimit e cila pasqyron statusin e shpenzimeve të Likuidimit. Çdo ndryshim në ndarjet buxhetore të likuidimit duhet të miratohet nga Bordi AKP-së. AL-ja mund të vendosë

për rivendosjen/rialokimin e mundshëm të linjave buxhetore, sipas nevojës, në qoftë se buxheti i përgjithshëm i rishikuar nuk e kalon shumën e përgjithshme të aprovuar nga Bordi. Në këto raste, AL do të bëj rialokimin e buxhetit pas konsultimit me Menaxhmentin e AKP-së.

Në çdo rast, kur pozicioni i para-përcaktuar i buxhetit mund të ndodh të tejkalohet, AL-të e njoftojnë menjëherë menaxhmentin e AKP-së dhe përgatisin një buxhet të ri i cili duhet të miratohet nga Bordi.

3.7.Konfliktet e interesave

Kryesuesi dhe çdo anëtar i AL-së është i detyruar t'i deklaroj interesat ekzistuese të tij/saj dhe ka për detyrë të informoj kryesuesin e AL-së dhe Menaxhmentin e AKP-së për çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit i cili mund të paraqitet gjatë ushtrimit të detyrës të anëtarit të AL-së.

Mos raportimi i konfliktit të interesit do të shkaktoj masa disiplinore, me mundësi të shkëputjes së marrëdhënies së punës për Zyrtarët e Rastit si dhe detyrimet që ka OSHP ndaj AKP-së në bazë të kontratës.

AL-ja duhet të sigurohet që i tërë personeli i cili është caktuar me detyrë pranë saj ka nënshkruar Deklaratën për Konflikt Interesi [Shih formularin L05].

3.8.Datat e rëndësishme në procedurën e rasteve të likuidimit

Kryesuesi i AL-së duhet t'i verifikoj, kurse Zyrtari i Rastit duhet t'i regjistroj datat e mëposhtme të rëndësishme për procedimin e çështjes së likuidimit, të cilat duhet të përfshihen kur të lëshohen njoftimet për kreditorët, ose raportet për Bordin:

- i) Data e nënshkrimit të kontratës së shitjes së Nëdrmarjes së Re apo asetit në likuidim;
- ii) Data e Vendimit të Likuidimit e cila është edhe datë e caktimit të AL-së dhe caktimin e punonjësve të AKP-së për të. Kjo është edhe data në të cilën nga mesnata të gjitha kontratat e punës që janë në fuqi, nëse ka të tilla, në mes të NSH-ve dhe punëtorëve të saj anulohen në bazë të ligjit¹².
- iii) Data e Publikimit të Parë të Vendimit të Likuidimit, me të cilën janë të lidhura të gjitha afatet kohore të procedurave të likuidimit.
- iv) Data e fundit për parashtrimin e kërkesave nga kreditorët të supozuar dhe mbajtësit e interesave.
- v) Data e Pezullimit: Data e pezullimit e të gjitha veprimeve gjyqësore kundër NSH-së.
- vi) Data e njoftimit të gjitha organeve ligjore për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së; dhe
- vii) Data e njoftimit të të gjithë kreditorëve të njohur për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së

¹² Neni 8 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së

3.9. Llogaridhënia dhe përgjegjësia e AL-së dhe anëtarëve të AL-së

AL-të i përgjigjen vetëm Bordit të Agjencisë dhe nuk i përgjigjen asnjë pale tjetër. Çdo AL është pjesë integrale/përbërëse e Agjencisë. Anëtarët e AL-së veprojnë në emër të AKP-së dhe të gjitha veprimet dhe lëshimet e një AL-jë do të shihen si veprime dhe lëshime të Agjencisë¹³. Çdo person që shërben, ose angazhohet apo caktohet për të ndihmuar AL-në është "personi i punësuar apo i angazhuar nga Agjencia" brenda kuptimit të nenit 18.5 të Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit do të koordinoj aktivitetet e përditshme me Menaxhmentin e AKP-së dhe njësitë tjera organizative relevante.

3.10. Të drejtat dhe kompetencat e AL-së

Pas emërimit të AL-së, të gjitha kompetencat e menaxhmentit dhe organeve kontrolluese të NSH-ve përkatëse do t'iu barten AL-ve¹⁴. Në praktikë, kjo i fuqizon AL-të siç shpjegohet në vijim:

3.10.1. Drejton ish-menaxhmentin e NSH-së

AL-ja është e autorizuar të ndërmerr të gjitha veprimet menaxheriale për dhe në emër të ish NSH-ve të nevojshëm ose i përshtatshëm për menaxhimin e punëve, afarizmin, dhe pronën e NSH-ve, duke përfshirë, por pa u kufizuar si në vijim:

- i) Hyrjen dhe inspektimin e lokaleve të NSH-së¹⁵;
- ii) Përfaqësimin dhe kryerjen e afarizmit të NSH-së¹⁶;
- iii) Krijimin dhe përfundimin e një regjistri të inventarit të të gjitha aseteve dhe detyrimeve të NSH-së dhe subjekteve të saj;
- iv) Ruajtjen dhe mirëmbajtjen e librave dhe korrespondencën afariste të NSH-së¹⁷;
- v) Kontraktimin e një pjese të aktiviteteve të NSH-së;
- vi) Vazhdimin ose Qiradhënien e cilësdo pronë të NSH-së dhe heqjen e qirasë nga cilado pronë e nevojshme apo e përshtatshme për vazhdimin e biznesit të NSH-së;
- vii) Ngritjen ose marrjen hua të parave dhe dhënien e letrave me vlerë mbi pasuritë e NSH-së.
- viii) Ekzekutimin në emër të NSH-së të çfarëdo titulli pronësor, pranim-dorëzimi apo dokumenti tjetër¹⁸;

¹³ Ligji i AKP-së, Neni 9.3.

¹⁴ Neni 9 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

¹⁵ Ligji i AKP-së, Neni 6.1.9.

¹⁶ Në praktikë, vazhdimi afat shkurtër i afarizmit mund të jetë i nevojshëm për të realizuar udhëheqje me rregull të inventarit si dhe mbledhjen e borxheve. Megjithatë, AL-ja duhet gjithmonë ta shohë arsyeshmërinë dhe përfitimi nga afarizmi para se të marrë një vendim të tillë.

¹⁷ Ligji i AKP-së Shtojca, neni 18.1.2.

¹⁸ Ligji i AKP-së Shtojca neni 18.1.5

- ix) Tërheqjen, pranimin, hartimin dhe mbështetjen e çfarëdo urdhër pagese me shkrim apo ndonjë njoftimi zotues me emër dhe në emër të NSH-së¹⁹;
- x) Operimin, hapjen, mbylljen dhe konsolidimin e llogarive bankare të NSH-ve dhe bërjen apo shkaktimin e ndonjë pagese të nevojshme apo të rastësishme për kryerjen e funksioneve të AL-së;
- xi) Punësimin dhe largimin e punëtorëve nga puna²⁰;
- xii) I bën kërkesë cilitdo punëtor apo kontraktues apo ndonjë kontakt tjetër afarist të NSH-së që të sigurojë informata të cilat i ka në dispozicion në lidhje me NSH-në;
- xiii) I bën kërkesë cilitdo person i cili ka kontroll mbi dokumentet e ndonjë NSH-je që t'i sigurojë qasje në ato dokumente për shqyrtimin e tyre, riprodhim dhe ruajtje.

3.10.2. Klasifikimi dhe kerkimi i borxheve ndaj NSH-së

AL-ja ka kompetencë të klasifikoj dhe të parashtroj kërkesë ndaj palëve të treta të cilët kanë borxhe ndaj NSH-së në likuidim.

3.10.3. Kufizimet në transferimin e pronës²¹

1. Që nga momenti i miratimit të Vendimit për Likuidim, shitja, zgjidhja, tjetërsimi, transferimi apo inicimi i qiradhënies së një prone të ndërmarrjes, në tërësi apo pjesërisht, përfshirë transferet për përmbushjen e obligimeve ekzistuese, apo krijimin e garancive apo interesave hipotekare kundrejt pronës së ndërmarrjes që nuk është iniciuar nga Autoriteti i Likuidimit ndalohet pa urdhër të Gjykatës.

2. Të gjitha transferet për përmbushjen e obligimeve ekzistuese, apo krijimi i garancive apo interesave hipotekare kundrejt pronës së ndërmarrjes ndalohen pa aprovim të Gjykatës, përveç për shitjen apo transferimin mallrave në rrjedhën e rregullt të operimit të biznesit të ndërmarrjes nëse ato operacione biznesi vazhdojnë të funksionojnë.

3.10.4. Heqja dorë nga pronat

Duke iu nënshtruar aprovimit të DHPGJS-së të kërkesës të cilën AL-ja ia parashtron asaj, AL-ja mund të heq dorë prej një asemi ose disa aseteve të NSH-së në rrethana të caktuara sipas nenit 18.3.1 dhe 18.3.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në.

Poashtu, AL-ja mund të parashtroj kërkesë në Gjykatë për ekzekutimin e një urdhri ndaj palëve të treta që janë në posedim të aseteve të NSH-ve që ato palë t'i kthejnë ato asete. Kur ekzekutimi

¹⁹Ligji i AKP-së Shtojca, neni 18.1.6.

²⁰“Neni 8 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së parashih se: “Prej mesnatës nga data e vendimit për likuidim të gjitha kontratat e punës, atëherë në fuqi, nëse ka, në mes të ndërmarrjes dhe punonjësve të saj anulohen”, d.m.th. të gjithë të punësuarit e NSH-së bëhen tepriçë me veprim të ligjit. NSH

²¹ Neni 28 i Shtojcës së Ligjit.

është jopraktik²², AL-ja mund të dorëzojë kërkesë me shkrim në gjykatë me qëllim që të heqë dorë ose ta largoj interesin e NSH-ve mbi ato asete.

Kur prona e NSH-ve gjendet në vende të tjera dhe nuk mund të realizohet, AL-ja i kërkon gjykatës leje që të heqë dorë nga ajo pronë. Agjencia e krijon një regjistër të pasurisë prej të cilës është hequr dorë dhe ia dorëzon këtë pronë shtetit të Kosovës që të mbahet në mirëbesim.

DHPGJS-ja merr vendim lidhur me kërkesën e tillë jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë nga data e kërkesës nga AL-ja apo AKP-ja.²³

Të gjitha kërkesat për heqje dorë të aseteve paraprakisht miratohen nga Bordi i Drejtorëve para se të dorëzohen në Dhomën e Posaçme sipas ligjit.

3.10.5. Të inicioj dhe mbroj në procedurë ligjore në emër të NSH-së

AL-ja mund të iniciojnë, mbrojnë dhe të hyjnë në çfarëdo aranzhime ose kompromis për të shmangur ose përfunduar çdo veprim ose procedurë tjetër ligjore me emrin dhe në emër të NSH-së, nëse kjo është e nevojshme për të mbrojtur apo avancuar vlerën e ndërmarrjes apo aseteve të saj²⁴.

Përderisa AL-ja do të vlerësoj dhe rekomandojë kursin e veprimit, të gjitha kompromiset apo aranzhimet duhet të miratohen nga menaxhmenti i AKP-së apo Bordi i Drejtorëve varësisht rastit specifik për të cilën kërkohet vendimmarrje sipas Ligjit të AKP-së.

Asnjë veprim ligjor, kompromis apo aranzhman me një debitor ose kreditor nuk duhet të bëhet pa miratimin paraprak me shkrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

3.10.6. Të pezulloj procedurat ligjore kundër NSH-ve

Pezullimi i veprimeve ligjore kundër NSH-së në likuidim është shpalosur në nenin 5 të rregullores.

3.10.7. Anulimi i transaksioneve dhe anulimi i transfereve të pronës dhe aseteve

AL mund të kërkojë pranë DHPGJS-së urdhërin për anulimin e çdo transferi të pronës apo aseteve të NSH-së të fituar gjatë periudhës prej 22 mars 1989 deri më datën e vendimit për Likuidim nga Bordi në përputhje me Ligjin e AKP-së, me kusht që të përcaktohet se transferet e tilla²⁵:

- i) Janë bërë në vlerë më të vogël se vlera e drejtë e tyre;
- ii) Kanë ulur vlerën totale të aseteve të Ndërmarrjes;
- iii) Kishin për qëllim apo për pasoj e dëmtimit të interesit të kreditorëve;

²² Ligji i AKP-së Shtojca, neni 19.3

²³ Ligji i AKP-së Shtojca, neni 19.7.

²⁴ Shtojca e Ligjit të AKP-së neni 18.1.11.

²⁵ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 21



- iv) Kishin për qëllim apo rezultuan në humbjen, vonimit apo pengimit të aftësisë të kreditorëve për të mbledhur kërkesat duke transferuar asetet tek pala e tretë kur pala e tretë ka qenë në dijeni apo është dashur të jetë në dijeni për qëllimin apo ndikim;
- v) Kanë qenë rezultat i transaksioneve me kreditorin ku kreditori ka fituar më shumë se pjesën proporcionale të aseteve të Ndërmarrjes dhe transaksioni ka ndodh në momentin kur kreditori është dashur të dijë që Ndërmarrja nuk ishte apo nuk do të mund të përmbushë obligimet e saja;
- vi) Ishin në kundërshtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara lidhur me imponimin e sanksioneve ndërkombëtare, pavarësisht nëse më pas është pranuar nga vendimi i gjyqit apo vendim me arbitrazh; apo
- vii) Mund të anulohen apo përcaktohen si të pazbatueshme në bazë të cekur në nenin 21 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së apo ndonjë bazë tjetër ligjore.

Për qëllimin e këtij neni, transferi do të përfshijë çdo mënyrë (të drejtpërdrejtë apo jo, absolute apo të kushtëzuar, vullnetare apo jo) të bartjes apo transferit, shitjes, këmbimit, dhuratës, shpërndarjes, zgjidhjes, lënies pengë, hipotekë apo ndonjë drejtë tjetër.

3.11.Emërimi i ekspertëve për të ndihmuar NSH-të në likuidim

Siç parashihet në Ligjin e AKP-së Shtojca, neni 18.1.12, AL-ja mund të angazhoj/kontraktoj Ofrues të Shërbimeve - OSH për t'i ndihmuar AL-së gjatë zhvillimit të procesit të likuidimit.

Në përputhje me praktikën e Agjencisë për koordinimin e procesit të likuidimit, Menaxhmenti i AKP-së e bën miratimin e kërkesave të AL-së për të angazhuar OSH-të. AL-ja ka mundësi për angazhimin e ish-menaxhmentit të NSH-së, ish-punësuarëve ose ekspertëve tjerë për të vepruar si OSH.

Angazhimi i OSH-ve bëhet sipas procedurave apo vendimeve të miratuara nga Agjencia.

Nëse është e nevojshme AL-ja mund të angazhoj persona për të vepruar si agjentë apo për të ofruar ekspertizë, si p.sh juristë, kontabilistë, ekspert kadastral apo persona tjerë të kualifikuar për të ndihmuar AL-në në kryerjen e detyrave të saja. Për të dalluar emërimet e tilla nga ato të Ofruesve Profesional të Shërbimeve, personat e caktuar për të vepruar si ekspertë për të ndihmuar në likuidim janë të përshkruar si Ofrues të Shërbimeve (OSH).

3.12.Sigurimi i NSH-së apo aseteve të saj

Me qëllim të mbrojtjes dhe sigurisë të pasurive të NSH-së, AKP-ja dhe AL-ja kanë kompetenca për të angazhuar Ofrues të Shërbimeve për të ofruar shërbime të sigurimit në lidhje me biznesin dhe pronën e NSH-së.

3.13.Përgjegjësitë dhe obligimet e AL-së

AL do të ketë përgjegjësitë në vijim:

3.13.1. Asetet e NSH-së

Duke marr parasysh resurset administrative dhe financiare në dispozicion, AL do të ndërmerr të gjithë hapat e duhur për të mbrojtur dhe siguruar asetet e NSH-së²⁶, duke iu nënshtruar pritjeve që të gjitha shpenzimet ndërlidhëse do të kompensohen nga të ardhurat që pritet të realizohen nga shitja e këtyre aseteve.

3.13.2. Inventari i aseteve dhe kërkesave kreditore

Brenda 60 ditësh²⁷ nga publikimi i parë i Njoftimit për datën e Likuidimit, AL-ja do të ekzaminojë librat dhe regjistrat e NSH-së dhe do të përpilojë inventarin e aseteve dhe diagramin fillestarë të borxheve të NSH-së dhe llogarive të arkëtueshme. AL mund të shfrytëzoj regjistrat të përpiluara për ta ndihmuar Agjencinë për qëllime të privatizimit dhe likuidimit.

AL është e obliguar të vlerësojë vlefshmërinë, shtrirjen dhe prioritetin e të gjitha kërkesave që janë bërë në lidhje me ndonjë NSH gjatë shqyrtimi të kërkesave AL ka të drejtë të:

- i) Konvertojë tërësisht apo pjesërisht, kërkesat bazuara në kontratë, në kërkesa për kompensim monetar;
- ii) Kundërshtoj ndonjë kërkesë, tërësisht apo pjesërisht, deri në atë masë deri ku kërkesa është e përmbushur në mënyra të tjera; dhe
- iii) Kundërshtoj kërkesën, tërësisht apo pjesërisht, sipas nevojës për të mbuluar shumën kërkesë për të cilën kërkuesi që detyrohet ndaj ndërmarrjes.

3.13.3. Përgatitja e Raportit për Rezultatin e Parashikuar

AL është i obliguar të përcjell përparimin e procesit të likuidimit, kurse Zyrtari i Rastit është përgjegjës për përgatitjen e Raportit për Rezultatin e Parashikuar në përputhje me raportin e përcaktuar në sistemin SML.

Zyrtari i Rastit duhet të sigurohet që Raporti i Rezultatit të Parashikuar (RRP) azhurnohet me secilin ndryshim në: vlerësimin e likuidimit; koston e likuidimit; dhe gjendjen e kërkesave kreditore sipas përcaktimit të AL-së dhe do të mbajë kopjen e verifikuar nga AL në regjistrin e rasteve. AL duhet të sigurohet që në mënyrë të drejtë pasqyron të gjitha realizimet e aseteve, nga aspekti aktual dhe sipas parashikimit.

Detyrimet dhe kërkesat kreditore, të pranuar dhe ende të pashqyrtuara duhet të përfshihen për t'i dhënë AL-së një vlerësim real të rezultatit të likuidimit. Raporti i Rezultatit të Parashikuar e përbën pjesën integrale të Sistemit të Menaxhimit të Likuidimit (SML) dhe shumica e informatave të cilat i përmban gjenerohen nga nën-sistemet tjera të SML-së. Pavarësisht nga kjo, AL ka përgjegjësi për të mbikëqyrë RRP për arsyeshmëri dhe për të hulumtuar dhe korrigjuar gabimet e zbuluara.

²⁶ Ligji i AKP-së, Neni 19.2.

²⁷ Afat i brendshëm.

RRP do të tregojë potencialin për të paguar kreditorët. Një vlerësim i rezultatit të rastit duhet t'i sigurohet Kryesuesit të AL duke theksuar tepricat e mungesat e parashikuara dhe, aty ku është ekonomike dhe e mundshme, rekomandimin se ku mund të bëhen shpërndarjet duke iu nënshtruar provizionimit të nevojshëm.

3.13.4. Inspektimi publik i inventarit të aseteve dhe diagrami i borxheve

AL do të sigurohet që inventari i aseteve dhe diagrami fillestar i borxheve të NSH-së të jetë në dispozicion për shiqim publik në faqen elektronike të Agjencisë.

AL rregullisht do të azhurnojë diagramin e borxheve sipas regjistrimit të kërkesave të reja të kreditorëve. Kjo informatë shpallet në dy mënyra: një përmes njoftimit të shpallur për të gjithë kreditorët [Shih Formularin L 24] dhe nëpërmjet shpalljes në faqen elektronike të AKP-së [Shih Formularin L08].

3.13.5. Shitja e aseteve me likuidim

Ekziston ndarja e qartë e përgjegjësi ndërmjet AL dhe Agjencisë në procesin e shitjes së aseteve me likuidim.

Përderisa, sipas nenit 18.1.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, AL-ja ka kompetencën për të marrë në posedim, grumbullimin, rikthimin dhe t'i marrin të gjithë hapat e nevojshëm për realizimin e pasurisë së NSH-ve dhe, për këtë qëllim, të hyj apo inicioj procedura të tilla ashtu siç AL-ja e mendon të përshtatshme, shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore bëhet sipas rregulloreve përkatëse për shitjen e aseteve të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore bëhet në përputhje me nenin 6, 8 dhe 9 të Ligjit të AKP-së dhe nenit 18.1.4 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

3.14. Udhëzimet nga DHPGJS

Në çdo moment gjatë procedurës së Likuidimit, AL mund të dorëzojë kërkesën me shkrim tek DHPGJS për të kërkuar udhëzim lidhur me çështjen apo duke përfshirë, mirëpo jo kufizuar në ndonjë çështje lidhur me pajtueshmërinë me apo interpretimin e Shtojcës të Ligjit të AKP-së²⁸.

AL mund t'i drejtohet DHPGJS-së me kërkesë me shkrim për gjykim të ndonjë çështje në ligj dhe DHPGJS-ja duhet të vendos për këtë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune²⁹. DHPGJS mund të jap urdhër, proces, apo aktgjykim që është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm apo i përshtatshëm për t'i zbatuar dispozitat e ligjit në fuqi apo për të ndihmuar likuidimin e ndonjë Ndërmarrje.³⁰

²⁸ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 48.1

²⁹ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 48.2

³⁰ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 48.3

114.

Neni 4 SISTEMI PËR MENAXHIMIN E LIKUIDIMIT

4.1. Arkivi i likuidimit

Përgjegjësitë dhe përmbytja e arkivës së likuidimit janë të përcaktuara në nenin 3 të rregullores.

4.2. Regjistri i kërkesave kreditore

Regjistri i kërkesave kreditore mirëmbahet në sistemin SML dhe të gjitha kërkesat e pranura protokolohehen dhe iu vendoset data, evidentohen në SML arkivohen në mënyrë fizike në dosjen e NSH-së dhe elektronike në SML. Me fillimin e likuidimit, ato shpërndahen tek AL-ja përgjegjëse për likuidimin për procedim sipas Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe kësaj rregulloreje.

4.3. Dokumentet standarde - formularët e likuidimit

Në tërë korrespondencën, duhet të shfrytëzohen formularët standard. Lista e formularëve është në shtojcë të kësaj rregulloreje.

4.4. Sistemi i Menaxhimit të Likuidimit

Sistemi i Menaxhimit të Likuidimit (SML) është mjeti kryesor për menaxhimin e të gjitha informatave për asetet, listën e kërkesave kreditore, kopjet e korrespondencave, vendimet e Autoritetit të Likuidimit, kopjet e vendimeve të Bordit, vendimet e Gjykatave dhe Raportin e Rezultatit të Parashikuar.

Është më se e rëndësishme që shitjet e aseteve dhe të gjitha vendimet për kërkesa të regjistrohen në SML pasi që ky përbën sistemin që përfshin Raportin e Rezultatit të Parashikuar.

SML përfshin nën-sistemet në vijim:

- i) Regjistrin e Dëshmive të Kërkesave
- ii) Regjistrin e Dëshmive të Interesit
- iii) Ditarin e sistemit të menaxhimit
- iv) Raportin e Rezultatit të Parashikuar.

Të gjitha shkresat, korrespondencat dhe dokumentet relevante të Ndërmarrjes në likuidim arkivohen në dosjen fizike të NSH-së dhe në formë elektronike (të skenuar) në SML.

Për qëllime të sigurisë, vetëm Zyrtarët e Rastit të AKP-së kanë qasje në SML për azhurnim dhe popullim të databazës. Ofruesit Profesional të Shërbimeve për AL dhe zyrtarët tjerë të AKP-së mund të kenë qasjen vetëm për të lexuar shënimet në SML.

4.5. Të dhënat e Autoritetit të Likuidimit

AL duhet të mbaj shënimet e aktiviteteve të saj dhe të gjitha shënimet lidhur me likuidimin duhet të ruhen në SML siç janë: kërkesat, vlerësimet, shënimet e aseteve të mbetura për shitje, vlerësimet e shpenzimeve të likuidimit, informata mbi provizionimin për fondet e rezervuara sipas nenit 42 të Shtojcës së Ligjit. AL do të krijoj shënime shtesë siç janë oraret e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale (OSHP) dhe shënime të aktiviteteve të tyre.

Neni 5 **NJOFTIMET PAS FILLIMIT TË LIKUIDIMIT**

5.1.Kërkesa e njoftimit në përgjithësi

Komunikimet e standardizuara dhe formale, ftesat dhe formularët që do të shfrytëzohen nga Autoriteti i Likuidimit riprodhohen nga Agjencia në gjuhën shqipe dhe serbe. Nëse një person flet rrjedhshëm apo ka shprehur dëshirë për njërën gjuhë, atëherë nuk është e nevojshme që komunikata e tillë të dërgohet në dy gjuhët.

Në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, ligji i AKP-së parasheh që Dëshmitë e Kërkesave dhe Dëshmitë e Interesit duhet të parashtrihen në gjuhën shqipe ose gjuhën serbe³¹. Kjo megjithatë nuk e pengon Agjencinë që të pranojë një kërkesë në gjuhën angleze pasi që dokumentet e standardizuara dhe formale të komunikimit, ftesat dhe formularët e përgatitur nga AL duhet të krijohen dhe të jenë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.³²

5.2.Njoftimi publik për likuidimin sipas Shtojcës së Ligjit

Brenda dhjetë (10) ditëve të punës³³ nga data e Vendimit për Likuidim, Agjencia do të publikojë Njoftimin [formulari L13] për Likuidim në përputhje me dispozitat për shpallje³⁴:

- 1.në gjuhën Shqipe dhe Serbe në gazetatat me tirazh më të madh në Kosovë;
- 2.në gjuhën serbe në një apo më shumë gazeta në gjuhën serbe që ka shitje të gjerë në Serbi dhe Mal të Zi, nëse Autoriteti i Likuidit e konsideron të nevojshme për të njoftuar kreditorët; dhe
- 3.në ndonjë publikim në gjuhën angleze që ka tirazh të madh në Evropë, atëherë Autoriteti i Likuidimit e konsideron të nevojshme për të njoftuar kreditorët.

Sipas nenit 7.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së:

“2. Njoftimi për likuidim titullohet, me shkronja të mëdha dhe të theksuara të shtypit, “njoftim për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes”, dhe përfshin informatat në vijim:

- 2.1. datën dhe përshkrimin e përgjithshëm të Vendimit për likuidim;
- 2.2. referencë në këtë ligj dhe këtë shtojcë si dhe një përshkrim të përgjithshëm të të drejtave të Personave që kanë Dëshmi të Interesit;
- 2.3. një deklaratë që Autoriteti i Likuidimit administron likuidimin sipas këtij ligji dhe kësaj shtojce;
- 2.4. hollësi lidhur me atë se si të sigurohen formularët për Dëshmi të Kërkesës dhe Dëshmi të Interesit dhe metoda për parashtrimin e Dëshmive të Kërkesës apo Dëshmive të Interesit, bashkë me një indikacion të qartë e të theksuar të afatit për parashtrimin e Dëshmisë të Kërkesës dhe Interesit (“Afati për parashtrimin e kërkesave”);

³¹ Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 50.1

³² Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 50.2

³³ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 7.1

³⁴ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 49

2.5. një deklaratë që vetëm Kreditorët e regjistruar dhe Bartësit e regjistruar të interesit të përcaktuar të tillë në pajtim me këtë ligj dhe këtë shtojcë, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e të hyrave që rezultojnë nga likuidimi i Ndërmarrjes, si dhe vetëm për aq sa përcaktohet me këtë ligj dhe këtë shtojcë.

2.6. njoftimin që:

2.6.1. saktëson adresën dhe hollësitë tjera të kontaktit që përdoren për parashtrimin e Dëshmime të Kërkesës dhe Dëshmime të Interesit dhe komunikimeve tjera me Autoritetin e likuidimit;

2.6.2. përfshin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashtrojnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularët përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashtrimin e kërkesave, që do të caktohet në 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje;

2.6.3. përfshin një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjithë Personat që pretendojnë të kenë kërkesa apo interesa në apo ndaj ndërmarrjes duhet të veprojnë në pajtueshmëri me kërkesat e saktësuara në njoftim dhe të përsërisin dëshminë e kërkesës apo të interesit; pavarësisht nëse më herët e kanë parashtruar një kërkesë të tillë apo informuar Gjykatën, Agjencinë apo pararendësin e Agjencisë (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit) në lidhje me të;

2.6.4. përfshin një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjitha Kërkesat dhe Interesat që nuk janë parashtruar si duhet deri në Afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë përgjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme; dhe

2.6.5. përfshin një indikacion të qartë se ku dhe si një person mund të sigurojë formularë standard për parashtrimin e Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit."

Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas publikimit fillestar të Njoftimit për likuidim, Agjencia publikon përsëri njoftimin në pajtim me Dispozitat për shpallje. Për të shmangur dyshime, ky publikim i Njoftimit për likuidim nuk ka ndikim në datën dhe kohën e Afatit për parashtrimin e kërkesave, i cili mbetet ai që është saktësuar në njoftimin fillestar.

5.3.Njoftimi publik për likuidimin sipas Udhëzimit të Dhomës së Posaçme

Përfundimisht nga dispozitat ligjore të cekura më sipër për publikimet në gazeta, deri në rifillimin e shtypjes së gazetave ditore në Republikën e Kosovës, do të zbatohen dispozitat e Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër C-IV-20-0059 të datës 15 tetor 2020, në dispozitivin e të cilit Udhëzim thuhet:

1. "AKP udhëzohet që së pari të bëj një spot informues, me qëllim të informimit të palëve të interesit se të gjitha informatat në lidhje me publikimin e njoftimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, nuk do të publikohen më në gazetat e shkruara, por tani e tutje

publikimi i njoftimeve do të bëhet vetëm në mediat televizive dhe në ato elektronike. Spoti informues do të transmetohet në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe dhe RTK 2 në gjuhën serbe si dhe në portalet online, për 5 ditë të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje minimale prej 30 sec me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 - 21:00;

2. AKP udhëzohet që për çdo Njoftim të Fillimit të Procedurës së Likuidimit të NSH-ve dhe publikimit të Listës së Punëtorëve me të drejta legjitime në 20% të të ardhurave nga privatizimi ose likuidimi i NSH-ve, të publikoj njoftimet në lidhje me to në RTK-1 dhe RTK-2 për 5 ditë të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje minimale prej 30 sec me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 - 21:00;
3. Të gjitha shpalljet duhet të lidhen me faqen e internetit të AKP-së; dhe
4. Ky udhëzim mbetet në fuqi deri në ri-fillimin e shtypjes së gazetave ditore në Republikën e Kosovës.”

Në arsyetimin ligjor të Udhëzimit të Dhomës së Posaçme përcaktohet poashtu se “AKP është udhëzuar që njoftimet t’i publikon në tre (3) portale në Republikën e Kosovës në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe, për pesë (5) ditë të njëpasnjëshme dhe t’i referohet faqes së internetit të AKP.”

5.4.Njoftim për kreditorët e njohur

NSHSipas nenit 7.4 të Shtojcës së Ligjit, Autoriteti i likuidimit brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së publikimit të parë Njoftimit për Likuidim në publikimin e specifikuar në Dispozitat për Shpallje, i dërgon me postë një kopje të Njoftimit për likuidim çdo personi që më herët ka informuar me shkrim Agjencinë apo Gjykatën lidhur me Kërkesën apo interesin e pretenduar ndaj ndërmarrjes apo aseteve të ndërmarrjes. Agjencia gjithashtu e përfshin një letër që informon personat e tillë se ata duhet të parashtrojnë Dëshmi të Kërkesës apo Dëshmi të Interesit në pajtim me Njoftimin për likuidim. Dispozitat e këtij paragrafi 4. nuk aplikohen nëse nuk mund të konstatohet lehtë adresa e personit në fjalë apo përfaqësuesit ligjor nga regjistrat e Agjencisë apo të Gjykatës që në mënyrë substanciale ndërlidhen me ndërmarrjen në fjalë³⁵. [Shih Formularin L11], apo që paraqiten në listën e kërkesave (që duhet të merret nga Njësia e AKP-së për kërkesa [Shih Formularin L10], duke kërkuar parashtrimin e të gjitha kërkesave dhe informatave për kreditorit.

Kjo letër, që do të përfshijë kopjen e njoftimit të likuidimit, do të informoj kreditorët që ata duhet të paraqesin Dëshmitë e Kërkesës apo Dëshmitë e Interesit në përputhje me udhëzimet e cekura në letër.

Autoriteti i Likuidimit nuk ka obligim t’i dërgoj letër të tillë kreditorit apo bartësit të interesit, adresa e kujt nuk është shkruar lexueshëm në regjistrat e Agjencisë³⁶ apo regjistrat e Gjykatës që është në lidhje me ndërmarrjen.

³⁵ Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 7.4

³⁶ Në praktikë kjo duhet bërë për të përfshirë shënimet e Agjencisë dhe NSH-së.

Pas njoftimit publik për Likuidimin, mund të pranohen edhe kërkesa tjera kreditore dhe AL duhet të përgjigjet duke konfirmuar pranimin e kërkesës [Shih Formularin L12] dhe i vë në dispozicion të kërkuarit formularin e kërkesës për Likuidim [Shih Formularin L14 dhe L15].

5.5.Njoftimet për teprice teknologjike tek menaxhmenti dhe punëtorët e NSH-së

Sipas nenit 8 të shtojcës së Ligjit të AKP-së, në mesnatën e Datës së Vendimit për Likuidim prishen të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë

Kryesuesi i AL-së do të lëshoj letrën standarde [formulari L07] duke informuar punëtorët për datën e Vendimit të Likuidimit dhe efektet e saj dhe kjo letër do t'i lëshohet secilit punëtorë në shërbim në datën e Vendimit të Likuidimit. Kjo letër do të përfshijë ftesën për të parashtruar kërkesat për pagat e papaguara apo kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës apo ndonjë drejtë tjetër apo kërkesë nga punëtorët.

Të drejtat e punëtorëve në procesin e likuidimit sa i përket pagave të papaguara dhe kompensimit për ndërprerjen e kontratës së punës janë të përfshirë në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

5.6.Njoftimet për institucionet publike

AL është e detyruar të lëshojë një Njoftim për Likuidim te autoritetet publike sipas nenit 19.6 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së: "Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së parë të publikimit të Njoftimit për Likuidim, Kryesuesi i Autoritetit të Likuidimit paraqet njoftim formal në pajtim me nenin 7 dhe 10 të Shtojcës së ligjit bazik në gjykatat përkatëse, Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare, Regjistrin e Pengjeve të Kosovës, Regjistrin e Hipotekave në Kosovë, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, bankën(at) e ndërmarrjes, Administratën Tatimore, Ofruesit e Shërbimeve Publike në nivel Qendror dhe Lokal. Këto organe janë përgjegjëse për të siguruar se kopja e atij njoftimi futet në dosje dhe regjistra të mbajtur nga ta në lidhje me ndërmarrjen apo asetet e saj. Ky njoftim do të përfshin referencë në këtë paragraf (6) dhe obligimin e institucionit në fjalë" [Shih formularin L06]. AL do të përfshijë një kopje të njoftimit në Dosjen për Likuidimit.

Letra standarde për njoftimin e Dhomës së Posaçme është në formularin L17.

5.7.Njoftimi për bankat

Menjëherë, pas emërimit të AL-se, ajo duhet t'i njoftoj bankën³⁷ për Likuidim [Shih formularin L09]. Ky njoftim ka për qëllim anulimin e autoritetit ekzistues të nënshkruesve në bankë(at) duke ndaluar në këtë mënyrë ndonjë transaksion të mëtejshëm të udhëzuar nga Drejtorët e NSH-së.

³⁷ Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 19.6

Bilanci në atë moment duhet të konfirmohet dhe regjistrohet (preferohet një letër nga Banka). AL-ja kërkon që gjendja e kësaj llogarie bankare të transferohet menjëherë në llogarinë bankare në Bankën Qendrore të Kosovës për NSH-në specifike NSH.

Çfarëdo paraje që mund të ndodhet në arkat e NSH-së para se të vendoset në likuidim, duhet të deponohet në llogarinë bankare të likuidimit në Bankën Qendrore të Kosovës për NSH-në.

5.8.Njoftimi për pezullim të veprimeve kundër Ndërmarrjes në likuidim

AL do të aplikoj për pezullimin e veprimeve ligjore kundër NSH-se përderisa këto veprime janë iniciuar nga ndonjë Gjykatë e rregullt në Kosovë. Kur të kërkohej një gjë e tillë në Gjykatën e rregullt, AL do të siguroj informatat e kërkuara sipas Shtojcës të Ligjit të AKP-së [Shih Formularin L16].

Brenda dhjetë (10) ditësh³⁸ pas publikimit të parë të Njoftimit për Likuidim, AL-ja lëshon një njoftim për autoritetet publike të përcaktuar në nenin 10 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe Odën e Përmbauesve për të njoftuar këto për fillimin e procedurave të likuidimit dhe pezullimit të veprimeve sipas nenit 10.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. [shih formularin L16]

Sipas nenit 10.1 të Shtojcës së Ligjit:

1. "Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, përmbaresh, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik, Tribunalin e Arbitrazhit apo Odën e Përmbauesve të Kosovës. Ky njoftim i referohet nenit 10 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim."

Veprimet e pezulluara ose procedurat mund të vazhdojnë dhe të jenë efektive me lejen e AL-së ose gjykatës sipas nenit 10.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Sipas nenit 10.2 të Shtojcës së Ligjit:

"2. Veprimet, procedurat apo aktet e tilla të pezulluara mund të vazhdojnë apo të jenë në fuqi vetëm me leje të Autoritetit të likuidimit apo të Gjykatës. Këto veprime, procedura dhe akte përfshijnë mes tjerash, çdo veprim, procedurë apo akt:

2.1. që ka të bëjë me grumbullimin, kthimin apo zbatimin e Kërkesave për borxhe, taksa, gjopa apo obligime të çfarëdo lloji;

2.2. që ka të bëjë me krijimin, pranimin, modifikimin, rritjen, përmbushjen, regjistrimin apo zbatimin e çdo Kërkese apo Interesi kundrejt Ndërmarrjes apo çdo aseti të ndërmarrjes;

³⁸ Afat i brendshëm i caktuar nga Agjencia.

2.3. çdo akt për realizimin, marrjen nën kontroll apo shitjen e aseteve të lëna peng, të hipotekuara apo që me çdo formë tjetër barre, apo ushtrimi i kontrollit mbi çdo aset të ndërmarrjes; dhe

2.4. procedurat apo veprimet rregullative që kanë të bëjnë me parandalimin apo korrigjimin e shkeljeve të dispozitave rregullative, rregullave apo vendimeve përderisa ato kanë të bëjnë me pretendime monetare ndaj ndërmarrjes.”

Pezullimi i vendimeve dhe procedurave të cekura me lart nuk do të zbatohen në rastet e parapara në nenin 10.3 Shtojcës të ligjit të AKP-së.

Sipas nenit 10.3 të Shtojcës së Ligjit:

“3. Pezullimi i veprimeve, procedurave dhe akteve nuk aplikohet në:

3.1. veprimet gjyqësore që në emër të ndërmarrjes drejtohen kundër palëve të treta;

3.2. procedurat penale ndaj ndërmarrjes apo një apo më shumë anëtarëve të Menaxhmentit të saj;

3.3. transferimet apo disponimi me asetet e ndërmarrjes gjatë rrjedhës së rregullt të punës së ndërmarrjes, përfshirë transaksionet e përcaktuar në këtë Ligj dhe në veçanti në nenin 10;

3.4. procedurat apo veprimet rregullative që kanë të bëjnë me parandalimin apo korrigjimin e shkeljeve të dispozitave rregullative, rregullave apo vendimeve, nëse ato nuk përfshijnë pretendime monetare ndaj ndërmarrjes; dhe

3.5. inspektimet dhe kërkesat për inspektim të parashtruara nga bartësit e hipotekave të regjistruara, garancive të vërteta apo pengjeve të ngjashme që kanë të bëjnë me asetet e ndërmarrjes.”

5.9.Njoftimi për pezullim të veprimeve të Përmbaruesve kundër NSH-së në likuidim

Në mënyrë specifike, sa i përket Urdhërave Përmbarimor të Përmbaruesve Privat, me qëllim të ruajtjes së aseteve në mirëbesim të NSH-ve në likuidim dhe zbatimit të plotë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, AKP me datën 6 tetor 2015 i është drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (“Dhoma e Posaçme”), e cila është gjykatë me kompetencë ekskluzive sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me AKP-në dhe Ndërmarrjet Shoqërore. AKP ka kërkuar udhëzim në lidhje me atë se a kanë të drejtë gjykatat përmbarimore, përmbaruesit privat dhe institucionet bankare të Republikës së Kosovës të ekzekutojnë pagesa nga fondet në mirëbesim të NSH-ve të cilat janë në procedurë të likuidimit.

Më 16 tetor 2015, AKP ka pranuar nga Dhoma e Posaçme Udhëzimin C-IV-15-1607 të datës 15 tetor 2015 i cili në dispozitiv të tij thotë:

- I. **“Nga data e parashtrimit të njoftimit të vendimit për likuidim, e deri në përfundim të likuidimit PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i vendimit për likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbaremore të vendimeve të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare.”**
- II. **Pezullimi i procedurave nuk aplikohet në rastet e parapara me paragrafin 3 të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në; dhe**
- III. **Procedurat e Pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhoma e Posaçme”.**

Në këtë Udhëzim Dhoma e Posaçme ka konstatuar poashtu se:

- Ligji për AKP-në është Ligji i Posaçëm (Lex Speciales) që zbatohet për rastet e tilla dhe përjashton zbatimin e të gjitha ligjeve tjera të përgjithshme (neni 31 paragrafi 1 i Ligjit të AKP-së).
- Zbatimi i ligjit të AKP-së është i obligueshëm jo vetëm për AKP-në, por edhe për të gjitha institucionet e tjera, përfshirë edhe bankat si dhe përmbareuesit privat;
- AKP ka për detyrë që me rastin e pranimit të propozimeve të tilla kundër NSH-ve që janë në likuidim, të reagoj në kuadër të autorizimeve dhe kompetencave ligjore që i ka.

Duke u bazuar në Udhëzimin nr. C-IV-15-1607 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AKP më 13 nëntor 2015 e ka njoftuar Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) lidhur me Udhëzimin nr. C-IV-15-1607 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe ka kërkuar nga Banka Qendrore e Kosovës që të mos ekzekutoj kërkesat e Përmbareuesve Privat për transferim të parave në mirëbesim të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë në procedurë të likuidimit pa Urdhër-Transfer të autorizuar nga Agjencia apo Urdhër të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Në tetor 2015 janë njoftuar edhe të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë, Oda e Përmbareuesve të Kosovës, Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë.

5.10. Veprimet e Agjencisë pas dijenisë për Urdhërat Përmbareimor

Secili zyrtar i AKP-së që vie në dijeni se një Urdhër Përmbareues është dërguar në Bankën Qendrore të Kosovës për ekzekutim nga fondet e Ndërmarrjes Shoqërore në likuidim apo Urdhërat Përmbareues që janë dërguar në Thesarin e Kosovës për ekzekutim ndaj buxhetit të AKP-së e që ndërlidhen me Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim, është i obliguar që menjëherë të njoftoj Autoritetin e Likuidimit (Kryesuesin dhe Anëtarët e AL-së), Departamentin Ligjor të AKP-së, Departamentin e Financave dhe Buxhetit të AKP-së dhe Menaxhmentin e AKP-së, të cilët në

koordinim do të përgatitin hapat e duhur për kundërshtimin e veprimeve të tilla në kuadër të autorizimeve dhe kompetencave ligjore.

Shkresat për Thesarin e Kosovës i nënshkruan Drejtori Ekzekutiv i AKP-së.

Për çështjet që ndërlidhen me vendimet për kërkesat kreditore, Kryesuesi i AL-së i nënshkruan shkresat për Gjykatën, Bankën Qendrore të Kosovës, Përmbauesin Privat dhe Odën e Përmbauesve.

Për çështjet që nuk bijnë në domenin e kërkesave kreditore, shkresat në Gjykatë i nënshkruan Departamenti Ligjor, ndërsa shkresat për institucionet tjera i nënshkruan Drejtori Ekzekutiv.

Në rastet e urdhërave përmbaresh nga Përmbauesi Privat, AKP-ja si administratore e NSH-ve, në bashkëveprim të ngushtë me AL-të, duhet të veprojë ex-officio në çdo kohë dhe pa vonesa, në pajtim me legjislacionin e përgjithshëm dhe të veçantë që ka të bëjë me çështjet kreditore, duke vepruar në harmoni me nenin 29 të ligjit për AKP-në dhe nenet 21, 22, 24, 27, 38 dhe 40 të Ligjit të Procedurës Përmbareshore nr. 04/139, por pa u kufizuar vetëm në këto dispozita.

Ushtrimi i mjeteve juridike duhet të bëhet brenda afateve ligjore si: kundërshtimi (prapësimi), ankesa dhe veprimet tjera juridike kundër propozimeve për përmbaresh të Përmbauesve Privat. Mjetit juridik të ushtruar ndaj propozimit për përmbaresh gjithsesi duhet t'i bashkëngjiten vendimi për hyrjen e NSH-së në likuidim, dëshmi tjera shtesë dhe shkresat tjera përcjellëse, ndërsa përmbauesit privat me anë të prapësimit t'i kërkohet: nxjerrja e aktvendimit për ta ndërprerë procedurën e përmbareshit.

Neni 6

MBLEDHJET E KREDITORËVE DHE KOMITETET E KREDITORËVE

Takimet e kreditorëve, mbrojtja e interesit të kreditorëve dhe takimet si dhe komisionet e kreditorëve janë të rregulluara me nenet 24, 25 dhe 26 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

M.H.

Neni 7 **ÇËSHTJE OPERACIONALE TË LIKUIDIMIT**

7.1. Sigurimi i librave dhe dosjeve

Ruajtja e sigurt e librave dhe dosjeve është çështje thelbësore për Likuidimin. Kjo është për arsye se "memoria e korporatës" humbet shpejt për shkak se menaxhmenti i NSH-ve dhe punëtorët e NSH-ve largohen apo pushohen nga puna.

Arkiva e NSH-ve në likuidim mbahet në vendet e përcaktuara për arkivim në zyret rajonale. Zyrtari i Rastit dhe Kryesuesi i AL-së janë përgjegjës për t'u siguruar se arkivat mbahen sipas ligjit.

Në Zyrën Qendrore të AKP-së ekziston Divizioni i Protokollimit dhe Shkresave Gjyqësore – Departamenti i Administratës në të cilën mbahen dosjet, ku janë të regjistruara pjesa dërmuese e kërkesave të paraqitura para se të vendosen ndërmarrjet në procesin e likuidimit.

Pas vendosjes së NSH-së në likuidim, AL-ja kërkon që këto kërkesa të regjistruar të shikohen për t'u krahasuar me kërkesat e pranuar pas publikimit të njoftimit të Likuidimit.

Kërkesat e pranuar para Datës së vendimit për likuidim nuk janë të pranueshme në likuidim, përveç nëse ato janë parashtruar përsëri pas Datës së vendimit për likuidim.

Nëse nevojitet këshilla ligjore për ndonjë çështje të caktuar gjatë procesit të likuidimit, AL-ja mund të kërkojë këshillë nga Departamenti Ligjor i AKP-së.

7.2. Llogaria bankare e likuidimit në BQK

Menjëherë, pas emërimit të AL-së, Zyrtari i Rastit duhet të kërkojë nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit të AKP-së hapjen e llogarisë bankare të Likuidimit. Kjo kërkesë duhet të përmbajë emrin e saktë të NSH-së, numrin e regjistrimit të gjykatës, regjionin dhe qëllimin e llogarisë. Hapja e llogarisë bankare bëhet pas plotësimit të formularit për hapjen e llogarisë bankare të përpiluar nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit i AKP-së.

Në këtë llogari bankare do të depozitohen të gjitha fondet e NSH-së (pa marr parasysh a janë fituar nga shitja e pasurive të NSH-së, të ardhurat e qirasë apo nga llogaritë bankare dhe paratë e gatshme të mbajtura në NSH në fillim të likuidimit) dhe nga e cila do të paguhet të gjitha shpenzimet e likuidimit, pagesat për kreditorët dhe fondet e likuidimit që i transferohen Fondit të Konsoliduar të Repulikës së Kosovës. Të gjitha të ardhurat e NSH-së në likuidim të përfituara nga "prona e ndërmarrjes në likuidim" (neni 27 i Shtojcës së Ligjit) do të mbahen në këtë llogari bankare.

Të gjitha transaksionet financiare në llogarinë bankare të likuidimit do të kryhen në pajtueshmëri me Procedurat Bankare të miratuara nga Bordi, politikat e Agjencisë dhe do të monitorohen nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit i Agjencisë.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit raporton çdo muaj për çështjet në vijim të llogarive bankare në likuidim:

1. Raporti - **Pasqyra e Llogarisë së NSH-së** – ofron përmbledhjen e të gjitha hyrjeve dhe pagesave për NSH-në përkatëse;
2. Raporti - **Pasqyra e Buxhetit** kundrejt shpenzimeve për NSH-në përkatëse – ofron përmbledhjen e pagesave për kodet dhe buxhetit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve;
3. Raporti - **Detaje të hyrjeve dhe daljeve të pagesave** nga llogaria e NSH-së në likuidim – ekstrakti bankar për të gjitha transaksionet nga llogaritë e NSH-ve në likuidim; dhe
4. Raporti - Detaje të pagesave të realizuara nga llogaria e tarifës administrative për NSH-të përkatëse – ekstrakti bankar për të gjitha transaksionet e llogarisë së tarifës administrative për NSH-të përkatëse.

Të gjitha të dhënat janë në formatin MS Excel dhe përmes vendosjes së kodit rajonal të NSH-së gjenerohen raportet përkatëse, por edhe kartelat bankare. Shtegu i raporteve të vendosura është:
T:\Liquidation\Finance and Budget Department Reports.

7.3. Vijueshmëria e aktiviteteve afariste

Nëse NSH-ja ka një aset që është dhënë me qira dhe qiramarrësi largohet, duke i mbetur kështu Autoritetit të Likuidimit të vendos nëse do të vazhdoj qiradhënia e asetit apo do të mbyllet asetit. Aktivitetet afariste të ndërmarrjes në likuidim do të vazhdojnë vetëm me lejen e Autoritetit të Likuidimit.

Në rast se NSH-ja në likuidim ka aktivitete operative (NSH Tregu, Ndërmarrja e Re Grand Hotel, NSH Kinemaja ABC, NSH Rilindja Shtypshkronja apo ndonjë NSH tjetër), situata duhet të mbikëqyret për së afërmi nga AL-ja dhe çdo indikacion se veprimtaria mund të pësoj humbje për NSH-në në Likuidim, e detyron AL-në që të konsultohet menjëherë me Menaxhmentin e AKP-së për të kërkuar udhëzime mbi veprimet që duhen ndërmarrë.

7.4. Pranimi ose refuzimi për vazhdimin e kontratave³⁹

Sipas nenit 20.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Autoriteti i Likuidimit mund të pranoj apo të refuzoj kontratat e lidhura nga ndërmarrja para datës së Vendimit për Likuidim të cilat ende nuk janë përmbushur në tërësi nga pala tjetër, me kusht që refuzimi i Autoritetit të Likuidimit i kontratës së tillë i jep palës tjetër mundësi për të parashtruar Kërkesa të pasiguruara për dëme, ndërsa kërkesa e tillë kategorizohet dhe ka prioritetin të specifikuar sipas nënparagrafit 1.7 të paragrafit 1 të nenit 40 të kësaj Shtojce.

³⁹ Neni 20 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Nëse Autoriteti i Likuidimit pranon një kontratë, dhe më vonë Autoriteti i Likuidimit e refuzon atë kontratë, pala tjetër ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për kompensim të dëmeve, e cila do të kategorizohet si Kërkesë për Shpenzime Administrative dhe ka prioritetin që i caktohet sipas pikës 1.3.5. të nën-paragrafit 1.3. të paragrafit 1. të nenit 40.

7.5.Paradhënie e parave të imëta

Posa të filloj Likuidimi, do të ketë nevojë të mbulohen disa shpenzime të cilat mbulohen nga paratë e imta. Për NSH-të në likuidim të cilat ende mbajnë disa aktivitet operative, lejohen të mbahen vetëm paratë e imta për operim të përditshëm. Për këto NSH lejohen nga një Avans për Para të Imta, ndërsa për të gjitha NSH-të tjera në likuidim, Zyra Rajonale përkatëse e plotëson Kërkesën për Para të Imta për të gjitha ato NSH përkatëse.

AL-ja duhet të deponoj në llogarinë bankare të likuidimit të NSH-së çfarëdo paraje të gatshme të mbajtur nga NSH-ja në fillim të likuidimit. NSH.

Kujdes duhet pasur gjatë vizitës së parë në lokalet e NSH-së për të kërkuar konfirmimin e kërkesës lidhur me shumën dhe vendndodhjen e parasë së gatshme në (ose jashtë) lokalit/zyres së NSH-së. Kur të jenë identifikuar shumat të konsiderueshme të parasë së gatshme, është e rëndësishme të shprehet dyshimi për burimin si dhe arsyetimi nga Menaxhmenti i NSH-së se për çfarë arsye fondet janë ruajtur në lokale/zyre ose në kujdes të menaxherëve ose punonjësve të NSH-së.

Për tërheqjen e avansit për para të imta do të përdoret formulari i përcaktuar nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit.

7.6.Menaxhimi i të hyrave ditore dhe të aktiviteteve me arkëtimet me para në dorë

1. Të gjitha të hyrat e Ndërmarrjes Shoqërore në likuidim të cilat vijnë nga arkëtimet me para në dorë (para të imta) nëpërmjet arkës, Ofruesi i Shërbimeve apo arkëtari, duhet t'i raportoj nëpërmjet një memorandumit të detajuar e të nëshkruar dhe të dorëzohet ditën pasuese pranë Zyrtarit të Rastit. Vërtetësia e të hyrave duhet të verifikohet nga Ofruesi i Shërbimeve - Mbikqyrës, i cili duhet të konfirmoj saktësinë e të hyrave përmes nënshkrimit të memorandumit të njëjtë.

2. Deri në fund të ditës pasuese, Ofruesi i Shërbimeve - arkëtari, duhet të depozitoj të gjithë shumën e të hyrave ditore pranë llogarisë bankare të Ndërmarrjes në likuidim si dhe të informoj Zyrtarin e Rastit në lidhje me shumën e depozituar duke i siguruar dhe një kopje të vërtetimit bankar në lidhje me depozitimin e parave.

3. Asnjë shpenzim nuk mund të kryhet nga Ofruesit e Shërbimeve nëpërmjet parave të arkës. Çdo parashikim për furnizime/shpenzime të nevojshme për mbarëvajtjen e aktiviteteve ditore të Ndërmarrjes, duhet të depozitohet nëpërmjet një kërkesë të detajuar pranë Zyrtarit të Rastit, i cili do të menaxhoj aktivitetin e furnizimeve/shpenzimeve të kërkuara. Shpenzimet nga Paratë e Imta do të bëhen vetëm me autorizim të Zyrtarit të Rastit, i cili do të ngarkohet me një shumë përkatëse në bazë të procedurave të brendshme të AKP-së.

4. Në asnjë rast, pa pëlqim paraprak nga Zyrtari i Rastit dhe Kryesuesi i Autoritetit të Likuidimit, Ofruesi i Shërbimeve nuk duhet të delegoj aktivitetet e mësipërme te ndonjë person tjetër, qoftë një tjetër Ofrues i Shërbimeve, zyrtar i Autoritetit të Likuidimit apo zyrtar i AKP-së.

5. Në rast të devijimit nga aktivitetet e mësipërme, atëherë Ofruesi i Shërbimeve duhet të informojë menjëherë me shkrim Zyrtarin e Rastit, Kryesuesin e Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxherin e Zyrës Rajonale.

7.7.Njoftimi për likuidim të të gjitha palët e treta

Të gjitha dokumentacionet që dalin nga AL-ja në lidhje me Likuidimin duhet të përmbajnë referencën që NSH-ja është në Likuidim, datën e vendosjes në likuidim, së bashku me adresën dhe numrat kontaktues të ZR-së.

7.8.Tatimi në pronë nga data e fillimit të likuidimit

Pagesat e faturave për Tatimin në Pronë për periudhën nga data e fillimit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore vlen vetëm për faturat e Tatimit në Pronë nga data e fillimit të likuidimit për një ndërmarrje shoqërore të caktuar në likuidim.

Detyrimet për Tatimin në Pronë për periudhën para vendosjes së NSH-së në likuidim trajtohen si kërkesa kreditore nëse komunat kanë paraqitur kërkesa kreditore brenda afatit ligjor.

Detyrimi për Tatim në Pronë sipas kërkesave kreditore të dorëzuara nga komunat gjatë procesit të hyrjes së ndërmarrjes në likuidim, është një tregues i detyrimeve të mundshme të Tatimit në Pronë që ndërmarrjet mund të kenë edhe në vijim pas hyrjes së ndërmarrjes në likuidim e që konsiderohen shpenzime operative të NSH-së në likuidim sipas paragrafit 1.1.3.4 të nenit 40 të Shtojcës së ligjit për AKP-në.

Detyra e secilit Zyrtar të Rastit është që të analizoj secilën ndërmarrje që ka në menaxhim dhe të identifikoj detyrimet e mundshme të Tatimit në Pronë pas hyrjes së ndërmarrjes në likuidim, kjo duke bashkëpunuar me komunat respektive, duke shkëmbyer informacionet, duke kontrolluar faturat e ardhura prej komunave, duke kontrolluar pagesat e mundshme që ndërmarrja ka kryer gjatë procesit të likuidimit, duke kontrolluar vlefshmërinë e një detyrimi të tillë (psh. nëse ndërmarrja ka pranuar një faturë të vitit 2010 për një aset që është shitur në vitin 2009 apo që nuk është në inventar të ndërmarrjes, atëherë kjo faturë nuk duhet të konsiderohet e vlefshme) etj.

Secili Zyrtar i Rastit në koordinim të ngushtë me Kryesuesin e Autoritetit të Likuidimit të ndërmarrjes përkatëse në likuidim duhet që në procesin e kontrollimit dhe verifikimit të faturave të Tatimit në Pronë të ndërmarr të gjitha veprimet e listuara më poshtë dhe jo vetëm ato, por edhe të tjera varësisht nga rasti dhe situata:

1. Të kontrolloj me saktësi të gjitha faturat e tatimit në pronë;
2. Të kontrolloj dhe krahasoj datën e faturës së tatimit në pronë;
3. Data e fillimit të likuidimit;

4. Të kontrollohen datat e shitjes së aseteve-objekteve përkatës duke u krahasuar me datën dhe periudhën e faturës;
5. Të kontrollohen shumat - vlerat duke specifikuar qartë, vlera bazë e faturës dhe interesi;
6. Të krahasohen me zyrat përkatëse komunale; dhe
7. Të monitorohet të paktën në çdo tre muaj pagesat e tatimit në Pronë edhe për asetet e lëshuara me qira, të kontrollohen periudhat e faturimit të tatimit në pronë me periudhat e kontraktuara me qiramarrësit.

Qëllimi final i kësaj detyre është që AKP-ja të ketë një pasqyrë të detajuar dhe të qartë për secilën ndërmarrje se sa është vlera detyrimeve për Tatimin në Pronë pas fillimit të procesit të likuidimit dhe pagesa e tyre me kohë.

I tërë ky proces duhet të udhëhiqet dhe monitorohet për së afërmi nga Udhëheqësit e Ekipave të Likuidimit në zyrën rajonale përkatëse.

7.9. Tatimi mbi vlerën e shtuar

AL-të duhet të sigurohen nëse NSH-të pas vendosjes në likuidim të mund të vazhdojnë aktivitete dhe si rrjedhojë të inkasojnë të hyra, të tilla si qiraja apo ndonjë aktiviteti tjetër me çka mund të obligoj NSH në deklaratimet mujore të TVSh'së për këto të hyra. Rrjedhimisht për këto raste, AL-të duhet të sigurojnë mbajtjen e certifikatës si deklarues i TVSh.

Nëse NSH nuk është deklarues i TVSh, por pas hyrjes në likuidim, AL duhet të aplikoj për t'u bërë deklarues i TVSh në rast se qarkullimi vjetor i aktiviteteve të sipërpërmendura tejkalon shumën prej 30,000EUR. Kjo në përputhje me nenin 6.1 të ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Të hyrat nga shitja e aseteve në likuidim dhe shitja e aksioneve të Ndërmarrjeve të Reja nuk llogariten si aktivitete ekonomike dhe në pajtim me nenin 8 dhe nenin 9 të ligjit bazik nuk i nënshtrohet Tatimit mbi Vlerën e Shtuar⁴⁰.

Pretendimet për TVSh për periudhën para se NSH të vendoset në likuidim mund të trajtohen vetëm me kërkesë kreditore që duhet të paraqes ATK-së në përputhje me procedurat e likuidimit të NSH-ve.

AL-të duhet sigurohen se shënimet e paraqitura në librat e ATK-së për detyrimet e TVSh janë të duhura dhe të shikoj për rastet që janë deklaruar por që në sistemin e tyre figurojnë të papaguara, për shkak se shpesh ndodh që ATK pagesat nuk i ka të regjistruara.

Për të hyrat që rrjedhin pas vendosjes së NSH-së në likuidim, AL-të duhet të bëjnë deklaratimet mujore të TVSh dhe paguaj brenda afatit ligjor të përcaktuara sipas ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

⁴⁰ Ligji i AKP-së, Neni 22.2.

Borxhi i NSH-së për TVSH duhet të krahasohet me përmbledhjen e ATK-së dhe duhet pasur kujdes që të sigurohet se përmbledhja e detyrimeve të pranuar në Likuidim (përfshirë TVSH-në) përjashton çdo detyrim të transferuar në privatizim tek një palë e tretë⁴¹.

7.10. Vulat dhe çelësat e arkivit

Nëse nuk janë mbledhur vulat dhe çelësat e arkivit të NSH-së gjatë “periudhës së tranzicionit”⁴² kjo duhet të kryhet menjëherë me rastin e fillimit të Likuidimit.

7.11. Obligimet shërbyese të Ofruesve të shërbimeve publike

Ofruesi i shërbimeve publike⁴³ nuk mund të ndryshoj, refuzoj apo ndërpres shërbimet e tij për një ndërmarrje për shkak që Bordi ka miratuar Vendim për fillimin e Likuidimit për ndërmarrjen në fjalë apo që prek atë.

Nëse Vendimi për Likuidim është miratuar, Ofruesi i shërbimeve publike nuk mund të ndryshoj, refuzoj apo ndërpres shërbimet e tij për ndërmarrjen për shkak që kjo ndërmarrje nuk ka paguar shërbimet e ofruara para datës së Vendimit për Likuidim. Ndërmarrja do të obligohet t'i paguaj shërbimet publike të ofruara pas datës së Vendimit për likuidim.

7.12. Raportimi i përgjithshëm vjetor për likuidimin

Sipas nenit 17 të Shtojcës së Ligjit, Autoriteti i Likuidimit publikon raporte të përgjithshme vjetore lidhur me mbarëvajtjen e likuidimit që përmbajnë së paku informatat në vijim:

1. listën e pronave të shitura, transferuara apo të zgjidhura në mënyra tjera;
2. listën e pranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme;
3. indikacion, nëse ka, të përfundimit të mundshëm të likuidimit; dhe
4. shpjegim të të gjitha çështjeve që zvarritin përmbylljen e rastit të likuidimit.

Struktura e raportimit të përgjithshëm vjetor të likuidimit përcaktohet nga Menaxhmenti i Agjencisë.

⁴¹ Si rregull në privatizimin e një NSH-je detyrimi neto i papaguar i TVSH-së së NSH-së, duke mos përfshirë interesin dhe ndëshkimet të dala gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) muajsh që mbaron në datën e përfundimit të privatizimit janë transferuar nga NSH-ja në një Ndër të Re.

⁴² Periudha e NSH-së para vendosje në procedurën e likuidimit.

⁴³ Sipas nenit 2 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike: “Ndërmarrje Publike” ose “NP” është term i përgjithshëm që nënkupton dhe përfshin të gjitha ndërmarrjet e përcaktuara në listat të cilat i janë bashkangjitur këtij ligji, duke përfshirë ndryshimet në këto lista të cilat bëhen nga Qeveria në përputhje me nenin 3.3 të këtij ligji.”

Raportet e përgjithshme vjetore të likuidimit publikohen në faqen e internetit të AKP-së.

Neni 8 DISA ÇËSHTJE SPECIFIKE PËR ASETET

8.1. Asetet në duar të palëve të treta⁴⁴

Ligji i AKP-së ka dispozita specifike për AL-në për të kërkuar dorëzimin e aseteve që janë mbajtur në kujdes të palëve të treta.

Sipas nenit 19.3 të Shtojcës së Ligjit, Autoriteti i Likuidimit lëshon njoftim për palët e treta që mbajnë apo kanë në posedim asete të ndërmarrjes duke kërkuar që ajo palë e tretë të ndërpresë posedimin dhe të dorëzojë asetet te Autoriteti i Likuidimit. Nëse është e nevojshme, Autoriteti i Likuidimit, në emër të Agjencisë, kërkon nga Gjykata urdhër për zbatimin e kësaj kërkesë. Nëse aset i në fjalë gjendet jashtë Kosovës, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë nga një gjykatë tjetër që ka juridiksion mbi asetet dhe autoritet të zbatojë këtë kërkesë, apo Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë që Gjykata të lëshojë kërkesë për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar sipas paragrafit 2 të nenit 27 të Ligjit të Dhomës së Posaçme⁴⁵. Nëse zbatimi i kësaj kërkesë dëshmohej të jetë i pasigurt, jopraktik apo jo i shpejtë, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtojë kërkesë me shkrim në Gjykatë, sipas paragrafit 4 të nenit 19 (të Shtojcës së Ligjit të AKP-së), për autoritetin për të hequr dorë apo zgjidhur në mënyra tjera interesin e ndërmarrjes ndaj asetit.

Sipas nenit 19.4 të Shtojcës së Ligjit, nëse prona e ndërmarrjes gjendet në shtete tjera dhe nuk mund të realizohet, Autoriteti i Likuidimit kërkon nga Gjykata leje për të hequr dorë nga kjo pronë. Agjencia krijon regjistër të pronave të hequra dorë dhe këtë pronë e dorëzon te Shteti i Kosovës që të mbahet në mirëbesim. Nëse një pronë e ndërmarrjes në shtetet tjera realizohet nga qeveria e Kosovës, të hyrat nga ajo shitje e pronës do të transferohet te Agjencia për t'u mbajtur në mirëbesim për përfitim të përgjithshëm të kreditorëve të regjistruar dhe bartësve të regjistruar të interesit në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Për këtë qëllim, Autoriteti i Likuidimit mban regjistër të pronave të hequra dorë të ndërmarrjes dhe ekstrakti i këtij regjistri do t'i bashkëngjitet raportit final të Autoritetit të Likuidimit në mbyllje të rastit.

8.2. Mallrat në tranzit⁴⁶

1. Nëse mallrat që i janë shitur ndërmarrjes janë në transit në momentin e Vendimit të Likuidimit, dhe ndërmarrja ende nuk ka fituar të drejta pronësore mbi ato mallra, shitësi mund të kërkojë kthimin e mallrave, gjersa shitësi bart të gjitha shpenzimet e lidhura me kthimin, si dhe ripaguan paradhëniet e bëra nga ndërmarrja.

⁴⁴ Neni 19.3 i Shtojcës së Ligjit.

⁴⁵ Nga data 13 korrik 2019, në rast të zbatimit të nenit 19.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, duhet referuar neni 27 të Ligjit nr. nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, publikuar në Gazetën Zyrtare më 27 Qershor 2019, në fuqi nga 13 korrik 2019, e jo më neni 19.2 të Shtojcës së Ligjit të vjetër të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 06/L-086.

⁴⁶ Neni 29 i Shtojcës së Ligjit.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, Autoriteti i likuidimit mund të kërkojë dorëzimin e mallrave, nëse Autoriteti i Likuidimit detyron ndërmarrjen të paguaj tërë shumën kontraktuese të transaksionit.

8.3.Prona e mbajtur në emër të palëve të treta⁴⁷

Prona e mbajtur në emër të palës/personit të tretë nuk është pronë e ndërmarrjes në likuidim dhe pronarët ligjor kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e pronës së tyre.

1. Nëse ndërmarrja është agjent apo broker i një pale të tretë të autorizuar të pranojë apo shesë pronat në pronësi të palëve të treta, ajo palë mund të shfuqizojë statusin si broker apo administrues dhe të kërkojë kthimin e pronës së mbajtur në kujdestari të ndërmarrjes, duke dorëzuar një kërkesë me shkrim në lidhje me të te Autoriteti i Likuidimit.

2. Nëse në kohën e kërkesës për kthim të pronës është i pamundur kthimi i tërë apo një pjese të pronës të mbajtur në kujdestari të ndërmarrjes në emër të palës së tretë, pala e tretë ka të drejtë të parashtojë kërkesë në çmim të kontratës. Nëse është i pamundur përcaktimi i çmimit kontraktues, në fuqi do të jetë çmimi i shitjes sipas Vendimit për Likuidim.

3. Nëse gjatë kohës së kërkesës për kthim të pronës ndërmarrja posedon pronë që duhet shitur mirëpo specifikat e saj i nënshtrohen rënies së shpejtë dhe drastike në vlerë, siç është rasti i mallrave të prishshme, pronari ka të drejtë të parashtojë kërkesë për çmimin kontraktues të pronës.

4. Çdo pronë e kthyer sipas këtij neni ekzekutohet në shpenzim të personit që ka kërkuar kthimin.

8.4.Çështje kadastrale

AL-ja duhet të hetoj të gjitha aspektet e çështjeve kadastrale që ndërlidhen me asetet e mbetura të NSH-së. Të dhënat e ZR-së për tërë ngastrat e tokës që janë në posedim në NSH-së duhet të identifikohen në mënyrë të duhur dhe të harmonizohen me të dhënat kadastrale. AL duhet të sigurohet që të gjitha ngastrat e tokës në posedim të NSH-së janë identifikuar siç duhet dhe regjistruar në librat kadastrale.

Nëse AL-ja zbulon/identifikon që asete të caktuara në posedim të një NSH-je në likuidim nuk janë regjistruar ende në kadashtër në emër të NSH-së së tillë, AL-ja duhet të kërkojë dëshmi ligjore në bazë të së cilës AL-ja mund të regjistroj asetet e tilla në emër të NSH-së në fjalë. Atëherë kur dëshmitë e tilla ligjore nuk janë në dispozicion, AL-ja edhe më tej mund të likuidoj/shes asetet në fjalë, shitje e cila realizohet përmes rregulloreve të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

⁴⁷ Neni 30 i Shtojcës së Ligjit.

Në rastet kur prona në kadastër evidentohet në emër të një ndërmarrje, por kjo pronë është në posedim faktik të një ndërmarrje tjetër shoqërore, Kryesuesit e AL-ve të NSH-ve përkatëse e nënshkruajnë marrëveshjen për bartjen e pronës nga një NSH te NSH-ja tjetër dhe e njëjta me dokumentet përcjellëse dërgohet për miratim në Bordin e Drejtorëve. Zyrtari i Rastit e dërgon Kërkesën për regjistrim në emër të ndërmarrjes shoqërore përkatëse në zyrën kadastrale komunale për Regjistrim të pronës duke e bashkëngjitur Vendimin e Bordit për bartjen e pronës dhe marrëveshjen ndërmjet Kryesuesve të AL-ve.

8.5. Anulimi i transaksioneve⁴⁸

1. Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit apo të një kreditori apo bartësi të interesit, Gjykata nxjerr urdhër për anulimin e çdo transferi, transaksioni apo kontrate që përfshin apo prek asetet apo kapitalin e ndërmarrjes të fituar gjatë periudhës 22 mars 1989 deri në datën e Vendimit për Likuidim⁴⁹ (dhe hedh poshtë çdo Dëshmi të Kërkesës apo Dëshmi të Interesit të bazuar në të), nëse, duke pasur parasysh dëshmitë në dispozicion dhe rrethanat e asaj kohe, Gjykata përcakton në mënyrë të arsyeshme se ai transfer, transaksion apo kontratë, apo pagesat apo furnizimet në lidhje me të:

- 1.1. janë bërë në vlerë më të vogël sesa vlera e drejtë;
- 1.2. kanë ulur vlerën totale të aseteve të ndërmarrjes;
- 1.3. kishin për qëllim apo për pasojë dëmtimin e interesave të kreditorëve;
- 1.4. kishin qëllim apo rezultuan në humbje, zvarritje apo pengim të aftësisë së kreditorëve për të mbledhur kërkesa përmes transferimit të aseteve të palë të treta gjersa pala e tretë ishte apo duhej të ishte në dijeni për atë qëllim apo ndikim;
- 1.5. ishin si rrjedhojë e një transaksioni me kreditorin, përmes së cilit kreditori ka fituar më tepër se sesa hisja proporcionale në asetet e ndërmarrjes dhe transaksioni ka ndodhur në kohë kur kreditori duhej të ishte në dijeni se ndërmarrja nuk ishte apo nuk do të ishte në gjendje t'i përmbush obligimet e saj;
- 1.6. ishin në kundërshtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo Rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian lidhur me imponimin e sanksioneve ndërkombëtare, pavarësisht se ajo mund të jetë pranuar më vonë me vendim gjyqësor apo arbitrim; apo
- 1.7. kanë qenë të prira për t'u anuluar apo të qenë të pazbatueshme në bazë të dispozitave të nenit 36 (të Shtojcës së Ligjit) apo një baze tjetër ligjore.

⁴⁸ Neni 21 i Shtojcës së Ligjit.

⁴⁹ Neni 21.1 i Shtojcës së Ligjit.

2. Transferimi për qëllim të këtij neni përfshin çfarëdo mënyre (direkte apo indirekte, absolute apo të kushtëzuar, vullnetare apo jovullnetare) të bartjes ose transferit, shitjes, këmbimit, dhuratës, shpërndarjes, zgjidhjes, lënies peng, hipotekës apo të drejtave të tjera.⁵⁰

3. Gjykata nxjerr vendim për kërkesat e dorëzuara sipas paragrafit 1. jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është dorëzuar kërkesa në Gjykatë dhe një kopje e saj t'jetë dorëzuar Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera sipas udhëzimit nga Gjykata. Çdo palë që kundërshton kërkesat e tilla duhet të parashtojë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi ta kenë marrë kërkesën. Pala që dorëzon kërkesën i ka pesëmbëdhjetë (15) ditë të përgjigjet në shkresën e kundërshtimit.⁵¹

⁵⁰ Neni 21.2 i Shtojcës së Ligjit.

⁵¹ Neni 21.3 i Shtojcës së Ligjit.

Neni 9

PUNA ME KËRKESAT E KREDITORËVE

9.1. Formulari i kërkesës kreditore

AKP-ja posedon me formular standard të kërkesave kreditore, atë të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit (sipas përkufizimeve në nenin 2 paragrafët 1.14 dhe 1.15 të Shtojcës së Ligjit).

Formularët e kërkesës janë dizajnuar për t'iu mundësuar parashtruesve të kërkesës kreditore të ofrojnë informatat e domosdoshme/obligative siç parashihet në nenin 23.1 të Shtojcës së Ligjit. Të gjitha kërkesat kreditore mund të parashtrohen vetëm në formularin standard të AKP-së. Për të ndihmuar parashtruesit e kërkesave kreditore, AKP-ja publikon shënime udhëzuese se si të regjistrohet/dorëzohet një kërkesë kreditore.

Për kërkesat që nuk e kanë arritur afatin e pagesës, për qëllime të dorëzimit të Dëshmisë së Kërkesës, do të konsiderohet se ato e kanë arritur afatin e pagesës që nga data e Vendimit për Likuidim në pajtim me nenin 23.4 të Shtojcës së Ligjit.

Formulari i kërkesës e ka rubrikën për emrin e parashtruesit (me shkronja të shtypura dhe të nënshkruar), natyrën e statusit të parashtruesit të kërkesës (parashtruesi apo përfaqësuesi i parashtruesit) dhe datën e nënshkrimit. Në rast të përfaqësuesit ai/ajo duhet të ofroj dëshmi nën betim nga përfaqësuesi kryesor autorizues. Mungesa e dëshmisë valide të përfaqësimit do ta bëjë kërkesën të pavlefshme.

Kërkesat e bartësit të supozuar të interesit janë të dizajnuara për t'iu mundësuar parashtruesve të kërkesës të ofrojnë informatat minimale obligative siç parashihet në nenin 23.2 të Shtojcës së Ligjit.

9.2. Regjistri i kërkesave kreditore

Brenda dhjetë (10) ditësh pas publikimit të parë të Njoftimit për Likuidim, AL-ja duhet t'i njoftoj të gjithë kreditorët e njohur të NSH-së me shkrim për fillimin e likuidimit se ata duhet të paraqesin Dëshmitë e Kërkesës apo Dëshmitë e Interesit në përputhje me Njoftimin për Likuidim.

Është parim i përgjithshëm i të gjitha sistemeve ligjore që personi që parashtron një kërkesë kreditore në likuidim, atëherë ai e bartë barrën e dëshmisë për të. Në mungesë të kërkesave specifike ligjore për forma të veçanta të dëshmisë, kreditori mund të dëshmojë kërkesën me çdo mënyrë që është e besueshme apo relevante.

Kërkesat e kreditorëve dhe bartësve të supozuar të interesit duhet të regjistrohen nga Autoriteti i Likuidimit brenda katërdhjetë e pesë (45) ditësh që nga data e publikimit të "Njoftimit për Likuidim".

Të gjitha kërkesat e pranuar nga Autoriteti i Likuidimit do të jenë të vullosura me datën dhe kohën e dorëzimit në AKP.

Autoriteti i Likuidimit në pajtim me Nenin 23.6 të Shtojcës 1 të Ligjit, do të mbaj një regjistër të kërkesave dhe dëshmime të interesit. Kërkesat e pranuar nga Autoriteti i Likuidimit do të futen në regjistrin e lart-përmendur dhe prej aty e tutje do të njihen si “Parashtrues të regjistruar të kërkesave”.

Regjistri i kërkesave të kreditorëve dhe bartësve të supozuar të interesit do të jetë në dispozicion për inspektim nga çdo parashtrues i regjistruar i kërkesës, apo nga çdo palë e cila potencialisht ka interes të drejtpërdrejtë financiar në ndërmarrje dhe/ose pasuri të saj.

Afatet kohore për t’u marrë me kërkesa janë të specifikuara në Nenin 37.4 i Shtojcës së Ligjit i cili thotë: “Menjëherë pas Afatit për parashtrimin e kërkesave, Autoriteti i Likuidimit vlerëson vlefshmërinë, shtrirjen dhe prioritetin e kërkesave dhe pengjeve apo kolateraleve të ndërlidhura të paraqitura ndaj Ndërmarrjes dhe njofton kërkuarët në fjalë lidhur me rezultatet e atij vlerësimi”. Fjala “menjëherë” interpretohet si “brenda 60 ditësh” apo periudhë e tillë kohore sipas zgjedhjes së Agjencisë.

Kur të parashtrohet kërkesa, AL-ja duhet të merr parasysh se çfarë dokumente apo të dhënash duhet të ekzistojnë në mënyrë që të vërtetohet kërkesa. Nëse pretenduesi nuk i ka siguruar këto dokumente, atëherë sipas nenit 23.3 dhe 37.5 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkoj informata dhe dëshmi shtesë nëse i konsideron si të nevojshme për ta kryer vlerësimin. Kërkesa për informata shtesë përdoret sipas formularit L19.

Autoriteti i Likuidimit në kërkesën drejtuar pretenduesit për informata ose dokumentacion shtesë, duhet të përfshijë vërejtjen se mosdorëzimi i informatave dhe dokumenteve të kërkuara brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës, do të rezultoj në refuzimin e kërkesës së tij nga Autoriteti i Likuidimit.

AL-ja duhet të shqyrtoj nëse kërkesave iu ka kaluar afati i përcaktuar me ligj, dhe nëse kërkesat e tilla nuk janë sjellë në mënyrën dhe në afatin e duhur në Gjykatën që ka juridiksion ato do të refuzohen dhe nuk do të jenë të kualifikueshme që të marrin pjesë në ndonjë shpërndarje përmes likuidimit⁵². Duhet të merret parasysh se të gjitha kërkesat dhe interesat në procesin e likuidimit të NSH-së që nuk janë parashtruar në mënyrë të duhur brenda afatit për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të mbyllen përgjithmonë si të pazbatueshme⁵³.

⁵² Ligji t AKP –së, Shtojca, Neni 37.4.1

⁵³ Ligji t AKP –së, Shtojca, Neni 7.2.6.4

9.3. Prioriteti i kërkesave kreditore

Caktimi i prioritetit të kërkesave duhet të bëhet në pajtueshmëri me nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në⁵⁴. Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të trajtohen sipas kategorisë dhe priopriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës të Ligjit për AKP-në.

Caktimi i prioritetit të kërkesave është i rëndësishëm. Së pari, kërkesat brenda kategorisë së njëjtë klasifikohen në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh kohën kur kërkesat paraqiten⁵⁵. Së dyti, arsyeja për klasifikim është dhënë në Shtojcën e Ligjit për AKP-në, Neni 41, që parasheh përbushjen e kërkesave kreditore si në vijim:

Kërkesat përbushen sipas kategorisë dhe prioritetit.

Trajtimi i Ankesave dhe interesit që i takojnë rangut pasues me prioritet më të ulët mund të iniciohen vetëm pas trajtimit të plotë të kërkesave nga klasa paraprake me prioritet më të lartë⁵⁶.

Pasi që kërkesat kreditore duhet të trajtohen sipas prioritetit me klasë dhe rend, ndonjë mungesë në likuidim do të rezultojë në nivelin e kreditorëve që pranojnë shpërndarje të më pak se 100% të kërkesave të tyre me kërkesat e prioritetit më të ulët dhe pasues që nuk pranojnë asgjë. AL-ja duhet të jetë e vetëdijshme për këtë informatë të rëndësishme në të gjitha nivelet e likuidimit dhe për të siguruar këtë, AKP-ja ka dizajnuar "Raportin e Rezultatit të Parashikuar" që është integruar në sistemin e menaxhimit të likuidimit.

Në rast se për një nivel të kreditorëve nuk do të mbesin të ardhura, vlerësimi i këtyre kërkesave do të jetë i panevojshëm kështu që puna duhet të përfundojë pasi që faktet të bëhen të njohura.

9.4. Trajtimi i kërkesave kreditore

Menjëherë pas afatit për parashtrimin e kërkesave, AL do të vlerësojë validitetin dhe bazën e kërkesave dhe do të njoftoj pretenduesit për rezultatet e vlerësimit⁵⁷. Nëse kërkesat nuk janë të plota apo dëshmitë kanë mungesa, AL mund të kërkojë informatat dhe dëshmitë shtesë në afat prej 15 ditëve pas pranimit të kërkesës për afat shtesë. Më pas, nëse AL, refuzon, tërësisht apo pjesërisht, apo zvogëlon shumën e kërkesës së parashtruar, do të njoftoj kreditorët me shkrim, duke dhënë shpjegimin për refuzimin apo zvogëlimin e kërkesës.

Vlerësimi i validitetit të secilës kërkesë do të ndodh brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve⁵⁸ nga pranimi dhe kërkuarit do të njoftohen brenda pesë (5) ditësh nga vlerësimi nëse kërkesa është përfshirë në diagramin e borxheve të NSH-së⁵⁹.

⁵⁴ Shtojca Ligji i AKP-së, Neni 40

⁵⁵ Shtojca e Ligjit të AKP –së, Neni 40.2.

⁵⁶ Shtojca e Ligjit të AKP –së, Neni 41.2

⁵⁷ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 37.4

⁵⁸ Afati kohor prej 60 ditësh ka qenë i përcaktuar më parë në politikat operative neni 7.7.5

⁵⁹ Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 37.6.

Vendimi i AL-së do të ketë formën e miratuar në shtojcë të kësaj rregulloreje [Shih formularët vaesisht rastit L20, L21, L22, L23, L24, L25, L26, L27 dhe L28].

Në rast të mungesës apo pamjaftueshmërisë së fondeve të likuidimit për përmbushjen e kërkesave kreditore, në ndërlidhje me nenin 40 dhe 41 të Shtojcës së Ligjit, atëherë përdoret formulari L30.

9.5.Çështje specifike lidhur me kërkesat kreditore

9.5.1. Kërkesat për kamata

Të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së vendimit të likuidimit me kushte që kjo kamatë të mos kalojë 10% të shumës themelore.

9.5.2. Kërkesat në valuta tjera nga ajo e euros

Kërkesat e parashtruara në valutë tjetër jo në Euro do të konvertohen në Euro me anë të normës së këmbimit të datës së Vendimit të Likuidimit. (neni 37.2 i Shtojcës së Ligjit).

9.5.3. Kërkesat për performancë të veçante

AL-ja është e autorizuar për të shndërruar ndonjë kërkesë për performancën e veçantë të kontratës, duke përfshirë por jo të limituar, në një kërkesë për kompensim monetar ⁶⁰.

9.5.4. Precizimi i kërkesave që nuk e kanë arritur afatin e pagesës

Për arsye të parashtrimit të Dëshmisë së Kërkesës, kërkesat që nuk e kanë arritur afatin e pagesës do të konsiderohen të afatshme që nga data e vendimit për likuidim.

9.5.5. Kundërshtimi në tërësi apo pjesërisht i kërkesave

AL ka autoritet të pakufizuar të kundërshtoj kërkesat e parashtruara tërësisht apo pjesërisht bazuar në faktin nëse kërkesa e parashtruar është përmbushur në ndonjë mënyrë tjetër ⁶¹.

9.5.6. Borxhet e dyanshme

Çështja e borxhit të dy anshëm është e rregulluar me dispozitën ligjore të Shtojcës të Ligjit për AKP-në Neni 37.9.3.1 deri 37.9.3.4.

9.5.7. Dispozitat kontradiktore në një kontratë

Dispozitat e nenit 37 (llogaritja dhe kompensimi i kërkesave) të Shtojcës së Ligjit kanë efekt superior mbi dispozitat e mundshme kontradiktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj.

⁶⁰ Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 37.9.1.

⁶¹ Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 37.9.2.

AL ka autorizim të ndryshoj çdo kontratë apo marrëveshje për mënyrën e pagesës, pagesën e kostove dhe interesit ose barazimin/kompensimin e borxheve.

9.6. Bazat për refuzimin e kërkesave në tërësinë e tyre

9.6.1. Kërkesat e parashkruara

Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.⁶²

Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.⁶³

Sa i përket parashkrimit, Autoriteti i Likuidimit duhet t'i referohet në tërësi Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Parashkrimi i disa kërkesave sipas Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në fuqi nga 20 dhjetor 2012, është paraqitur më poshtë:

- Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit (neni 352 i LMD);
- Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. E njëjta gjë vlen për pensionet vjetore me të cilat paguhet shuma kryesore dhe kamata në shuma të barabarta të përcaktuara më parë, por nuk vlen për pagesat në këste ose për përmbushje të tjera të pjesshme. Kamata në kërkesat periudha e parashkrimit e të cilave është më pak se tri (3) vjet, parashkruhen pas kalimit të periudhës së njëjtë si për kërkesën kryesore. (neni 353 i LMD);
- Afati njëvjeçar i parashkrimit të kërkesave është paraparë në nenin 363 të LMD;
- Parashkrimi i kërkesave për shpërblimin e dëmit janë paraparë në nenin 357 të LMD;
- Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale parashkruhen sipas nenit 355 të LMD;
- Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu

⁶² Neni 341 i Ligjit LMD

⁶³ Neni 342 i Ligjit LMD

parashikon afat më të shkurtër për parashkrim. Megjithatë, të gjitha kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujdite të tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, parashkruhen në afatin e paraparë për parashkrimin e kërkesave periodike (neni 361 i LMD).

Koha e cila nevojitet për parashkrim ka qenë e përcaktuar edhe në Ligjin mbi Bazat e Marrëdhënieve të Detyrimeve GZ 29/1978:

- o Kërkesat parashkruhen për 5 vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër (neni 371).

- o Kërkesat për dhënie periodike ato periodike aksesore parashkruhen 3 vjet nga rrjedhja e secilës dhënie (neni 372).

- o Kërkesat reciproke të personave shoqërorë – juridik nga kontrata në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe kërkesat për kompensim të shpenzime parashkruhen për 3 vjet (neni 374);

- o kërkesat për shpërblim nga dëmi i shkaktuar parashkruhen për 3 vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe personin që ka shkaktuar dëmin (neni 376).

- o Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose vendim të organit tjetër kompetent ose pajtimit gjyqësor ose organit tjetër kompetent parashkruhen për 10 vjet (neni 379).

9.6.2. Afati i parashtrimit/dorëzimit të kërkesës

Afati për parashtrimin e kërkesave është përcaktuar në nenin 7 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe bartësve të interesit që t'i parashtrojnë Dëshmitë e tyre të Kërkesës dhe Interesit ⁶⁴.

Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë Dëshminë e Kërkesës apo Interesit të dorëzuar pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave ⁶⁵.

Në rastet e tilla Autoriteti i Likuidimit do të dërgoj kërkesë për arsyetim të vonës në parashtrimin e kërkesës kreditore [formulari L18].

9.7.Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta⁶⁶

1. Pas përcaktimit të pranueshmërisë së kërkesave të ndërlidhura me nenin 23.1.1 dhe të shtojcës së këtij ligji, Autoriteti i Likuidimit merr në shqyrtim dhe refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë meritore të Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse

⁶⁴ Ligji t'i AKP –së, Shtojca, Neni 7

⁶⁵ Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 35.3

⁶⁶ Neni 36 i Shtojcës së Ligjit.

refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës.

2. Pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:

2.1. kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;

2.2. dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese; apo

2.3. ndonjë aspekt i dokumentacionit të paraqitur është mashtrues apo ka dëshmi të mira dhe substanciale për të besuar se Kërkesa apo interesi i pretenduar është mashtrues; apo

2.4. ka arsye për të besuar se transaksion:

2.4.1. nuk është aprovuar përmes procedurave të rregullta të brendshme të Ndërmarrjes;

2.4.2. është ekzekutuar në emër të Ndërmarrjes nga personi pa autoritet të vërtetë ligjor;

2.4.3. nuk do të ishte aprovuar nëse do të ishte parashtruar për aprovim të rregullt të brendshëm, përfshirë edhe kontratat që do të duhej të aprovohej nga Menaxhmenti apo një Zyrtar i Ndërmarrjes në kohën përkatëse, mirëpo të cilat nuk janë aprovuar;

2.4.4. në kohën përkatëse, është lidhur në kundërshtim me obligimin fiduciar apo obligimet tjera ndaj Ndërmarrjes apo palës së tretë nga Menaxhmenti apo Zyrtari sipas ligjit në fuqi në atë kohë; apo

2.4.5. ishte në kundërshtim me rregulloren e nxjerrë nga OKB-ja apo rregullore apo akte të ngjashme të nxjerra nga një organ i autorizuar nga Bashkimi Evropian; dhe, në secilin rast të saktësuar në pikët 2.4.1 – 2.4.5 më lart, kreditori apo kërkuesi i interesit ishin në dijeni apo, gjatë ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm profesional, do të duhej të ishin në dijeni të shkeljes, cenimit apo mungesës së autoritetit në fjalë.

2.5. në kohën që transaksioni është lidhur kreditori ishte në dijeni apo, gjatë ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm profesional, do të duhej të ishte në dijeni se Ndërmarrja ishte insolvente dhe se transaksioni ka rezultuar pasi që kreditori është vënë në pozitë më të favorshme sesa kreditorët e tjerë;

2.6. transaksioni është bërë në vlerë që është materialisht më e ulët sesa vlera aktuale e tregut në atë kohë;

2.7. pagesa apo furnizimi në lidhje me transaksionin ishte në shkelje të një apo më shumë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo Rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian lidhur me imponimin e sanksioneve ndërkombëtare; apo

2.8. kërkesat që kanë të bëjnë me transaksionin që është kryer jashtë Kosovës:

2.8.1. ka të bëjë me një subjekt, apo subjekt apo njësi biznesi të supozuar e cila, në kohën e Vendimit efektiv për Likuidim, menaxhohet ndaras nga veprimtaria e ndërmarrjes në Kosovë dhe;

2.8.2. autoriteti i Likuidimit ka përcaktuar se nuk është i mundur zbatimi i marrjen nën kontroll në emër të ndërmarrjes i pronës apo asetëve të atij subjekti. Të gjitha transaksionet e tilla të mbyllura në emër të ndërmarrjes përfshin transaksionet qëllimi afarist i të cilave është kufizuar në subjektin e pavarur apo njësinë e biznesit.

Autoriteti i Likuidimit do t'i kushtoj kujdes vlerësimit të transaksionit kundrejt kriterëve të gjëra të specifikuar në Nenin 36 të Shtojcës së Ligjit. Nëse transaksioni është i anulueshëm sipas kriterëve të mësipërme, atëherë edhe kërkesa kreditore e bazuar në atë transaksion duhet të refuzohet.

Kur kërkesat kreditore janë të paligjshme ose të falsifikuara, Agjencia ka kompetencë të shqiptoj sanksione administrative. Agjencia gjithashtu mund t'i imponoj sanksione administrative AL-së apo çdo personi të tretë i angazhuar nga AL-ja për shpërdorim të kërkesave dhe fshehje të asetëve.

9.8.Kërkesat e siguruara⁶⁷

1. Kërkesat e siguruara me anë të garancisë, siç është pengu, zotimi, pagesa, hipoteka apo siguri tjera mbi një pronë apo aset të ndërmarrjes (Kërkesë e Siguruar) nuk parandalojnë Autoritetin e Likuidimit të tjetërsojë apo që në mënyra tjera të ushtrojë kompetencat e tij ndaj një Personi të tretë, apo ta parandalojë atë, nga marrja e asaj prone apo asemi të paguarantuar dhe të pasiguar, me kusht që shitja e tillë apo ushtrimi i kompetencave nga ana e Autoritetit të Likuidimit t'i njoftohet kreditorit.

2. Në rast se prona apo asemi i garantuar tjetërsohen apo në mënyra tjera bëhen subjekt i ushtrimit të kompetencave të Autoritetit të Likuidimit, Kërkesa e Siguruar e kreditorit ka prioritet të njëjtë sikur që do të kishte në kuptim të pronës apo asemi që është shitur apo që është bërë subjekt i ushtrimit të kompetencave të Autoritetit të Likuidimit nëse Autoriteti i Likuidimit i ka ndërmarrë këto veprime për qëllimin e vetëm të gjenerimit të të hyrave për shpërndarje te kreditorët.

3. Në rast se shitja apo ushtrimi i kompetencave të Autoritetit të Likuidimit ndaj pronës apo asemi të garantuar ka gjeneruar, apo pritet të gjeneroj, fonde likuide që janë të pamjaftueshme për të

⁶⁷ Neni 38 i Shtojcës së Ligjit.

përbushur Kërkesën e Siguruar, pjesa e Kërkesës së Siguruar që mbetet apo që pritet të mbetet e papërbushur pranohet si Kërkesë e pasiguruar.

Pengu, hipoteka apo barrët tatimore mbi asetet e NSH-së do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë regjistruar bazuar në Ligjin mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

Te kërkesat kreditore të siguruara (neni 40.1.4 i Shtojcës së Ligjit), AL-ja mund të veproj në dy mënyra:

I. Kur e drejta e siguruar është e vlefshme dhe AL e ka marrë aprovimin nga Bordi i Drejtorëve që t'ia dorëzoj asetin ose pronën e siguruar me atë të drejtë kreditorit të siguruar;

ose

II. Kur AL-ja vendos të shes pasuritë e ngarkuara me të drejtë siguroese për të zbatuar në mënyrë efektive likuidimin e NSH-së.

Situatat kur aset i dorëzohet kreditorit të siguruar duhet të kufizohen në situata ku:

a) Marrëveshja themelore e sigurimit në mënyrë të veçantë e lejon pengmbajtësin që të merr në posedim asetin e mbajtur peng nëse kreditori nuk është paguar plotësisht;

b) Sigurimi është në formë të marrëveshjes së vlefshme të "Mbajtjes së titullit". Marrëveshja e tillë siguron që e drejta ligjore nuk i kalon blerësit deri sa furnitori të jetë paguar në tërësi. Nëse marrëveshja e vlefshme e "Mbajtjes së titullit" ekziston, atëherë NSH-ja asnjëherë nuk e ka pasur në posedim asetin dhe se furnitorit i takon posedimi, por AL-ja duhet të siguroj se të gjitha kostot që janë të lidhura me heqjen e aseteve janë përgjegjësi vetëm e furnitorit; apo

c) Vlera e kërkesës kreditore realisht tejkalon vlerën e asetit. Në këtë skenar, nuk ka ndonjë arsyetim që AL të kërkoj shitjen e aseteve, përveç nëse aset i në fjalë është vital/thelbësor për shitjen e ndonjë asemi tjetër e që mund të arrihet më së miri duke u shitur si grup asetesh.

Në rast se vlerësohet se vlera e Aseteve të Siguruara është më e vogël sesa kërkesa e parashtruar kreditore dhe e pranuar si valide nga AL-ja dhe AL-ja vendos që t'ia dorëzoj asetin kreditorit të siguruar⁶⁸, AL-ja duhet të kërkoj nga kreditori i siguruar që t'i heq asetet në fjalë me shpenzimet e veta. Megjithatë, nëse më vonë shitja e asetit nga ana e kreditorit të siguruar rezulton me suficit kundrejt borxhit të siguruar, ai është i detyruar me ligj që ta përcjell suficitin te AL-ja.

9.8.1. Shitja e aseteve të siguruara

Kërkesat e siguruara me ane të garancisë siç është pengu, zotimi, hipoteka, pagesa apo siguri tjera mbi një pronë apo aset të NSH-së nuk parandalojnë Agjencinë apo AL-në në ushtrimin e kompetencave ligjore. Për më tepër shih shtojcën e ligjit për AKP-në neni 38.1, 38.2 dhe 38.3.

⁶⁸ Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 18.2.

MA

9.9.Trajtimi i kërkesave kreditore lidhur me punësimin

9.9.1. Të përgjithshme

Punëtorët e ndonjë NSH-je mund të kenë kërkesa kreditore nga marrëdhënia e punës në momentin kur AKP vendos për fillimin e procesit të likuidimit. Ligjet në Kosovë ofrojnë bazën ligjore për të drejtat e punëtorëve në procedurën e likuidimit të NSH-së të udhëhequr nga AKP.

Kërkesat për tre (3) pagat e papaguara të punëtorëve dhe kompensimin për ndërprerje të parakohshme të punës janë një pikë e rëndësishme referimi në procesin e likuidimit. Në procesin e likuidimit, kjo do të thotë që secili punëtor me kërkesë në këtë kategori do të jetë më afër për shpërndarjen e shumës me prioritet. Kërkesat që nuk kanë prioritet do të shpërndahen proporcionalisht në mes kreditorëve të pasiguruar, duke përfshirë punëtorët.

Neni 40.1.6 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së parasheh kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim:

- 40.1.6.1. kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tre paga mujore bruto për person;
- 40.1.6.2. kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Ky parim gjithashtu mbështetet nga "E Drejta e Kosovës". Sipas neni 3.1.14 të Ligjit të AKP-së, e drejta e Kosovës do të thotë: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tyre në pajtim me Kushtetutën, dhe legjislacioni që ka qenë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës nëse ai legjislacion vazhdon të jetë në fuqi sipas paragrafit 2. të nenit 145 të Kushtetutës. "E Drejta e Kosovës" nuk përfshinë asnjë ligj, legjislacion apo akt nënligjor, e as ndonjë pjesë të tyre, që është shfuqizuar, zëvendësuar, anuluar, është bërë i pavlefshëm në mënyrë të ligjshme apo zbatimi i të cilit ka përfunduar ligjërisht.

Ligji i AKP-së parashikon të drejtën e punëtorëve për tre (3) pagat e papaguara dhe të drejtën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës [neni 40.1.6 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së]. Kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës dhe kërkesa për tre (3) pagat e papaguara paraqesin kërkesa preferenciale të punëtorëve.

Kjo pjesë e Rregullores për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit ndërlidhet me kërkesat që kanë të bëjnë me kompensimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës dhe pagat e papaguara për punëtorët e NSH-ve. Çështjet tjera nga apo lidhur me marrëdhëniet e punës nuk janë trajtuar në këtë dokument.

Kjo pjesë e rregullores poashtu do të shërbejë si udhëzues për trajtimin e kërkesave për pagat e papaguara dhe kompensimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës. Ky dokument nuk ka për qëllim adresimin e të gjitha problemeve të mundshme lidhur me ato kërkesa. Pasi që rastet do të

dallojnë njëri prej tjetrit, për secilën kërkesë do të vendoset sipas diskrecionit të plotë të Autoritetit të Likuidimit pas shqyrtimit të të gjitha fakteve të secilit rast dhe vlerësimit ligjor të të gjitha fakteve.

9.9.2. Kompensimi dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës

Pas fillimit të privatizimit apo likuidimit, marrëdhënia e punës me punëtorët zakonisht ndërpritet për të gjithë punëtorët. Kjo trajtohet si ndërprerje kolektive në shumë vende. Qëllimi është t'iu sigurohet punëtorëve një pagesë prej disa rrogave për shkak të humbjes së punës sipas bazës e cila nuk varej nga punëtori dhe për të siguruar pagesën e disa rrogave për një kohë derisa ata të mos gjejnë punë tjetër apo të marrin ndonjë ndihmë tjetër.

Baza ligjore për ndërprerje kolektive është e paraparë me ligjin e punës. Ligji i punës i siguron punëdhënësit të drejtën për ndërprerje kolektive të kontratave të punës për shkak ndryshimeve ekonomike, teknologjike apo strukturale në ndërmarrje.

Në raste të tilla, Punëdhënësi mund të ndërpret kontratën e punës punëtorëve me njoftim paraprak nr.dhe kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit.

Kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës përlllogaritet në bazë të kohëzgjatjes së marrëdhënies të punës. Pasi që ligji i AKP-së parasheh kufizimet në aplikimin e ligjit të punës për privatizim dhe likuidimin e NSH-ve, paradhënia (pagesa avans) e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës nuk është kusht për ndërprerjen e kontratës. Neni 6.3 i Ligjit të AKP-së: Ligji nr. 03/L-212 mbi "Ligjin Themelor të Punës" nuk do të zbatohet në lidhje me ndonjë veprim të ndërmarrë nga Agjencia nën autoritetin e këtij neni 6; sidoqoftë me kusht që neni 76.7 i atij ligji të përdoret për të përcaktuar shumën e pagesës për shkurtim nga puna që mundet të ngrihet si pretendim i vlefshëm sipas nenit 40 të shtojcës së Ligjit.

Neni 6.3 i Ligjit të AKP-së parasheh që kriteret për llogaritjen e shumës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës sipas ligjit të punës, do të jetë e zbatueshme për përcaktimin e shumës për t'iu paguar punëtorit të NSH-së që është shpallur tepricë për shkak të privatizimit apo likuidimit.

Nuk ka ndonjë definicion për "tepricë", mirëpo interpretimi i përgjithshëm ndërkombëtar është largimi nga puna pasi që nuk është më i/e nevojitur për ndërmarrjen.

Në privatizim, transferi dhe shitja e aseteve të Ndërmarrjes së Re në mënyrën e drejtpërdrejtë të privatizimit me spin-off është ndryshimi në organizimin e NSH-së që rezulton në më pak punëtorë të nevojshëm. E njëjta zbatohet edhe për procedurën e likuidimit të një Ndërmarrjeje Shoqërore.

Veprimet më të zakonshme të AKP-së për të cilat kjo ndërlihet, janë tepricat që vijnë pas privatizimit me spin-off apo fillimit të procesit të likuidimit.

Ligji i AKP-së lejon kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës për të gjithë punëtorët që i nënshtrohen tepricës si pasojë e, apo në ndërlidhje me likuidimin apo privatizimin pavarësisht nga madhësia e tepricës së punëtorëve.

9.9.3. Kush ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës

Sipas ligjit të AKP-së, kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës paraqet kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës për tepricë për shkak të privatizimit dhe likuidimit të NSH-së.

Kriteri për përcaktimin e drejtës për përfshirje për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës përbëhet prej katër komponentëve. Në ditën e fillimit të privatizimit (të Ndërmarrjes së Re) apo fillimit të procesit të likuidimit:

- i) Duhet të ekzistoj marrëdhënia e punës me punëtorin;
- ii) Punëtori duhet të ketë punuar apo ofruar shërbime për NSH-në;
- iii) Punëtori ka pasur marrëdhënie të varur me NSH-në;
- iv) Punëtori do të ketë marrëdhënie të përhershme të punës.

i) Duhet të ekzistoj marrëdhënia e punës me punëtorin

Në ditën e fillimit të likuidimit, punëtori duhet të ketë pasur marrëdhënie pune me NSH-në. Ekzistimi i marrëdhënies të punës mund të dëshmohet me kontratë të punës, vendim për punësimin, librezën e punës, listën e pagave dhe dokumente tjera të cilat sipas vendimit të komisionit të likuidimit dëshmojnë ekzistencën e marrëdhënies të punës.

ii) Punëtori duhet të ketë punuar apo ofruar shërbime për NSH-në

Ekzistenca e marrëdhënies të punës nuk do të jetë gjithmonë e mjaftueshme për përfshirje në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Ligji i punës parasheh definicionin për punëtorin. Punëtori do të jetë person fizik i punësuar për të kryer punë apo shërbime me pagesë për punëdhënësin. Prandaj, përpos kërkesës për ekzistencë të marrëdhënies së punës, punëtori duhet të ketë punuar në ndërmarrje dhe të jetë paguar për punën e tij/saj në momentin e fillimit të likuidimit apo privatizimit. Punëtori i cili në momentin e fillimit të likuidimit, për ndonjë arsye ligjore kishte formalisht marrëdhënie pune me kompaninë, mirëpo ai/ajo nuk ishte produktiv në kompani, nuk ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Këta persona nuk janë shpallur tepricë (shih definicionin më lart për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës). Shumica e punëtorëve janë shpallur punëtorë tepricë.

iii) Punëtori ka pasur marrëdhënie të varur me NSH-në

Është e rëndësishme të theksohet që vetëm personat e punësuar kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Ofruesit e shërbimeve, punëtorët sezonal të

anëtarëve me honorar në bord (nëse nuk janë me orar të plotë në NSH) nuk kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Për përcaktimin e pozitës së punëtorit, është i rëndësishëm fakti që punëtori të ishte punëtor i rregullt në NSH dhe ai/ajo ishte i/e ngarkuar me udhëzimet e punëtorit (ai/ajo nuk ishte punëtorë i/e pavarur apo profesionist i/e pavarur).

iv) Punëtori do të ketë marrëdhënie të përhershme të punës

Shprehja marrëdhënie e përhershme e punës do të thotë që punëtori nuk do të ketë kontratë me afat të kufizuar (më pak se dy vite) dhe do të jetë punëtorë i përhershëm (jo i rastit apo sezonal). Ky kriter është gjithashtu i përfshirë me ligj. Ligji i punës nr. 03/L-212 (neni 76.7) parasheh që vetëm punëtorët me kontrata të pakufizuara kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës.

Ligji më tutje parasheh që vetëm punëtorët që kanë punuar së paku 2 vite në kompani kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës. Prandaj, punëtorët të cilët kanë pasur kontrata me afat të kufizuar në më pak se dy vite apo ishin të punëtorë të përhershëm jo të rastit, nuk kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës.

9.9.4. Identifikimi i punëtorëve me të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës

Mjetet për identifikimin e personave me të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës mund të jenë:

- i) Lista e pagave të NSH-së, dhe
- ii) Lista e menaxhmentit të punëtorëve;
- iii) Dokumenti nga Administrata Tatimore apo Trusti Pensional që dëshmon që kontributet janë paguar nga Punëdhënësi për punëtorin;
- iv) Ndonjë dokument tjetër që sipas vendimit të komisionit të likuidimit paraqet dëshmi për ekzistencën e marrëdhënies të punës apo shërbimeve të ofruara nga punëtori për NSH-në.

Lista e menaxhmentit me punëtorë gjithashtu me dëshmi prima facie⁶⁹ për ekzistencën e marrëdhënies së punës në ditën e fillimit të privatizimit apo likuidimit. Lista e pagave paraqet dëshmi prima facie për punëtorët të cilët kanë punuar dhe kanë pranuar pagesë para ditës së fillimit të privatizimit apo likuidimit. Zakonisht, NSH-të nuk i kanë paguar punëtorët për tre muajt e fundit në pritje të privatizimit të NSH-së. Prandaj, ky fakt duhet marr parasysh gjatë përcaktimit të kualifikueshmërisë.

⁶⁹ Sipas fjalorit juridik të Mirriam-VWebster, prima facie do të thotë: (a) e vërtetë, valide ose e mjaftueshme në përshtypjen e parë; ose (b) ligjërisht mjaftueshëm për të dëshmuar një fakt ose rast, përderisa nuk dëshmohet e kundërta.

9.9.5. Si t'i trajtoj kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës

Janë katër çështje kryesore për t'u vlerësuar dhe zgjidhur gjatë vendimit për Pagesë për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës të Punës:

- i) Nëse kërkesa është e Pranueshme;
- ii) Nëse kërkesa ka Bazë Ligjore;
- iii) Përcaktimin e "rrogës mujore";
- iv) Përcaktimin e "viteve të shërbimit në NSH".

9.9.6. Vendimi për kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës

Kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës do të aprovohet nëse kërkesa është e pranueshme dhe ka bazë ligjore.

9.9.7. Pranueshmëria

Para hyrjes në shqyrtimin e materialit të kërkesës, rekomandohet të kontrollohet nëse kërkesa i përmbush kërkesat minimale formale.

i) Afatet për dorëzimin e kërkesës dhe formulari

Kërkesa duhet të dorëzohet brenda afatit ligjor pas publikimit që NSH është vendosur në procedurën e likuidimit.

Çështja më problematike gjatë shqyrtimit të afateve për kërkesa të tilla është përcaktimi nëse kërkesa është parashtruar pas afatit.

Në shumicën e rasteve, kërkesat janë dorëzuar në AKP dhe ankuesi nuk e ka ripërtëri kërkesën para Autoritetit të Likuidimit. Një problem tjetër është që para hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067 më 1 korrik 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës kishte vendosur që punëtorët nuk kanë pasur të drejtë në kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës⁷⁰.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067 më 1 korrik 2008, neni 5.7.b.ii kishte paraparë kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës si kërkesë preferenciale duke iu referuar nenit Rregullores nr. 2005/48 të UNMIK-ut neni 44.1.f. Poashtu, me miratimin e Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034 që ka hyr në fuqi më 21 shtator 2011, është paraparë në nenin 40.1.6 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së se kjo e drejtë e punëtorëve trajtohet me prioritet preferencial.

⁷⁰ SCL-06-0007, *Zekije Osaj kundër NAK 1 maj*, data 05/06/2008

ii) Kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës para datës 1 korrik 2008

Nëse një punëtorë ka parashtruar kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës para 1 korrik 2008 ose në AKP apo në Komisionet e mëparshme të likuidimit të AKM-së apo AKP-së (deri më 21 shtator 2011), kjo kërkesë nuk do të refuzohet nga Autoriteti i Likuidimit në AKP në baza që punëtorët nuk kishin të drejtë për kërkesë për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës para hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067, pasi që NSH-ja nuk ishte vendosur në likuidim ende.

E drejta për Kompensim për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës është e drejtë e përcaktuar me Ligjin e AKP-së. Prandaj, kërkesat ekzistuese për Kompensim për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës do të shqyrtohen nga Autoriteti i Likuidimit. Punëtorët nuk do të jenë të obliguar të parashtrojnë kërkesa të reja për Kompensim për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës të Punës.

iii) Parashkrimi

Parashkrimi relativ

Deri në hyrjen në fuqi më 21 shtator 2011 të Ligjit të AKP-së nr.04/L-034, likuidimi është kryer në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48. Në përputhje me nenin 43.3(d)(ii) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 "...të gjithë kreditorët dhe kërkuesit e mundshëm se në rast të mosparaqitjes së dëshmisë së kërkesës brenda dy (2) muajve pas datës së publikimit të dytë të njoftimit, kreditorët dhe kërkuesit e tillë nuk do të jenë në gjendje të përfitojnë nga shpërndarja e të ardhurave nga procedura e likuidimit. Neni 6.1 i Rregullores për Dhomën e Posaçme nuk zbatohet."

Ndërsa, me rastin e hyrjes në fuqi më 21 shtator 2011 të Ligjit të AKP-së nr.04/L-034, likuidimi kryhet në bazë të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Në përputhje me nenin 7.2.6.2 të Ligjit të AKP-së nr.04/L-034, të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo aseteve të ndërmarrjes duhet të parashtrojnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularët përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashtrimin e kërkesave, që do të caktohet në ora 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje.

Kërkesat kreditore të dorëzuara pas këtij afati, do të refuzohen nga Autoriteti i Likuidimit.

Parashkrimi absolut

Parashkrimi absolut i punësimit lidhur me kërkesat është 3 vite. Parashkrimi absolut mund të jetë relevant vetëm nëse njoftimi i likuidimit, sipas paragrafit paraprak, nuk është plotësuar apo nuk është plotësuar në mënyrë të duhur.

MP

Neni 608 i Ligjit për Punën Sociale, Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 53/1976, parasheh që: "Parashkrimi ndërpret kërkesën për zbatimin e obligimeve materiale lidhur me kontratat dhe në veçanti: 1) pagesën e të hyrave personale dhe kërkesat tjera të punëtorëve; 2) pagesën për dëme lidhur me punën ... të gjitha këto kërkesa kanë parashkrim prej 3 vitesh"; dhe

Në përputhje me nenin 87 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212) "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës". Ky ligj hyn në fuqi më 16 dhjetor 2010.

iv) Likuidimet që kanë filluar para datës 1 korrik 2008. Si të trajtohen rastet kur nuk është parashtruar kërkesa për kompensim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës të punës?

Para hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067 më 1 korrik 2008, kërkesat për kompensim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës të punës⁷¹ nuk janë shqyrtuar si kërkesa sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48. Prandaj, shumë kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës nuk janë parashtruar pranë komisionit të likuidimit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067 më 1 korrik 2008, neni 5.7.b.ii i këtij ligji kishte paraparë kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës si kërkesë preferenciale duke iu referuar nenit 44.1.f të Rregullores nr. 2005/48 të UNMIK-ut. Poashtu, me miratimin e Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 shtator 2011, është paraparë në nenin 40.1.6 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së kjo e drejtë e punëtorëve me prioritet preferencial.

Për NSH-së që janë vendosur në likuidim para hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067 më 1 korrik 2008, përderisa nuk ka përfunduar likuidimi i NSH-së, punëtorët e NSH-ve kanë pasur të drejtë në kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Në procedurën e likuidimit do të shqyrtohen të gjitha kërkesat e kreditorëve të parashtruara pranë komisionit të likuidimit në kohën e AKM-së apo deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067 më 1 korrik 2008.

Kërkesat e parashtruara pas afatit do të refuzohen. Në procedurën e likuidimit, për NSH-të që janë vendosur në likuidim pas datës 21 shtator 2011, kreditori duhet të parashtror kërkesën brenda dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje.

Për NSH-të që janë vendosur në likuidim para datës 1 korrik 2008, afati për kufizimet statusore (parashkrimin) fillon me kualifikimin për një të drejtë të tillë (neni 360 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, RSFJ, 1978), për shkak se sipas këtij neni "Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit". Poashtu, edhe sipas nenit 342.1 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në fuqi nga 20 dhjetor

⁷¹ Shih SCL-06-0007, *Zekije Osaj kundër NAK I maj, data 05/06/2008*

2012), "Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër". Prandaj, afati kohor për parashkrimin e kërkesave për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës nga likuidimet që kanë filluar para datës 1 korrik 2008, ka filluar më 1 korrik 2008 me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067.

Një pyetje tjetër është, nëse afati kohor prej dy muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067 apo afatet kohore të zbatueshme me nenin 43.3(d)(ii) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo parashkrimet e përgjithshme janë të zbatueshme për kërkesat kreditore për punësim? Neni 43.3(d)(ii) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 i referohet të drejtës së ankuesit për të parashtruar kërkesat e tyre ekzistuese për kualifikueshmëri dy muaj pas publikimit të dytë të njoftimit për likuidim. Ky afat nuk është përfillur nga ankuesit pasi që asnjë publikim tjetër nuk është bërë. Publikimi i ligjit nuk mund të konsiderohet si publikim i njoftimit të likuidimit për kualifikueshmëri. Si shtesë, njoftimi për likuidim publikohet dy herë në gazetën e përditshme për të arritur në mënyrë efektive tek ankuesit potencial. Prandaj, të rastet e lartpërmendura të kërkesave për punë, i zbatueshëm do të jetë parashkrimi prej 3 viteve. Si përfundim, në rastet kur likuidimi i NSH-së ka filluar para datës 1 korrik 2008 dhe komisioni i likuidimit, pas asaj date ka publikuar edhe një njoftim për likuidim, parashkrimi për parashtrimin e kërkesës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës do të jetë 3 vite (pra deri më (30 qershor 2011) nga hyrja në fuqi të Ligjit të AKP-së nr. 03/L-067.

9.9.8. Kërkesa ka bazë ligjore

Nëse punëtori i plotëson kërkesat ligjore për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës.

Kriteret e kualifikueshmërisë:

- Duhet të ekzistoj marrëdhënia e punës me punëtorin
- Punëtori duhet të ketë punuar apo ofruar shërbime në NSH
- Punëtori kishte marrëdhënie të varur pune me NSH-në
- Punëtori të ketë kontratë të përhershme (jo me afat të kufizuar)
- Punëtori nuk ka pranuar bonus social.

9.9.9. Llogaritja e shumës për pagesën e ndërprerjen e kontratës së punës

i) Numri i pagave

Sipas nenit 76.7 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, pagesa për ndërprerjen e parakohshme të kontratës duhet t'u paguhet punëtorëve sipas skemës në vijim:

- Prej dy (2) deri në katër (4) vite shërbim, paga një (1) mujore;
- Prej pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, pagë dy (2) mujore;
- Prej dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite shërbimi, paga tre (3) mujore;
- Prej njëzetë (20) deri në njëzet e nëntë (29) vite shërbimi, paga gjashtë (6) mujore; dhe

- Prej tridhjetë (30) vite ose shumë shërbimi, paga shtatë (7) mujore.

Zbatimi i Ligjit të Punës

Neni 6.3 i Ligjit të AKP-së përcakton që: "Ligji nr. 03/L-212 mbi "Ligjin Themelor të Punës" nuk do të zbatohet në lidhje me ndonjë veprim të ndërmarrë nga Agjencia nën autoritetin e këtij neni 6; sidoqoftë me kusht që neni 76.7 i atij ligji të përdoret për të përcaktuar shumën e pagesës për shkurtim nga puna që mundet të ngrihet si pretendim i vlefshëm sipas nenit 40 të shtojcës."

Prandaj, kriteri për përcaktimin e shumës për t'u paguar për kompensimet e ndërprerjeve të parakohshme të kontratës duhet të përcaktohet me kriteret të përcaktuara në nenin 76.7 të Ligjit të Punës nr.03/L-212.

ii) Shuma e pagës

Neni 76.6 i ligjit të punës nr.03/L-212 thotë që pagesa e shumës së pagave mujore të paguhet si kompensim i ndërprerjes së parakohshme të kontratës. Në shumë raste, paga e punëtorëve nuk ishte përcaktuar me kontratë, vendim ose dokumente me shkrim. Veç kësaj, në shumë raste punëtorët nuk i kanë marrë pagat të siguruara me vendim ose kontratë, pasi që NSH-ja nuk kishte të hyra të mjaftueshme për të paguar pagën e plotë. Prandaj, përcaktimi i pagës gjatë shqyrtimit të kërkesës kreditore mund të jetë problematik.

Mjeti më i duhur për përcaktimin e pagës është lista e pagave ose dëshmia e pagesës së tatimit të të ardhurave. Neni 3.1.13 i Ligjit të Punës ofron përfufizimin për paga "shpërblimi ose fitimi i çfarëdo niveli të llogaritur e shprehur në para për të punësuarin". Në shumë raste, lista e pagave nuk korrespondon me pagën e kontraktuar, sepse në disa raste NSH-ja nuk kishte të hyra të mjaftueshme për të paguar pagat e punëtorëve. Sidoqoftë, pagat e kontraktuara në shumë raste kanë qenë të larta, sa që NSH-ja kurrë nuk ka qenë në gjendje të paguaj paga të tilla. Prandaj, lista e pagave duhet të shërbej si bazë e përcaktimit të pagave mujore sipas kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës.

Pagesa e fundit që punëtori e ka marrë në emër të shërbimeve të tij/saj të ofruara për NSH-në para privatizimit ose likuidimit është norma e pagesës që ai/ajo ka humbur si pasojë e veprimeve të AKM/AKP sipas nenit 6.1 dhe 6.2 të Ligjit, në parim duhet të shërbej si pagë mujore për t'u paguar sipas kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës.

Në rastet kur ne shqyrtohen pagat për punëtor me orar të plotë dhe këto janë më të ulta sesa paga minimale e përcaktuar në Kosovë, baza për pagën mujore sipas kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës duhet të jetë minimumi i pagës në Kosovë. Ky parim duhet të jetë efektiv, pasi që sipas ligjit të punës, asnjë punëtor me orar të plotë nuk duhet të marrë më pak page se sa paga minimale të ofruara nga autoritetet e shtetit.

iii) Bonusi social

Në disa raste, punëtorët kanë pranuar kompensimin nga të hyrat e NSH-së, megjithëse nuk ofronin punë produktive ose shërbime për kompaninë (shembull: të hyrat e qirasë për asetin janë shpërndarë në grup të gjithë punëtorëve, ndërsa praktikisht vetëm menaxhmenti punonte me të hyrat e qirasë së NSH-së). Këta punëtorë nuk kanë të drejtë në kompensim të ndërprerjes së parakohshme të kontratës.

9.9.10. Përcaktimi i “viteve të shërbimit” në NSH

“Vitet e shërbimit” është periudhë e kohës gjatë së cilës punëtorët punuan për atë punëdhënë, p.sh. vitet që punëtori shërbej në ndërmarrje ku kontrata e tij është përfunduar. Çdo pushim i paguar, duke e përfshirë e mos kufizuar në, pushimin e lehonisë, pushimin vjetor, festat zyrtare nuk e ndërprejnë marrëdhënien e punës dhe duhet të përfshihen në vitet e shërbimit.

Vitet e përgjithshme të shërbimit të nuk duhen marrë parasysh kur përcaktohen vitet e shërbimit, mirëpo vitet e shërbimit në NSH. NSH-ja e caktuar ka hyrë në likuidim, prandaj vetëm vitet e shërbimit në ndërmarrjen në likuidim duhet të merren parasysh. NSH-ja e likuiduar nuk duhet të mbaj borxh pagesën e kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës për vitet e shërbimit të punëtorit në ndërmarrje ose institucione tjera.

Punëtori nuk është i kualifikueshëm nëse:

- Punëtori ka përfunduar kontratën e punës në mënyrë vullnetare/të njëanshme, kur NSH-ja edhe më tej paguante dhe ishte e gatshme të paguaj atij/asaj pagën e kontraktuar;
- Punëtori nuk kryente detyrat e tij/saj;
- Punëtori ishte shkarkuar nga puna sipas masave disiplinore;
- Punëtori ishte akuzuar për krim dhe dënuar për veprimet e bëra kundër NSH-së ose pronës së saj;
- Punëtori nuk punonte për NSH-në dhe nuk merrte pagën për punën e tij, tre muaj para fillimit të privatizimit ose likuidimit (duke mos përfshirë rastet e pushimit të lehonisë).
- Rastet tjera në diskrecion të AL-së.

9.9.11. Pagat e papaguara

Punëtorët kanë të drejtë të paguhet për kompensimet e papaguara të pagave, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Kategoria e përcaktuar në nenin 40.1.6 e Shtojcës së Ligjit:

“40.1.6. kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim:

1.6.1. kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tre paga mujore bruto për person;

1.6.2. kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në;"

Dhe

Kategoria e përcaktuar në nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit:

"40.1.7. kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë;"

9.9.11.1. Tre pagat e fundit të papaguara

Menjëherë pas kërkesave të siguruara dhe kërkesave pronësore, kërkesat për tre pagat e fundit të papaguara renditen si kërkesa me prioritet preferencial. Të kualifikueshëm për pagesa të tilla duhet të jenë punëtorët të cilët kanë kryer punën e tyre për tre paga të tilla. Tre pagat e fundit të papaguara duhet të konsiderohen si kritere, sepse në praktikën e procesit të privatizimit në Kosovë, NSH-ja në shumicën e rasteve nuk kishte paguar punëtorëve tre pagat e fundit, sepse ata (NSH-të) kanë kuptuar që tre pagat do të paguheshin gjatë procesit të likuidimit. Është lehtë për t'u identifikuar nga AL-të, shuma e pagave, nëse paga është paguar apo jo dhe për të konkluduar nëse kërkesa nuk është me afat të skaduar. Në shumicën e rasteve punëtorët në kërkesë nuk e specifikojnë se për cilën pagë të papaguar ata ankohen dhe nuk përfshijnë dëshmitë për mospagesën e pagave.

Te tre (3) pagat e papaguara llogariten pagat neto, tatimi në të ardhura personale dhe kontributi pensional në emër të punëdhënësit dhe punëtorit.

9.9.11.2. Kërkesat tjera për pagat e papaguara

Kërkesat tjera të punëtorëve për pagat e papaguara sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së përfshijnë:

1. Pagat e papaguara (neto) të punëtorëve të papaguara nga Punëdhënësi (NSH), pasi të zbriten tre pagat e fundit (që përcaktohen me kategorinë 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit);
2. Kontributi pensional i papaguar (5% të pagës bruto paguhet si pension në emër të punëdhënësit-NSH dhe 5% nga paga bruto e punëtorit) dhe tatimit në të ardhura personale nga NSH në Administratën Tatimore të Kosovës në emër të punëtorëve;
3. Pushimi i papaguar nga punëdhënësi vetëm në rastet kur punëtori ka punuar;⁷²
4. Kompensimet tjera për të bërë nga Punëdhënësi sipas marrëveshjes për punë (e vlerësuar me çmim të tregut);

⁷² Ligji i Punës 03/L-212, neni 36 dhe neni 38.

5. Përfitimet jo-monetare, sikur transporti në punë dhe nga puna, ushqimet dhe të papritura, rroba për mbrojtje në punë vetëm në rastet kur punëtori punon.

9.9.12. Kush është i kualifikueshëm për pagat e papaguara

Kriteri për përcaktimin e kualifikueshmërisë për personat e kualifikueshëm për pagat e papaguara duhet të përbëhet prej këtyre komponentëve:

- Marrëdhënia e punës me punëtorët duhet të ekzistoj
- Punëtori të ketë punuar ose ofruar shërbime për NSH
- Punëtori nuk ka pranuar pagesën për punën e tij/saj
- Punëtori ka marrëdhënie të varur të punës me NSH-në
- Punëtori nuk ka pranuar bonuset sociale.

i) Marrëdhënia e Punës

Punëtori duhet të dëshmojë ekzistencën e marrëdhënies së punës për tu bërë i kualifikueshëm për kërkesën për pagën e papaguar. Marrëdhënia e punësimit nga kontrata e punës ose libri i punëtorëve. Dëshmitë tjera potenciale për dëshmimin e ekzistimit të marrëdhënies së punësimit duhet të jetë Lista e Punëtorëve e Menaxhmentit, Lista e Pagave etj.

ii) Performanca e punëtorëve

Për t'u bërë i kualifikueshëm për kërkesën e pagave të papaguara, punëtori duhet të ketë punuar ose ofruar shërbime për NSH-në gjatë periudhës së ankuar të pagës së papaguar. Kërkesat kur punëtorët ankohen për pagat e papaguara, mirëpo është e qartë që punëtorët nuk kanë kryer ndonjë shërbim për NSH-në për periudhën e ankuar, duhet konsideruar si punëtorë joaktiv (punëtorët në pushim pa pagesë ose punëtorët në listë të pritjes). Kërkesa të tilla kreditore duhet të refuzohen nga Autoriteti i Likuidimit. Në disa raste më të sofistikuar punëtorët kanë pranuar "bonuset sociale" në bazë materiale, p.sh. menaxhmenti ka shpërndarë të hyrat e qirasë në mes të punëtorëve dhe ka llogaritur si një pagesë në avans, megjithëse punëtorët nuk kanë kryer ndonjë punë në NSH. Pagesa të tilla duhet të konsiderohet si "bonus social" e jo si pagesë në avans në emër të pagave të papaguara.

Marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktuese në përbërje të obligimeve të përbashkëta të palëve (shërbime dhe shpërblime) dhe i nënshtrohet parimeve të nenit 104 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077) i Kosovës. Asnjë shpërblim nuk jepet nëse shërbimi nuk është kryer. Kërkesat e punëtorëve të cilët nuk kanë kryer ndonjë punë ose shërbim të punëdhënësit nuk duhet të konsiderohen si kërkesa për pagat e papaguara.

Rastet e veçanta: pamundësia për të performuar

Këto janë rastet e kreditorëve të cilëve marrëdhënia e punës kurrë nuk ishte përfunduar në mënyrë formale ose është konfirmuar nga gjykata që përfundimi ishte jo valid, mirëpo nuk ka mundur të

MM

kryej ndonjë punë kundrejt dëshirës së tyre për shkak të (i) implementimit të masave të dhunshme në vitin 1989-1999, ose (ii) kushtet e pafavorshme të sigurisë që kanë parandaluar atë që përkohësisht të paraqitet në punë. Këto grupe të kreditorëve pretendojnë kompensimin për pagat e papaguara për periudhën e kohës kur nuk kanë qenë në gjendje të punojnë për punëdhënësin. Këta kreditorë duhet të jenë të kualifikueshëm për pagat e papaguara, nëse kërkesat e tyre nuk janë parashkruar. Përfshirja e këtij grupi është justifikuar ligjërisht, sepse nuk ishin në gjendje të kryejnë punën e tyre për arsye të:

- a) Refuzimi i punëdhënësit për të pranuar punën e tyre të kontraktuar ose shërbimet në baza diskriminuuese;
- b) Kushtet e pafavorshme të sigurisë që kanë parandaluar atë që përkohësisht të paraqitet në punë.

Në rastet kur punëdhënësi ka refuzuar shërbimet ose punën e punëtorit (sipas paragrafit “a” më lart), bazuar në motivimin i cili nuk mbështet me ligj, punëtori nuk është i obliguar për të performuar, mirëpo mban të drejtën ndaj palës tjetër të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077) i Kosovës.

Termi “përkohësisht” në paragrafin b) më lart nënkupton gjendjen ku punëtori për shkak të gjendjes së sigurisë në Kosovë nuk ishte në gjendje të kryer detyrat e tij/saj për periudhë të caktuar megjithëse punëtori ka ofruar performancën për NSH-në kohë pas kohe. Pengesë e tillë nuk duhet të jetë natyrë e përhershme, pra kjo ka qenë e përkohshme vetëm deri sa është përmirësuar gjendja e sigurisë dhe është pritur nga punëtori të kryej detyrat e tij/saj të punës.

Shënim i rëndësishëm:

Këto kërkesa zakonisht janë të parashkruara, prandaj së pari duhet kontrolluar parashkrimin.

Rasti i pamundësisë për të performuar, kreditori është dashur t'i qaset gjykatës relevante dhe të parashtrij padi ndaj NSH-së. Parashkrimi për parashtrimin e padisë për shkak të shkeljes së të drejtave të punës është 3 vite (Neni 608 i Ligjit mbi Punën Sociale, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 53/1976, thotë që: “Parashkrimi përfundon kërkesën për ekzekutim të obligimeve materiale e cila ndërlidhet me kontratat dhe në veçanti: 1) pagesa e të hyrave personale dhe kërkesave tjera të punëtorëve; 2) pagesa për punën lidhur me dëmet Të gjitha kërkesat tjera janë të parashkruara për 3 vite”).

Nëse ankuesi nuk ka iniciuar parashtrim në gjykatë, atëherë kërkesa e tillë është parashkruar, përndryshe AL-të shqyrtojnë dhe vlerësojnë vendimet përkatëse të gjykatës.

Praktika e gjykatës: Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës SCC- 07 – 0191 të 1 nëntor 2007.

Ankuesi kërkon kompensim për pagat e papaguara për periudhën e ashtuquajtur “masat e dhunshme” prej 1989-1999. Ekzistojnë katër lloje të kërkesave për kompensim të cilat janë parë në procesin e likuidimit:

- i) Kërkesat kreditore që janë dorëzuara pa aktgjykim të gjykatës e bërë për here të pare gjatë procedurës së likuidimit kërkon kompensim të pagave për periudhën e lartë përmendur. Këto kërkesa duhet të anulohen sit të parashkruara.
- ii) Kërkesa kreditore që janë dorëzuara me aktgjykimin e gjykatës të lëshuar nga një gjykatë para vitit 1999 në favor të punëtorit bazuar në procedurat e filluara pas largimit gjatë vitit 1999. Kërkesat në këtë kategori të rastit duhet të jenë të pranuar në parim.
- iii) Kërkesat kreditore që janë dorëzuar me një aktgjykim të gjykatës lëshuar nga gjykata pas qershorit 1999, të bërë në favor të ankuesve bazuar në procedurat e filluara me kohë sipas ligjeve të zbatuara para vitit 1999, mirëpo të kryera vetëm pas vitit 1999. Kërkesat në këtë kategori duhet të pranohen në parim.
- iv) Kërkesat kreditore që janë dorëzuara me një aktgjykim të lëshuar bazuar në procedurat e filluara pas qershorit 1999. Qëndrimi ligjor lidhur me këtë kategori të rasteve të kërkesave duhet të ekzaminohet për të pare nëse mund të apelohej për shkak të aktgjykimit të lëshuar ultra vires⁷³.

iii) Mungesa e pagesës

Punëtori duhet të pranojë çfarëdo pagese ose kompensim për punën ose shërbimin e bërë. Në të kundërtën, punëtori nuk duhet të jetë i kualifikueshëm për pagat e papaguara.

iv) Marrëdhënia e punës e varur

Ofruesit e shërbimeve, punëtorët sezonal të anëtarëve të bordit (nëse nuk ishin tërësisht të punësuar në NSH) nuk kualifikohen për pagat e papaguara. Për përcaktimin e gjendjes së punëtorit i rëndësishëm është fakti që punëtori ishte punëtor afatgjatë në NSH dhe ai/ajo ishte i lidhur me me udhëzimet e punëdhënësit (ai nuk ishte i ekspert i pavarur ose profesionist i pavarur). Ofruesit e shërbimeve, konsulentët, të pavarurit etj. duhet të konsiderohen si kontraktorë dhe jo si punëtorë.

9.9.13. Vendimi mbi kërkesat për pagat e papaguara

Kërkesat për pagat e papaguara duhet të miratohet nëse kërkesa është e pranueshme dhe me bazë ligjore.

i). Kërkesa është e pranueshme nëse nuk është parashkruar

Parashkrimi relativ

Për NSH-të për të cilat procesi i likuidimit është zhvilluar sipas nenit 43.3(d)(ii) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, pra deri më 21 shtator 2011 (kur ka hyrë në fuqi Ligji i AKP-së nr. 04/L-034 dhe Shtojca e Ligjit), "...të gjithë kreditorët potencial dhe ankuesit që kanë dështuar të parashtrijnë dëshmi të kërkesës brenda dy (2) muajve të datës, njoftimi i dytë është publikuar do të rezultojë

⁷³ Ultra vires sipas fjalorit Mirriam-VWebster: përtej mandatit ose në kundërshtim me autorizimet ligjore.

me kreditor dhe ankues të tillë duke mos qenë në gjendje të përfitoj nga shpërndarja e të ardhurave të procedurave të likuidimit.”

Ndërsa, me rastin e hyrjes në fuqi më 21 shtator 2011 të Ligjit të AKP-së nr.04/L-034, likuidimi kryhet në bazë të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Në përputhje me nenin 7.2.6.2 të Ligjit të AKP-së nr.04/L-034, të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo aseteve të ndërmarrjes duhet të parashtrojnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularët përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashtrimin e kërkesave, që do të caktohet në ora 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje.

Parashkrimi absolut

Parashkrimi absolut për kërkesat që kanë të bëjnë me punësimin është 3 vite.

Nëse pranoi kërkesë për pagë të papaguar, ju lutem kontrolloni fillimisht nëse kërkesa është e parashkruar.

Neni 608 i Ligjit për Punë Sociale, Gazeta Zyrtare RSFJ nr. 53/1976 dhe neni 87 i Ligjit të Punës (Nr.03/L –212) parasheh parashkrimin prej 3 viteve për të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me punësimin. Nëse kërkesa që është më e vjetër se tre vite dhe nuk është ndërprerë në pajtim me Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve nr. 04/L-077 të Kosovës, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

ii). Kërkesa është e bazuar në rast se punonjësi i plotëson kërkesat ligjore dhe është i kualifikueshëm për të marr pagën e papaguar.

Kriteret e kualifikueshmërisë:

- Marrëdhënia e punës me punonjësin duhet të jetë ekzistuese
- Punonjësi duhet të ketë punuar ose kryer shërbime në NSH
- Punonjësi nuk ka marr pagë për punën e tij/saj
- Punonjësi pati marrëdhënie të varur të punës me NSH.

9.9.14. Shqyrtimi i kërkesave për pagat

i) Vlerësimi i situatës faktike

Autoritetet e likuidimit mund të përdorin qasjen e përmbledhur më poshtë si udhëzues për vlerësimin e situatës faktike të kërkesave për pagat.

Lista e plotë e vlerësimit të kërkesave kreditore për pagat

1. Identifikoni ankuesin - Kopjen e identifikimit (ID) Letërnjoftimin
2. Analizoni kopjen e Librezës së punës (nëse nuk ka librezë të punës, sqaroni pse dhe çfarë është burimi i përdorur i informacionit për identifikimin e marrëdhënies së punës për periudhën e caktuar)
3. Përcaktoni qartë datat se kur ankuesi ka filluar punën në këtë NSH.
4. Gjeni të dhëna në NSH për vendimin e punësimit dhe/ose kontratës
5. Cila është data e fundit që ankuesi ka dalë në punë në këtë NSH
6. A ka pranuar ankuesi ndonjë njoftim me shkrim në lidhje me tepricat teknologjike apo ndonjë njoftim për të mos dalë në punë?
 - Nëse po, bashkëngjitni një kopje të njoftimit me shkrim në lidhje me tepricat teknologjike apo ndonjë njoftim për të mos dalë në punë
 - Nëse jo, bashkëngjitni një deklaratë me shkrim pse ju nuk jeni kthyer në punë në këtë NSH.
7. A ka aplikuar ankuesi në Gjykatë apo ndonjë institucion të njohur për mbajtjen e statusit të punës, siç kërkohet në Ligjin për punën e bashkuar?
 - Nëse po, bashkëngjitni kopjen e aplikimit dhe cilindo vendim nga gjykata.
 - Nëse jo, ju lutemi sqaroni pse ankuesi nuk ka aplikuar
8. Sa ishte paga mujore BRUTO e ankuesit? (specifikoni në valuten origjinale dhe të konvertuar në euro)
9. Cila ishte data kur ankuesi kishte marrë pagën e tij/saj të fundit?
10. Me çfarë periudhe kohore kjo pagë e fundit ka të bëjë?
11. Sa ishte vlera e pagës së fundit të pranuar - BRUTO ? (specifikoni në valuten origjinale dhe të konvertuar në euro)
12. Zbuloni, kërkoni dhe bashkëngjitni çdo njoftim për pagën ose ndonjë faturë bankare për të konfirmuar këtë pagesë
13. Në kohën e shkuarjes së paditësit, ai/ajo a kanë pasur ndonjë kredi të papaguar apo ndonjë pagë të marrë si akontacion apo paga tjera të marra nga ankuesi prej NSH-së (Nëse po, cila ishte shuma në valuten origjinale dhe të konvertuar në euro dhe siguron përshkrimin për pagesë)
14. Kërkoni nga paditësi që të sigurojë deklaratën me shkrim ku i specifikon të gjitha punët që ai/ajo ka pasur që nga data kur ka punuar për herë të fundit në këtë NSH.
15. Kërkoni nga Ankuesi të ofrojë dokumente tjera apo dëshmi mbështetëse që ju mendojnë se janë relevante për kërkesën e Ankuesit.

ii) Përmbledhja e informacioneve (tabela)

Emri i NSH-së:		Kodi Rajonal i NSH-së:		Rajoni i AKP-së:	
Emri i kreditorit:					
<u>Detajet mbi pagat e papaguara dhe kërkesa për kompensim nga shkëputja e kontratës së punës</u>					
Neni 40.1.6.1: Tre Pagat e Fundit të papaguara (kërkesa preferenciale) – që ka të bëjë me punën që paditësi e ka kryer në këtë NSH dhe që ende nuk e ka marr pagën për tre muajt e fundit					
Përshkrimi	Data e fillimit d/m/v	Data e mbarimit d/m/v	Shuma bruto	Valuta origjinale	E konvertuar ne euro
			Gjithsejt paga (në euro)		
Neni 40.1.6.2: Kompensimi për ndërprerjen e kontratës së punës (kërkesa preferenciale) - sipas neni 40.1.6.2 të Ligjit të AKP-së nr.					
Vendosni më poshtë figurat për eksperiencën e punës së kreditorëve në këtë NSH					
	Data e fillimit	Data e mbarimit	Gjithsej vite punësimi		
	d/m/v	d/m/v	Vite	Muaj	
Neni 40.1.7 Pagat tjera të papaguara (kërkesa të pasiguruar) – që ka të bëjë me punën që paditësi e ka kryer në këtë NSH dhe që ende nuk e ka marr pagën. Kësaj shume i zbriten tre pagat e fundit sipas kategorisë 40.1.6.1					
Vendosni më poshtë figurat për eksperiencën e punës së punëtorit në këtë NSH					
	Data e fillimit	Data e mbarimit	Gjithsej vite punësimi		
	d/m/v	d/m/v	Vite	Muaj	
Komentet – Vendosni ndonjë koment apo sqarim në lidhje me padinë e paditësit					

Paga mujore bruto do të vlerësohet në bazë të kontratës së punës, listës së pagave apo ndonjë burimi tjetër në dispozicion.

Shuma bruto e kërkesës së punëtorëve për paga i nënshtrohet zbritjes prej 5% për kontributin pensional në emër të punëtorit⁷⁴ për të llogaritur tatimin në të ardhurat personale të tatueshme. Tatimi në të ardhurat personale llogariten duke u bazuar në normat tatimore të përcaktuara në Ligjin për të Ardhura Personale⁷⁵ dhe Opinionin Ligjor të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) me numër nr. E-564-2012 të datës 21 nëntor 2012 për llogaritjen mujore të tatimeve të punëtorëve gjatë procesit të likuidimit të NSH-ve.

⁷⁴ Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, neni 6

⁷⁵ Ligji nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhura Personale

Me qëllim të regjistrimit të kërkesës në likuidim, shuma prej 5% në emër të kontributit pensional të punëdhënësit duhet t'i shtohet kërkesës bruto të punëtorit.

Shuma totale e kontributit pensional është 10% dhe përbëhet prej 5% të pagës bruto në emër të kontributit pensional në emër të punëtorit dhe 5% të pagës bruto në emër të kontributit pensional në emër të punëdhënësit (kontributi pensional në emër të punëdhënësit paguhet nga fondi i NSH-së në likuidim).

Kur paga është paguar, ndalesat/zbritjet e bëra për tatimin në të ardhura personale dhe kontributet pensionale (në emër të punëdhënësit dhe në emër të punëtorit) duhet të paguhet në llogarinë bankare të Administratës Tatimore të Kosovës dhe në llogarinë bankare të Trustit Pensional të Kosovës respektivisht brenda 15 ditëve pas pagesës së pagës neto të punëtorit.

Në rastet kur kreditori/punëtori ka vdekur apo ka arritur moshën e pensionimit (sipas Ligjit për Fondet Pensionale) në datën e nxjerrjes së vendimit nga AL për kërkesën kreditore apo ka vdekur apo ka arritur moshën e pensionimit para se të nxjerret vendimi i Bordit për miratimin e pagesave për kreditorët, atëherë nuk llogaritet kontributi pensional (5% i punëtorit dhe 5% i punëdhënësit), por tatimi në të ardhura personale llogaritet në të ardhurat bruto të aprovuara nga AL-ja.

Pas pagesës së kontributit total pensional, Autoriteti i Likuidimit e dërgon në Trustit Pensional Brenda shtatë (7) ditëve kalendrike listën e punëtorëve me të dhënat e kontributeve pensionale respektive për secilin punëtor/kreditor që kanë përfituar pagesa.

E njëjta mënyrë e llogaritjes së pagesës neto, tatimit në të ardhura personale dhe kontributit pensional vlen edhe për kompensimin për ndërprerjen e kontratës së punës, siç përcaktohet edhe në Opinionin Ligjor të ATK-së të referuar më sipër.

Tatimi në të ardhura personale dhe kontributi pensional i punëtorit janë pjesë përbërëse e pagës bruto dhe të ardhurave të fituara nga kompensimi për ndërprerjen e kontratës së punës. Këto trajtohen me të njëjtin prioritet të pagesës sikurse edhe vet pagat neto dhe pjesa neto e kompensimit për ndërprerje të kontratës së punës.

9.9.15. Vlerësimi i kërkesave të vlefshme

Autoriteti i Likuidimit duhet të jetë në gjendje që t'i bëjë këto përlllogaritje në lidhje me kërkesat për paga:

- Cili është kompensimi i përgjithshëm për pagat neto?
- Cili është kompensimi i përgjithshëm për kontributin pensional (si për punonjës in po ashtu edhe për punëdhënësin)?
- Sa është kompensimi i përgjithshëm për tatimin në të hyra personale?

Me krijimin e shumave të përgjithshme më sipër, Autoritetet e Likuidimit do t'i ndajnë pagat sipas prioriteteve dhe radhitjeve sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Shumat e ndara sipas radhitjes së pagave përbëhet nga pagat neto, kontributi pensional dhe tatimi në të ardhura personale.

Në shpërndarje kreditori pranon vetëm pagën neto, kurse kontributi pensional dhe tatimi në të ardhura personale iu paguhen Trustit Pensional dhe ATK-së respektivisht.

Autoritetet e Likuidimit duhet të analizojnë me kujdes:

- nëse kreditori ka pretenduar pagë "Bruto" apo pagë "Neto"; dhe
- nëse ATK ka dorëzuar kërkesa kreditore që ndërlidhen më të njëjtat ardhura të punëtorëve.

Në këto raste, kërkesa e ATK-së për tatimin në ardhura pensionale dhe kontributeve pensionale refuzohet, ndërsa në arsyetimin e vendimit refuzues theksohet se këto i paguhen ATK-së proporcionalisht për pagesën Neto që ndërlidhen me kërkesën e kreditorit. Kjo duhet të shmang llogarinë e dyfishtë të kërkesës për tatimin në të ardhura personale dhe kontributin pensional.

9.9.16. Vlerësimi i komponentës së tatimit në të ardhura personale dhe komponentës së kontributit pensional

Gjatë vlerësimit të kërkesave për paga dhe kompensimin për ndërprerjen e kontratës së punës, Autoritetet e Likuidimit do të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet elementeve të tatueshme dhe të pa-tatueshme të kërkesës për paga.

Neni 9 i Ligjit për Tatimin në të Ardhura Personale përcakton:

1. Të ardhurat bruto nga pagat që tatohen;
2. Cilat të ardhurat e përgjithshme nga rrogat nuk tatohen (përfshihen nga tatimi); dhe
3. Për kontributet pensionale që tatohen si të ardhura bruto.

9.9.16.1. Në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen:

1. rrogat e paguara në emër të një punëdhënësi për punën të cilën e kryen punonjësi sipas udhëheqjes së drejtorit ose punëdhënësit;
2. bonuset, provizionet, mëditjet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënësi apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës;
3. të ardhurat e fituara nga puna e përkohshme të cilën e kryen punonjësi;
4. të ardhurat nga punësimi i mundshëm, siç është nënshkrimi i një bonusi të rrogës;
5. premitë e sigurimit të jetës që një punëdhënësi paguan për punonjës;
6. falja e huas së punonjësit ose e obligimit të punëdhënësit;
7. pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënësi; dhe

8. pos nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj, përfitimet në gjësende që një punëdhënës ia jep punonjësit që kalon shumën minimale të përcaktuar me një akt nënligjor të lëshuar nga Ministri.

9.9.16.2. Në të ardhurat e përgjithshme nga rrogat nuk përfshihen:

1. kompensimi i shpenzimeve reale të udhëtimeve të biznesit deri në shumën e përcaktuar me akt nënligjor nga Ministri;
2. dëmshpërblimi për aksidentet në punë;
3. përfitimet në natyrë në formë të shujtave dhe transportit të ofruara nga punëdhënësi për punëtorin duke përjashtuar kompensimin në para;
4. rimbursimin, e kufizuar në më pak nga kostoja e transportimit publik apo zero pikë gjashtëmbëdhjetë euro (0.16€) për kilometër, për shpenzimet e vajtje-ardhjeve për të punësuarit distanca e vajtje-ardhjeve e të cilëve nga rezidenca e tyre kryesore për në vendin e rregullt të punës është më e madhe se njëzet (20) kilometra;
5. përfitimet në natyrë që i jepen të punësuarëve në formë të biletave të transportit publik të kufizuara në transportimin mbi transportin e autorizuar publik nga rezidenca kryesore e të punësuarit për në vendin e rregullt të punës. Përfitimet në natyrë mund t'u jepen të punësuarve distanca e vajtje-ardhjeve e të cilëve nga rezidenca e tyre kryesore për në vendin e tyre të rregullt të punës është më e madhe se një (1) kilometër;
6. Ministri do të nxjerr akt nënligjor për të përkufizuar kërkesat e raportimit që lidhen me dhënien e rimbursimit apo përfitimeve në natyrë të lejuara me nën-paragrafët 2.4 dhe 2.5 të këtij paragrafi.

9.9.16.3. Për kontributet pensionale, të ardhurat bruto do të përfshijnë:

1. kontributet e dhëna nga punëdhënësi në emër të punonjësit në sistemin e kursimeve individuale pensionale, në fondin plotësues të pensionit të punëdhënësit dhe në skemën plotësuese individuale të pensioneve sipas legjislacionit përkatës mbi trustin e kursimeve pensionale të Kosovës;
2. kontributet e dhëna nga punonjësi në sistemin e kursimeve individuale pensionale, në fondin pensional plotësues të punëdhënësit dhe në skemën plotësuese pensionale individuale sipas legjislacionit përkatës mbi kursimet pensionale në Kosovë.

9.10. Trajtimi i kërkesave kreditore për transformimet pronësore

9.10.1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj pjese të rregullores është që të shtjelloj kërkesat kreditore të Fondit Zhvillimor të Serbisë në procedurat e likuidimit dhe të jap rekomandimet se si të trajtohen ato nga Autoritetet e Likuidimit.

Kërkesat kreditore të Fondit Zhvillimor të Serbisë (FZHS) bazohen në pretendimet që NSH e caktuara kanë kaluar nëpër një transformim gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX e që rezultoi me ndërrimin e pronësisë të NSH-ve (pjesërisht apo plotësisht) në dobi të FZHS.

Sa i përket një transformimi të pretenduar, Ligji i AKP-së (neni 5 paragrafi 4) thotë:

“4. Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikoj në autoritetin e Agjencisë sipas neneve 5.1 ose 5.2 të Ligjit të AKP-së si dhe neneve 6, 8 ose 9 të Ligjit të AKP-së, përveç nëse:

4.1 Transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në bazë të të cilit është bërë transformimi;

4.2 Janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me Transformimin, qofshin ato që kanë dalë gjatë apo pas Transformimit, qofshin ato të shqiptuara në bazë të ligjit apo ndonjë kjontrate – përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, përmbushjen e plotë të detyrimeve që kërkojnë pagesën e kompensimit të plotë dhe lëshimin e aksioneve; dhe

4.3 transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Një transformim i pretenduar duhet të plotësoj në mënyrë kumulative kushtet e parapara sipas paragrafit 4.1, 4.2 dhe 4.3 të nenit 5 të Ligjit për AKP-në, në mënyrë që të ndikoj në Pronësinë Shoqërore të ndërmarrjeve në fjalë. Kushti i parë paraprak për vlefshmërinë e transformimit të pretenduar, i cili më pas do të ndikoj në vlerësimin e kërkesave kreditore të FZHS, është përputhshmëria me ligjin e aplikueshëm për transformimet.

9.10.2. Ligji i aplikueshëm për transformimet

Fondi Zhvillimor së pari ishte futur në Legjislacion nga Ligji i RFSJ mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90).

Ligji mbi Kapitalin Shoqëror i autorizon ndërmarrjet me pronësi shoqërore “që të përvetësojnë kapital shtesë me anë të lëshimit të një sasive të aksioneve, më saktësisht nëpërmjet shitjes të aksioneve që u japin të drejtën apo titullin e pronësisë”⁷⁶.

⁷⁶ Neni 1 i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90).

Përkufizimi i Kapitalit Shoqëror, siç parashihet në nenin 1 të këtij Ligji, janë asetet kapitale të një ndërmarrjeje të zhvlerësuar për pjesën proporcionale të humbjeve të pambuluara tregtare, fondeve rezervë dhe fondeve jashtë biznesit. Kapitali shoqëror mund të shitet, plotësisht apo pjesërisht, investitorëve vendor apo të jashtëm me kusht që të hyrat e fituara nga kjo shitje i takojnë fondit për zhvillim⁷⁷.

Neni 3 i këtij ligji thotë se të hyrat e fituara përmes shitjes të kapitalit shoqëror që kanalizohen tek fondi për zhvillim do të paraqesin një depozitë të vazhdueshme të Republikës apo Krahinës Autonome në Fondin për Zhvillim. Të ardhurat e fituara nga shitja e ndërmarrjeve (plotësisht apo pjesërisht) do të përdoren nga Fondi për Zhvillim për investime kapitale në ndërmarrje. Përderisa Fondi për Zhvillim funksionon si një ndërmarrje publike, Republika apo Krahina Autonome e Jugosllavisë mund të themeloj një apo më shumë fonde për zhvillim.

Lëshimi i aksioneve për shitje, si dhe shitja e ndërmarrjes e plotë apo e pjesërishtme, është e drejtë ekskluzive e organit Menaxhues të Ndërmarrjes. Me vendimin e brendshëm për shitjen e aksioneve (përgatitja e tyre për shitje për punëtorët aktual apo ish-punëtorët, personat tjerë fizik vendor apo fondet për sigurime pensionale dhe të invaliditetit) organi menaxhues duhet të merr vendim për organizimin e ndërmarrjes në një formë qoftë si Shoqëri Aksionare apo Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar⁷⁸. Në rast se organi menaxhues i ndërmarrjes merr vendimin për shitjen e një pjese të ndërmarrjes, ai njëherësh merr edhe vendimin tjetër për organizimin e ndërmarrjes si ndërmarrje me pronësi të përzier⁷⁹.

Ligji thotë caktimi i vlerës së një ndërmarrje bëhet nga një organizatë e përzgjedhur nga ana e një Agjencie për Ristrukturim dhe Revitalizim, e cila është e themeluar në bazë të këtij ligji me qëllim të ofrimit të këshillave lidhur me shitjen e ndërmarrjes⁸⁰. Ligji kërkon të merret një opinion nga ana e kësaj Agjencie para përmbylljes të kontratës që ka të bëjë me çfarëdo shitje të aksioneve, pjesë të ndërmarrjes apo vet ndërmarrjen⁸¹. Ligji përcakton një afat prej 10 vitesh për përmbylljen e shitjes si dhe pagesën e aksioneve të brendshme të lëshuara nga ndërmarrja⁸². Parapagimi apo pagesa e aksioneve duhet të dëshmohen nga Banka në fjalë përmes certifikatave të veçanta⁸³.

Ligji mbi Kapitalin Shoqëror u ndryshua në vitin 1996 (Gazeta Zyrtare e RSFJ 29/96, 29/97) për sa u përket ofrimit për herë të parë të mundësisë të transformimit përmes bartjes të aksioneve tek Fondi për Zhvillim⁸⁴ apo në fondet tjera.

⁷⁷ Neni 2 i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90).

⁷⁸ Neni 1 a) i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

⁷⁹ Shih nenin 2 të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

⁸⁰ Shih nenin 2 a) të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

⁸¹ Shih nenin 2 b) të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

⁸² Shih nenin 14 të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

⁸³ Shih nenin 97 dhe 100 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

⁸⁴ Shih nenin 6, paragrafin 2 të Ligjit mbi bazat e transformimit të kapitalit shoqëror (Gazeta Zyrtare 29/96, 29/97)

Transferimi i aksioneve, sa i përket nenit 13 të Ligjit në fjalë, është bërë për të vetmin qëllim që këto aksione të ofrohen për shitje për tregun kapital. Transferimi i aksioneve tek Fondi për Zhvillim, nëse është bërë ndonjëherë sipas nenit 13 të Ligjit, e bën Fondin një lloj “bartësi” të aksioneve të blerësi, i cili pas bërjes të pagesës bëhet pronar i padiskutueshëm/përfundimtar. Një ndryshim i rëndësishëm, i bërë me këtë ligj, ishte e drejta e kompanisë për të hyrë në marrëveshje kontraktuale me kreditorët e saj për shndërrimin e shumave të detyrimeve (ndaj kreditorëve) në investim (të kreditorëve) dhe më pas kapitalizmin e një investimi të tillë në aksione⁸⁵.

9.10.3. Obligimi i regjistrimit në Gjykatë

Çfarëdo ndryshimi i statutit të ndërmarrjes, por edhe ndryshime tjera, përfshirë ndryshimet në kapital, duhet të regjistrohen në regjistrin e Gjykatës⁸⁶. Regjistrimi në Gjykatë është e vetmja mënyrë për t'i dhënë efekt ligjor transformimit të ndërmarrjes⁸⁷. Të dhënat e futura në Regjistrin e Gjykatës publikohen në Gazetën Zyrtare të RSFJ⁸⁸.

Përveç ligjit Federal, Republika e Serbisë ka nxjerrë ligjin e vet lidhur me themelimin e Fondit për Zhvillim dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore. Ligji mbi Fondin Republikan për Zhvillim dhe Rindërtim të Ekonomisë ishte nxjerrë nga Republika e Serbisë në vitin 1990. Aktiviteti i Fondit do të ishte investimi i kapitalit shoqëror dhe mjeteve tjera financiare në aksione apo pjesë të ndërmarrjes shoqërore, duke synuar konsolidimin e ndërmarrjeve të tilla, shitjet pasuese të aksioneve e pjesëve dhe rregullimin e krediteve⁸⁹.

Fondi Republikan për Zhvillim dhe Rindërtim të Ekonomisë ka pushuar së funksionuari në vitin 1992, me ç'rast Kuvendi i Republikës të Serbisë miratoi Ligjin mbi Fondin Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92). Njëri nga objektivat e Fondit për Zhvillim të Serbisë, ashtu siç parashihej nga ky ligj ishte “parandalimi i emigrimit të mëtejshëm dhe të kthimit të Serbëve dhe Malazezëve në Kosovë”⁹⁰. Përderisa aktiviteti kryesor i Fondit ishte për të marrë pronën në posedim, prodhimi dhe rekonstruktimi financiar, mjetet financiare do të vinin, ndër tjera, nga shitja e kapitalit shtetëror si dhe shitja e ndërmarrjeve shoqërore apo pjesëve të tyre në pajtim me ligjin⁹¹.

Fondi ishte i organizuar si Shoqëri Aksionare që do të lëshonte aksione në shumën e transferuar bazuar në transformimin e pronës shoqërore në pajtim me ligjin si dhe shumën e aseteve të ofruara nga Buxheti i Republikës të Serbisë⁹².

⁸⁵ Shih nenin 14 të Ligjit mbi bazat e transformimit të kapitalit shoqëror (Gazeta Zyrtare 29/96, 29/97)

⁸⁶ Shih nenin 183 dhe 184 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

⁸⁷ Shih nenin 185 dhe 186 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

⁸⁸ ibid.

⁸⁹ Shih nenin 4 të Ligjit mbi Fondin Republikan për Zhvillim dhe Rikonstruktiv të Ekonomisë (RS Gazeta Zyrtare RS 32/90)

⁹⁰ Shih nenin 3 të Ligjit Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare RS 20/92).

⁹¹ Shih nenin 4 të Ligjit Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare RS 20/92).

⁹² Shih nenin 8 të Ligjit Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare RS 20/92)

Procedura për transformimin e pronës shoqërore parashihej me “Ligjin mbi Kushtet dhe Procedurat për Transformimin e Pronës Shoqërore” (tani e tutje Ligji mbi Transformimet)⁹³. Ligji mbi Transformimet përbëhet prej parimeve të vendosura nga Ligji i RSFJ mbi Kapitalin Shoqëror. Ligji parasheh transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri aksionare.

Ligji e mvesh Organin Menaxhues të ndërmarrjes me autoritet ekskluziv për të vendosur mbi transformimin e ndërmarrjeve në Shoqëri Aksionare si dhe për lëshimin e aksioneve⁹⁴. Ndërmarrja është e obliguar me Ligj që të publikoj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë si dhe në shtypin ditor që të dyja, Vendimin e Organit Menaxhues lidhur me transformimin dhe Vendimin për Lëshimin e Aksioneve⁹⁵. Pronarët e kapitalit do të pranojnë një vërtetim për shumën e paguar të aksioneve⁹⁶.

Ligji parasheh tre mënyra të transformimit:

- 1) lëshimi dhe shitja e aksioneve me qëllim të shitjes të kapitalit në pronësi shoqërore;
- 2) lëshimi i aksioneve me qëllim të rritjes të kapitalit; dhe
- 3) blerja e ndërmarrjes apo një pjese të saj⁹⁷.

1) Sipas metodës të parë të transformimit – shitja e kapitalit shoqëror përmes aksioneve – punëtorëve, ish-punëtorëve apo trashëgimtarëve të ish-punëtorëve të ndërmarrjes të kualifikohen për zbritje të vlerës nominale të aksioneve⁹⁸, ndërsa 50% e kapitalit të fituar nga shitja e aksioneve me zbritje shkon në Fondin Pensional.

Fondi për Zhvillim duket se ka pranuar vetëm 60% të kapitalit të fituar nëpërmjet shitjes të aksioneve pa zbritje, që janë para të mbledhura nga shitjet ndaj palëve të treta (që nuk janë punëtorë), ndërsa 30% e kapitalit shkon në Fondin Pensional dhe 10% në Fondin për Punësim. Kapitali i transferuar në Fondin për Zhvillim do të përdorej për prodhim, ristrukturim të pronës dhe zhvillim⁹⁹. Secila ndërmarrje e përfshirë mban të dhënat e të gjitha aksioneve të shitura dhe zbritjeve të bëra¹⁰⁰.

2) Vendimi mbi lëshimin e aksioneve me qëllim të rikapitalizimit i përket prapë Organit Menaxhues të ndërmarrjes. Ligji parasheh një vlerësim që duhet bërë nga ana e Agjencisë,

⁹³ Shih Gazetën Zyrtare të RS 48/91.

⁹⁴ Shih nenin 7 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

⁹⁵ ibid.

⁹⁶ Shih nenin 3 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

⁹⁷ Shih nenin 9 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

⁹⁸ Shih nenin 16 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

⁹⁹ Shih nenin 17 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

¹⁰⁰ Shih nenin 18 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

përderisa kapitali i fituar pas shitjes të aksioneve të tilla mbetet në pronësi të ndërmarrjes¹⁰¹.

3) Shitja e Ndërmarrjes, apo e një pjesë të saj, si një formë tjetër e transformimit, bëhet përmes një ankandi publik me kushtet e vendosura nga Fondi për Zhvillim. Ndërmarrja bëhet pjesë e kontratës të shitjes vetëm nëse një pjesë e saj është shitur¹⁰². Nëse vetëm një pjesë e ndërmarrjes është shitur, ndryshe nga blerja e ndërmarrjes si e tërë ku çmimi i shitjes paguhet në llogarinë bankare të Fondit për Zhvillim, paratë e paguara mbesin në ndërmarrje¹⁰³. Shitja e ndërmarrjes, megjithëse mund të përfshijë vetëm një pjesë të saj, shpie në likuidim.

Transformimi, pa marrë parasysh formën, duhet të përfitonte nga shërbimet e një Agjencie të specializuar¹⁰⁴, e cila do të luante një rol të rëndësishëm sa i përket kapitalizmit të ndërmarrjeve që do të transformoheshin në Shoqëri Aksionare. Kjo Agjenci do të lëshonte një vërtetim brenda 60 ditëve pas pranimit të vlerësimit të brendshëm të kapitalit shoqëror të NSH-së dhe zbritjen e aplikueshme përkatëse të vlerës të aksioneve¹⁰⁵. Procesi i lëshimit dhe i shitjes të aksioneve duhet t'i përmbahej Ligjit mbi rregullimin e aksioneve i cili është Ligji i RSFJ për letra me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89, 29/90).

Ligji mbi Letrat me Vlerë themelon një Komision për shqyrtimin e aplikacioneve të detyrueshme të cilat një organ (ndërmarrja) i cili merret me lëshimin e aksioneve duhet t'i dorëzonte para çfarëdo lëshimi të aksioneve¹⁰⁶. Aplikacioni duhet të shoqërohet me një Opinion të Shërbimit Shoqëror për Kontabilitet dhe Auditim të situatës financiare në ndërmarrje¹⁰⁷. Vendimi i Komisionit publikohet në Gazetën Zyrtare të RSFJ¹⁰⁸. Ligji i kërkon Agjencisë Federale të Administratës, e cila është kompetente për çështjet financiare, që të mbajë të shënime për çfarëdo lëshimi të aksioneve apo letrave me vlerë e veçanërisht ato të llojit afatgjatë (nuk është e qartë se në çfarë konteksti është përdorur në ligj ky term); emrin (titullin) dhe selinë e organit lëshues të aksioneve dhe letrave me vlerë; shumën e përgjithshme dhe numrin e aksioneve dhe letrave me vlerë; si dhe numrin serik dhe të kontrollit të organit lëshues të aksioneve dhe bondeve¹⁰⁹.

¹⁰¹ Shih nenin 26 dhe 27 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

¹⁰² Shih nenin 28 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

¹⁰³ Shih nenin 29 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

¹⁰⁴ Shih nenin 3 paragrafi 4 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91). Nuk është e qartë nëse një Agjenci e tillë ishte themeluar ndonjëherë përmes ligjit, neni 39 parasheh tre muaj afat për themelimin e saj.

¹⁰⁵ Shih nenin 8 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

¹⁰⁶ Shih nenin 4 dhe 45 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹⁰⁷ Shih nenin 5 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹⁰⁸ Shih nenin 45d të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹⁰⁹ Shih nenin 7 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

Definicioni i aksioneve dhe letrave me vlerë; siç parashihet në nenin 1 dhe 8 të Ligjit, është aksionet, fletë garancionet, letrat e thesarit, dëftesat dhe certifikatat komerciale të cilat janë dokumente në formë të shkruar të regjistruara apo të krijuara për bartësin.

Çfarëdo e drejte apo detyrimi të parapara në aksione apo obligacione hyn në fuqi posa Lëshuesi i dorëzon ato te blerësi¹¹⁰. Ligji kujdeset posaçërisht për aksionet e lëshuara nga ndërmarrja apo subjektet tjera-përfutuese në nenet 13-25. Sipas nenit 15, ligji parasheh që aksionet duhet të paguhen me para, apo mallra ose të drejtat e shprehura në shuma financiare, nëse vendimi për lëshimin e aksioneve ka paraparë ashtu. Këshilli i Punëtorëve merr vendim për lëshimin e aksioneve¹¹¹.

Vendimi mbi lëshimin e aksioneve duhet të përmbaj një sërë elementesh të specifikuara në nenin 20 të ligjit në fjalë: një të dhënë që tregon se aksionet janë lëshuar tek bartësi apo se ato janë regjistruar; shumën e përgjithshme dhe numrin e aksioneve; vlerën nominale të aksioneve; numrin e votave për aksion në organin menaxhues; metodën e pagesës të ndarë; kohën e regjistrimit të aksioneve; metodën e regjistrimit; kohën dhe metodën e pagesës të aksioneve; afatin për rimbursim në rast të ndonjë dështimi; llojin e aksioneve që do të lëshohen; renditja e realizimit të drejtave me prioritet në rastet kur kemi më shumë se një lëshim; metodën e njoftimit; procedurat e shpërndarjes; mënyrën e shpërndarjes; specifikacionet lidhur me kushtet e pagesës të dividendit të akumuluar; bartja e rrezikut; mënyra e shitjes të aksioneve; mundësia për shndërrim; të drejtat e bartësit për aksionet me prioritet; drejtat e me prioritet për bartësin në rast të lëshimit të ri; etj.

Aksionet e lëshuara nga ndërmarrja përbëhen nga dy komponentë:

- I) dokumenti për lëshimin e aksioneve dhe
- II) kuponi për mbledhjen e dividendëve¹¹².

I) Elementet e dokumentit të aksioneve, siç është definuar në nenin 21 të Ligjit: 1) një shenjë që tregon se bëhet fjalë për një aksion; 2) një tregues që shpjegon llojin e aksionit; 3) identifikimin e blerësit të aksioneve – tek i cili është lëshuar aksioni; 4) shumën në para të vlerës të aksionit; 5) numrin e aksioneve të lëshuara tek bartësi; 6) kushtet e pagesës të dividendës; 7) vendi dhe data e lëshimit; 8) vendi dhe data e lëshimit; 9) numrin serik i cili mban një numër kontrolli 10) nënshkrimin e personit të autorizuar; 11) identifikimin e lëshuesit të aksioneve; 12) një listë me të drejtat e bartësit;

II) Kuponi duhet të përmbaj elementet në vijim: 1) numrin rendor për mbledhjen e dividendës; 2) numrin e aksioneve që përmban kuponi; dhe 3) nënshkrimin e lëshuesit të aksioneve.

Aksionarët kanë pasur certifikatën e aksioneve të lëshuara nga ndërmarrja me qëllim të pjesëmarrjes në asamblenë e aksionarëve¹¹³.

¹¹⁰ Shih nenin 9 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹¹¹ Shih nenin 20 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹¹² Shih nenin 19 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹¹³ Shih paragrafin 3 të nenit 20 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

MA

9.10.4. Përbushja e detyrimeve që dalin apo që ndërlidhen me aksionet

Kërkesa e dytë e paraparë me Ligjin e AKP-së (sipas nën-paragrafit 4.2 të nenit 5), përcakton se për të qenë transformimi i vlefshëm duhet përbushur të gjitha obligimet përfshirë, por duke mos u kufizuar në, pagesën apo lëshimin e aksioneve në fjalë. Përdërisa obligimet që lidhen me lëshimin e aksioneve janë trajtuar gjerësisht më sipër, kjo pjesë do të trajtoj çështjen e pagesës të aksioneve siç parakusht për transformimin e NSH-së në Shoqëri Aksionare.

Pagesa e Aksioneve ka qenë gjithashtu parakusht për transformimin sipas ligjit të aplikueshëm për transformim të kohës.

Aksionet e lëshuara nga një NSH mund të paguheshin përnjëherë apo edhe në këste¹¹⁴. Në rast të pagesës me këste, atëherë bartësi ka pranuar vetëm aksione të përkohshme deri në pagesën përfundimtare¹¹⁵. Sidoqoftë, ka pasur një afat kohor për pagesën e aksioneve të përcaktuar në Memorandumin e Shoqatës të Shoqërisë Aksionare, dhe se në rast dështimi për të bërë pagesën, praktikisht kjo ka quar në ndërprerjen e financimit të SH.A.¹¹⁶. Ligji parasheh që certifikata të lëshohet nga banka në të cilën është bërë pagesa e aksioneve¹¹⁷.

Aksionet munden gjithashtu të përdoren për përbushjen e obligimeve të një NSH-je nën çfarëdo kushti që pajtohen bartësi dhe ndërmarrja¹¹⁸. Në këtë rast, marrëveshje për kryerjen e obligimeve me aksione duhet shoqëruar me certifikatën e marrëveshjes apo ndonjë dokument tjetër që mund të dëshmojë përbushjen në fjalë sipas një marrëveshjeje të tillë.

Transferimi i aksioneve tek Fondi për Zhvillim sipas Ligjit të vitit 1997 për Bazat e Transformimit të Kapitalit Shoqëror, si një metodë tjetër e transformimit, gjithashtu i nënshtrohet obligimit për pagesë të vlerës monetare të aksioneve. Aksionet transferohen tek Fondi në pajtim me nenin 13 të Ligjit, sipas obligimit për t'i ofruar ato për shitje në tregun e kapitalit. Pasi të shiten aksionet, ato i takojnë blerësit dhe pagesa duhet dëshmuar me certifikatën bankare.

9.10.5. Transformimi nuk ishte as diskriminues dhe as nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Transformimi është bërë në kohën e një klime me trazira politike, mosbesimi në mes të popullatës dhe njërive themeluese të ish-Jugosllavisë që dërguan në ndezjen e luftës dhe shpërbërjen e mëtejshme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Objektivi politik i Fondit, siç përcaktohet me Ligjin mbi Fondi për Zhvillim të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92), ishte "parandalim për emigrimin e mëtejshëm dhe kthimin e Serbëve dhe Malazezëve në Kosovë"¹¹⁹. Ndërsa ky dokument nuk merr përsipër të interpretoj nëse një

¹¹⁴ Shih nenin 16 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹¹⁵ ibid.

¹¹⁶ Shih nenin 97 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

¹¹⁷ Shih nenin 100 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

¹¹⁸ Shih nenin 11 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

¹¹⁹ Shih nenin 3 të Ligjit mbi Fondit për Zhvillim të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92)

dispozitë e tillë mund të sugjeronte konotacion diskriminues të këtij ligji të veçantë, ne duhet të theksojmë se ligjislacioni mbi transformimin ishte paraprirë apo i shoqëruar nga një legjislacion diskriminues.

Rregullorja e aplikueshme e UNMIK-ut 1999/24 “mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë” me ndryshime, neni 1, përcakton si në vijim:

“1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

- (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to; dhe
- (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2 Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj”.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 parasheh që një dispozitë apo ligj në fuqi nga marsi i vitit 1989 deri në qershor të vitit 1999, mund të zbatohet vetëm nëse nuk është diskriminuese.

Legjislacioni diskriminues në Kosovë ishte miratuar në një atmosferë politike pas suprimimit¹²⁰ të Autonomisë së Kosovës dhe Kuvendit të saj, si dhe heqjes të institucioneve autonome.

“Organet e Dhunshme” ishin instaluar nga ana e autoriteteve shtetërore të Serbisë në të gjitha institucionet qeveritare, ndërmarrjet dhe ndërmarrjet shoqërore.

Shembuj evident të legjislacionit që inspironin dhe që kishin për qëllim diskriminimin nacional ishin Ligji mbi Marrëdhënien e Punës në rrethana të veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 26 e datës korrik 1990) apo edhe Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në ndërmarrje (Gazeta Zyrtare e RS 43/90). Këto Ligje nënkuptonin instalimin e Masave të Dhunshme që mëtonin ndërrimin e autoriteteve menaxhuese në NSH me “organe të dhunshme”. Largimi nga puna e drejtorëve Shqiptarë ishte veprimi i parë, ndërsa në fund zëvendësimi i tyre me qytetar etnik Serbë rezultoi me largimin nga puna të punonjësve Shqiptarë.

Natyra diskriminuese e një sërë ligjesh që ndërlidhen me transformimin dhe të drejtat e punëtorëve të NSH-ve ishte vënë re në masë të madhe nga organet përgjegjëse ndërkombëtare,

¹²⁰ 23 mars 1999

siç janë OSBE dhe Komisioni mbi të drejtat e Njeriut i KB bazuar në raportet e përgatitura nga ta mbi situatën në Kosovë¹²¹.

Në mënyrë që transformimi i NSH-ve të jetë i vlefshëm, në mënyrë absolute është e domosdoshme që ai të mos jenë vendosur nga organet menaxhuese nëpërmjet zbatimit të Ligji mbi Marrëdhënien e Punës në Rrethana të Veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 e datës korrik 1990), Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në NSH (Gazeta Zyrtare e RS 43/90), apo në ndonjë mënyrë tjetër i ndikuar nga ligjet diskriminuese të nxjerra ndërmjet marsit 1989 dhe qershorit 1999.

Pajtueshmëria me parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (Konventa) buron nga Kushteluta e Republikës së Kosovës, e cila e bën drejtpërdrejt të zbatueshme Konventën në Kosovë.

Konventa nuk ka qenë drejtpërdrejt e zbatueshme në kohën e transformimit të ndërmarrjeve shoqërore pasi që RSFJ nuk ishte anëtare e Këshillit të Evropës dhe prandaj nuk e kishte ratifikuar atë. Megjithatë, parlamenti i ish- Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë iu kishte dhënë statusi mysafirist special në Asamblenë e Këshillit të Evropës në qershor të vitit 1989, menjëherë pas shpërthimit të luftës në qershor të vitit 1991 ky status së pari ishte pezulluar më 25 nëntor 1991 dhe përfundimisht ishte tërhequr më 30 Qershor 1992.

Parimet e Konventës që mund të cenoheshin me transformim janë atë të parapara me nenin 1, protokolli 1 – e drejta e pronës, neni 6 – procesi i drejtë në përputhje me ligjin, neni 14 – ndalimi i diskriminimit etj. Përderisa dështimi i paraqitjes të fakteve që dëshmojnë pagesën e aksioneve të lëshuara nga NSH-ja sigurisht se do të përbënte shkelje të parimeve të parapara me nenin 1, protokolli 1 të Konventës, zëvendësimi i organeve menaxhuese të NSH-ve që vendosin për transformimin, para marrjes të një vendimi të tillë, me qëllim të zbatimit të “masave të dhunshme” është një dhunim i qartë i parimeve kundër diskriminimit që gjenden në nenin 14 të Konventës.

9.10.6. Përfundimi lidhur me trajtimin e kërkesave nga transformimet

Në mënyrë që të përmbushet kushti i parë i paraparë në paragrafin 4.1 të nenit 5 të Ligjit për AKP-në, d.m.th transformimi i ndërmarrjes në pajtim me ligjin e asaj kohe, kërkesa pronësore e Fondit për Zhvillim të Serbisë duhet të shoqërohet nga dëshmitë në vijim:

1. Vendimi i Këshillit të Punëtorëve (Organi Menaxhues i NSH-së) mbi Transformimin - neni 2 i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, neni 17 i Ligjit mbi Transformimin;
2. Vendimi i Këshillit të Punëtorëve (Organi Menaxhues i NSH-së) mbi lëshimin e

¹²¹ Shih paragrafin 156 të Raportit mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në territorin e ish Jugosllavisë nga raportuesi Special drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut të KB (E/CN.4/1993/50), në pajtim me Rezolutën e Komisionit 1992/S-1/1, e disponueshme në <http://ap.ohchr.org/documents/alldocs>. Raporti ofron një listë me ligjet diskriminuese, e cila në mes tjerash përmban Ligjin mbi Marrëdhënien e Punës në Rrethana të Veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 e datës korrik 1990) apo Ligjin mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në NSH (Gazeta Zyrtare e RS 43/90).

aksioneve që përmban të gjitha elementet e parapara në nenin 20 të Ligjit mbi letrat me vlerë - Neni 2 i ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, neni 17 i Ligjit mbi transformimin;

3. Dëshmi për publikimin e Vendimit në Gazetën Zyrtare të RS sipas pikës 1.& 2. - neni 7 i Ligjit mbi transformimin;

4. Dëshmi për vlerësimin e brendshëm (Shërbimi Shoqëror për Kontabilitet dhe Auditim) të Kapitalit Shoqëror (Kapitalizimi) – neni 8 i Ligjit mbi transformimin;

5. Dëftesën nga Agjencia Republikane (sipas nenit 8 të Ligjit mbi transformimin) apo Vendimi i lëshuar nga Komisioni për Vlerësim sipas nenit 4 të Ligjit mbi letrat me vlerë;

6. Dëshmi për publikimin e Vendimit të Komisionit (sipas pikës 5 më lartë) në Gazetën Zyrtare RSFJ – neni 45d i Ligjit mbi letrat me vlerë, me ndryshime;

7. Transkripti i regjistrimit të Shoqërisë Aksionare në Gjykatën Ekonomike që tregon qartë FZHS si një nga aksionarët si dhe shumën e aksioneve që ka në pronësi - neni 183 dhe 184 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime;

8. Dëshmi për publikimin e të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Gjykatës Ekonomike në Gazetën Zyrtare RSFJ që tregon qartë numrin e aksioneve në pronësi të FZHS- neni 185 dhe 186 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime;

9. Certifikatën e aksioneve (dokumentin) e lëshuar nga ndërmarrja që përmban të gjitha 12 elementet, që tregon qartë bartësin e aksioneve- sipas nenit 21, paragrafi 1 i Ligjit mbi letrat me vlerë;

10.Kuponi (pjesa e veçantë e Certifikatës të aksioneve) me 3 elemente sipas nenit 21, paragrafi 1 i Ligjit mbi letrat me vlerë;

11.Certifikatën e aksioneve për pjesëmarrje në mbledhjet të Asamblesë së Aksionarëve (në rast se Vendimi për Lëshimin e Aksioneve e parasheh një gjë të tillë sipas pikës nr. 2 më lartë) lëshuar për FZHS– neni 20.3 i Ligjit mbi letrat me vlerë;

12.Kontrata për shitjen e ndërmarrjes (nëse është e zbatuar kjo metodë e transformimit) sipas nenit 28 dhe 29 të Ligjit mbi transformimin;

13.Certifikata Bankare që dëshmon pagesën e aksioneve apo pagesën e çmimit të shitjes të ndërmarrjes – neni 100 i ligjit mbi ndërmarrjet;

14.Marrëveshja për përmbushjen e obligimeve përmes transferimit të aksioneve apo Marrëveshja për shndërrimin e borxhit në aksione e lidhur ndërmjet NSH-së dhe FZHS e shoqëruar me certifikatën e përmbushjes apo çfarëdo dokumenti tjetër që mund të dëshmojë kryerjen e obligimeve në pajtim me marrëveshjen në fjalë, me kusht që aksionet janë lëshuar për shlyerjen e borxhit – neni 11 i Ligjit mbi Letrat me Vlerë;

15.Dëshmia që Organet Menaxhuese të NSH-së nuk janë zëvendësuar, para se të merrej vendimi për transformimin, duke zbatuar Ligjin mbi Marrëdhënien e Punës në Rrethana të Veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 e datës korrik 1990), Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në NSH (Gazeta Zyrtare e RS 43/90), apo ndonjë nga ligjet tjera diskriminuese.

Në rast se gjatë vlerësimit dhe përcaktimit të vlefshmërisë të kërkesave kreditore të FZHS, Autoritetet e Likuidimit vërejnë mungesën e ndonjërit nga këto dokumente/dëshmi paraqitur më lartë prej 1-15 në mbështetje të kërkesës kreditore, AL-të në pajtim me nenin 23.3 dhe 37.5 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në mund të kërkojnë nga FZHS që të ofroj informacionet që mungojnë e që janë të domosdoshme për përcaktimin e vlefshmërisë të Interesit në fjalë.

Autoriteti i Likuidimit në kërkesën drejtuar FZHS për informata ose dokumentacion shtesë, duhet të përfshij vërejtjen se mosdorëzimi i informatave dhe dokumenteve të kërkuara brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës për informata shtesë, do të rezultoj në refuzimin e kërkesës së tij nga Autoriteti i Likuidimit në pajtueshmëri të plotë me nenin 36, nën-paragrafin 2.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në.

9.11.Lista përfundimtare e kërkesave kreditore

Kur vlerësimi i të gjitha kërkesave duke përfshirë përcaktimin e kundërshtimeve kundër vendimit të AL-së nga kreditori i prekur lidhur me refuzimin apo reduktimin e kërkesave në përputhje me nenin 37 të Shtojcës së Ligjit të AKP, AL-ja sipas nenit 39 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së përpilon Listën Përfundimtare të Kërkesave, duke përfshirë shumën e tyre dhe statusin në përputhje me kategoritë përfundimtare të vendosura në Nenin 40, Shtojca e Ligjit për AKP-në.

Afat real i brendshëm për këtë detyrë është afati 30 ditor pas vlerësimit të kërkesave.

Sipas nenit 39.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, një kopje e listës përfundimtare të Kërkesave postohet në faqen e internetit të AKP-së dhe dorëzohet në Komitetin e Kreditorëve (nëse ekziston) dhe vihet në dispozicion për kreditorët që mund ta marrin pas dorëzimit të kërkesës në Autoritetin e Likuidimit.

AL-ja do të përdorë formën standarde të aprovuar nga AKP-ja. AL-ja së paku do të siguroj informacionet në vijim:

- (i) Emrin e NSH;
- (ii) Shumën e mjeteve të marra nga shitja e aseteve;
- (iii) Kërkesat e parashtruara;
- (iv) Kërkesat e vërtetuara dhe të ndara në kategori;
- (v) Propozimi për shpërndarje të të ardhurave të marra; dhe
- (vi) Bilanci i mbetur për t'u shpërndarë nëse ka.

Neni 10 ANKESAT DHE PADITË

10.1. Ankesat kundër vendimeve të AL-së

Të gjitha vendimet e Autoritetit të Likuidimit pala e pakënaqur mund t'i apeloj në DHPGJS të Kosovës¹²².

Nëse Autoriteti i Likuidimit refuzon tërësisht apo pjesërisht, ose zvogëlon vlerën e kërkesës së parashtruar, ajo duhet të njoftoj me shkrim kreditorin e prekur, duke i dhënë sqarim për refuzimin apo zvogëlimin e kërkesës¹²³.

Kreditori i prekur ka të drejtë që të apeloj në Dhomën e Posaçme në afatin prej 30 ditësh prej datës se njoftimit me vendimin e Autoritetit të Likuidimit për përcaktimin e kërkesës së tij dhe në rast të dështimit të parashtrimit në kohë, kreditori nuk do të ketë mundësi të kundërshtoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Gjykata nxjerr vendim lidhur me kërkesën e parashtruar nga kreditori i prekur jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë, pas datës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Gjykatë dhe pasi një kopje e saj t'i jetë dorëzuar Autoritetit të Likuidimit, Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera sipas udhëzimit të Gjykatës¹²⁴.

10.2. Paditë kundër AKP-së

DHPGJS-ja do të ketë juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.

DHPGJS-ja nuk do të pranoj asnjë padi kundër AKP-së, përveç nëse paditësi paraqet prova se ka informuar Kryesuesin e Bordit për qëllimin e tij për të paraqitur padinë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit të padisë. DHPGJS-ja, me kërkesë të Agjencisë, mund të pezullojë hapjen e procedurës për një padi kundër AKP-së për një periudhë që nuk i kalon gjashtëdhjetë (60) ditë nga marrja e padisë për të mundësuar një marrëveshje miqësore (Ligji për AKP-në Neni 30.2).

¹²² Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 37.7

¹²³ Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 37.6

¹²⁴ Neni 37.8 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Neni 11 **GJOBAT DHË SANKSIONET NË DISPOZICION TË AGJENCISË**

11.1.Obligimi për të bashkëpunuar me AL-në

NSH-ja, menaxhmenti, dhe punëtorët e NSH-së, përfshirë këtu edhe ish punëtorët, dhe të gjithë personat tjerë relevant, si dhe të gjitha autoritetet publike, do të bashkëpunojnë me AL-në dhe do të ofrojnë qasje në të gjitha dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me veprimtaritë dhe operacionet e NSH-së dhe Aseteve të saja, përfshirë, por pa u kufizuar me, të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me kërkesat kreditore, shpagimet, transferimet apo tjetërsimet e pronës dhe Aseteve të NSH-së dhe të gjitha pagesat, transferimet apo veprimtaritë që kanë të bëjnë me NSH-në¹²⁵.

11.2.Ndihma nga Qeveria e Kosovës

Kur të kërkohet nga Agjencia, Qeveria, Policia e Kosovës dhe autoritetet tjera publike sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme për zbatimin e kompetencave të Agjencisë dhe urdhrave të lëshuara nga ajo sipas ligjit të AKP-së¹²⁶.

11.3.Autoriteti për të shqiptuar gjoba

Për të zbatuar autoritetin e vet sipas Ligjit të AKP-së, AKP-ja mund t'u shqiptojë gjoba NSH-ve, punëtorëve dhe personave tjerë me funksione menaxheriale apo kontrolli në lidhje me NSH-të si në vijim:

- i) Mos përgjigjja brenda pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i Agjencisë për informata ose dokumentacionin që është në posedim të të adresuarit - deri në një njëmijë Euro (1000 €) në ditë për çdo ditë të mos përgjigjes deri në një maksimum prej njëqind mijë Eurosh (100,000 €);
- ii) Dhënia me qëllim të informatave të rrejshme një përfaqësuesi të autorizuar të Agjencisë – deri në njëqind mijë Euro (100,000€);
- iii) Shkatërrim, falsifikim, fabrikim ose fshehjen e të dhënave mbi ndërmarrjen – deri në njëqind mijë Euro (100,000 €);
- iv) Fshehjen e qëllimshme ose transferimin e paligjshëm të asetëve të ndërmarrjes – deri në pesëdhjetë mijë Euro (€ 50,000) ose një shumë sa tre herë vlera e asetit në fjalë, cila do që është më e lartë; dhe
- v) Mosdorëzimin në Agjenci të çfarëdo asetit të ndërmarrjes pas marrjes së një urdhri me shkrim nga Bordi - deri në pesëdhjetë mijë (50.000) Euro ose shumën e barabartë me tre herë vlerën e asetëve të pa dorëzuara, cilado që është më e lartë.

¹²⁵ Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 22

¹²⁶ Ligji i AKP-së, Neni 26

Çfarëdo urdhëri për të shqiptuar gjoba do të nënshkruhet nga Drejtori Ekzekutiv ose një Zëvendës Drejtor Ekzekutiv dhe do t'i dorëzohet ndërmarrjes apo personit në fjalë. Urdhëri duhet të hyjë në fuqi menjëherë me rastin e lëshimit të tij. Ndërmarrja apo personi në fjalë do t'i ketë tridhjetë (30) ditë pas marrjes së një urdhri të tillë që ta kundërshtoj këtë urdhër pranë Dhomës së Posaçme.

Dhoma e Posaçme do ta trajtojë një kundërshtim të tillë me urgjencë dhe mund – deri sa të zgjidhet çështja – ta pezullojë urdhërin dhe të shqiptojë ndonjë masë të përkohshme lehtësuese që Dhoma e Posaçme e konsideron të nevojshme apo të duhur gjatë periudhës së çështjes gjyqësore.

Çdo drejtor i NSH-së dhe çdo person tjetër me funksion menaxhues dhe mbikëqyrës që ka lidhje me ndërmarrjen është përgjegjës për çfarëdo dëmi të shkaktuar NSH-së si rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve të ligjshme të përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë që vepron sipas autorizimeve të Agjencisë. AKP-ja në emër të ndërmarrjes në fjalë ka autorizim të kërkoj pagimin e dëmit të tillë në Gjykatën kompetente.

11.4. Sanksionet për parashtrimin e dokumenteve të rrejshme të kërkesës

1. Çdo Person që me qëllim jep deklarata materialisht të rrejshme apo mashtruese, me gojë apo me shkrim, përkitazi me procedurat e kryera sipas këtij ligji, apo që me qëllim ndihmon apo nxit një person tjetër të kryej akt të tillë ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë (100.000) Euro për secilin rast. Në rast të personit fizik, ky person mund t'i nënshtrohet edhe ndjekjes penale në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Kodit Penal.

2. Çdo Person që me qëllim parashtron Kërkesë të rrejshme apo dokumente të rrejshme apo jep deklarata të rrejshme para Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës në procedura sipas këtij Ligji, ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë (100.000) Euro për secilin rast. Në rast të personit fizik, përfshirë zyrtarë dhe drejtorë të personave juridikë, këta persona mund t'i nënshtrohen edhe ndjekjes penale në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Kodit Penal.

11.5. Sanksionet për përvetësimet e paligjshme dhe fshehja e aseteve

1. Çdo person që vepron në cilësi të një anëtarit të Autoritetit të Likuidimit, apo që angazhohet për të punuar në mbikëqyrje të Autoritetit të Likuidimit, Agjencisë apo Ndërmarrjes, që me qëllim bën përvetësim të paligjshëm, shkatërron, vjedh, në mënyrë direkte apo indirekte, dokumente, prona apo asete të Ndërmarrjes do të mbahet përgjegjës për shumën e mjetit në fjalë si dhe ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë (100.000) Euro për secilin rast. Në rast të personit fizik, ai person mund të ndiqet penalisht në pajtim me Kodin Penal.

2. Çdo Person që me qëllim transferon, fsheh apo dështon të paraqes dokumente, prona apo asete të Ndërmarrjes për Autoritetin e Likuidimit, apo në Gjykatë, për t'i ikur proceseve dhe procedurave të këtij Ligji, do të mbahet përgjegjës për gjobë administrative pjo më të lartë se njëqindmijë (€100,000) për secilin rast. Në rast të personit fizik, ai person mund të ndiqet penalisht në pajtim me Kodin Penal.

Neni 12

SHPËRNDARJET PËR KREDITORËT DHE TRANSFERIMI I FONDEVE TË LIKUIDIMIT NË FONDIN E KONSOLIDUAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Para se të merret parasysh rekomandimi për shpërndarjen e të ardhurave nga realizimi i aseteve, së pari duhet konsideruar një numër të madh çështjesh, si për shembull Fondet e Rezervuara sipas nenit 42 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

12.1.Fondet e rezervuara¹²⁷

Sipas nenit 42 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, me aprovim të Bordit, fondet likuide, paratë apo asetet e tjera mund të ndahen nga Autoriteti i Likuidimit në llogari të ndarë të dorëzansë të mbajtur nga Agjencia për përmbushje të:

- Kërkesave që janë në kontestim dhe që ende nuk janë zgjidhur nga Gjykata;
- Kërkesave për pagesa që janë subjekt i shpengimit për të cilin duhet të dorëzohen dokumentet, identifikimet apo kuponët, përfshirë letrat me vlerë, obligacionet, apo instrumente të ngjashme;
- Shpenzimet e ardhshme në lidhje me mirëmbajtjen e pronës apo aseteve të caktuara apo të ndërmarrjes, dhe
- Kërkesat e ardhshme të cilat do të paraqiten me siguri, por që në kohën e Afatit për Parashtrimin e Kërkesave nuk ishin të konstatueshme.

Për qëllime të operimeve të Agjencisë, këto fonde mbahen në llogaritë e likuidimit të cilat menaxhohen nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit i AKP-së.

12.2.Llogaritja e “fondeve teprice” të likuidimit - neni 19.3 i Ligjit

Agjencia është e obliguar që të llogaritë “fondet teprice” (nëse ka) për secilin likuidim të nisur nga Agjencia sipas Ligjit të AKP-së apo sipas dispozitave analoge të legjislacionit paraprak deri në ligjin aktual¹²⁸.

“Fondet Teprice” llogariten duke i mbledhur të ardhurat e privatizimit dhe likuidimit përfshirë çfarëdo të ardhurash tjera anësore si qiraja ose ndonjë gjenerim tjetër pastaj duke e zbritur:

- i) 20% për punëtorët e kualifikuar;
- ii) Pagesa 5% për Agjencinë;
- iii) Vlerën maksimale të kërkesave dhe interesave të pronësisë së kërkuar dhe;
- iv) Shpenzimet e parapara e likuidimit.

Pasi të jenë kryer përlllogaritjet e paraqitura më lartë, 25% zbriten nga “fondet teprice” si mbrojtje ndaj ndonjë gabimi të mundshëm. Llogaritja është ilustruar si në vijim:

¹²⁷ Neni 42 i Shtojcës së Ligjit

¹²⁸ Ligji i AKP-së Neni 19.3

LLOGARITJA E FONDEVE TEPRICË TË LIKUIDIMIT €

1. Realizimi i Aseteve €

Të ardhurat në privatizim 85

Shitja e asetëve përmes likuidimit 10

Të ardhura tjera të ndryshme 5

Gjithsej 100 €

2. Alokimi i mjeteve për punëtorët dhe AKP-në

20% për punëtorët (20)

5% për pagesë për AKP-në (5)

Gjithsej (25)

3=1 minus 2 Fondi në dispozicion për likuidim 75 €

4. Shpenzimet e parapara të likuidimit dhe kërkesat kreditore të dorëzuara

Shpenzimet e parapara të likuidimit (6)

Kreditorët e pasiguruar (25)

Kërkesat për pronësi (5)

Gjithsej shpenzimet e likuidimit dhe kërkesat kreditore të dorëzuara (36)

5. Fondet teprice

5.1=3-4 është e tërë shuma e fondeve teprice 39

5.2=5.1*25% ndalja e 25% të fondeve teprice në llogarinë e likuidimit (9.75)

Fondet teprice që mund të deklarohen dhe transferohen në Buxhet 29.25 €

Nëse fondi teprice është i dukshëm nga përllogaritjet e mësipërme, Agjencia përcakton dhe deklaron si “fonde teprice” deri në shtatëdhjetë e pesë përqind (75%)¹²⁹ dhe menjëherë i transferon ato fonde teprice në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, të cilat pastaj bëhen “para publike” dhe trajtohen në pajtim me LMFPP¹³⁰ dhe të cilat fonde do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të vendit, me aprovim të Kuvendit të Kosovës.

Në praktikë, kalkulimet e sipërshënuara mund të kryhen vetëm pas datës për parashtrimin e kërkesave kreditore. Për më tepër kalkulimet në rastet e këtilla trajtohen dhe janë të përcaktuara me Ligjin e AKP-së Neni 19.

¹²⁹ Shpjegimi i formulimit “deri në 75%”: Gjatë procesit të përpilimit të Ligjit të AKP-së, përpiluesi ligjor pa qëllim ka hequr koston e paraparë të likuidimit nga llogaritjet e Fondit të Mbetur. Për të mundësuar këtë, janë futur fjalët “deri në 75%” ashtu që Agjencia të mund të sigurojë kostot e likuidimit duke reduktuar shumën e Fondeve të Mbetura deri nën maksimumin prej 75% të paraparë me nenin 19.3. Me qëllim të llogaritjes së Fondit të Mbetur, Agjencia do të bëjë llogaritjen siç është përshkruar në këtë rregullore dhe kështu të përcaktojë përqindjen që do të transferohet tek Fondi i Konsoliduar i Republikës së Kosovës.

¹³⁰ Ligji i AKP-së, Neni 19.3.3

MH

12.3.Llogaritja e “fondeve të mbetura” të likuidimit - neni 2.2.6 i Ligjit

“Fondet e Mbetura” të likuidimit të ardhurat që mbahen në mirëbesim nga Agjencia të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme, që mbasin pas përmbushjes së obligimeve të parapara në nenin 40 dhe 41 të shtojcës së ligjit.¹³¹

Pas përmbushjes së vlefshme të kërkesave të kreditorëve në proces të likuidimit sipas Shtojcës së ligjit, fondet e mbetura, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës, dhe përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se Fondi në Mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas bartjes së fondeve të mbetura në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumën e nevojshme nga fondet e mbetura, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse.¹³²

12.4.Llogaritja e “fondeve të përkohshme” të likuidimit - neni 2.2.7 i Ligjit

“Fondet e Përkohshme” të likuidimit janë të ardhurat e përcaktuara nga Agjencia në mënyrë të arsyeshme, që mbasin pas llogaritjes së përmbushjes së obligimeve të parapara në nenin 2.7 të këtij ligji dhe neneve 40, 41 dhe 42 të shtojcës së ligjit.¹³³

Pas llogaritjes së shumës së nevojshme për përmbushjen e vendimeve të vlefshme të kërkesave kreditore në proces të likuidimit, sipas Shtojcës së ligjit bazik dhe pas llogaritjes së fondeve të nevojshme për aktivitetet dhe proceset ligjore tjera të Agjencisë, Fondet e Përkohshme, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës, të cilat fonde të përkohshme përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se fondi në mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas transferimit të fondeve të përkohshme në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme apo për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë sipas ligjit bazik, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumën e nevojshme nga fondet e përkohshme, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit dhe mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë, që ndërlidhen me Ndërmarrjen Shoqërore përkatëse.¹³⁴

12.5.Kthimi i fondeve të likuidimit nga Qeveria e Kosovës

Në rast se shuma e mbetur në një fond të mirëbesimit nga i cili fondet tepricës janë transferuar në Qeveri sipas Ligjit të AKP-së nenit 19 paragrafit 3.3 (fondet tepricë të likuidimit) apo nenit 2

¹³¹ Neni 3.1.28 i Shtojcës së Ligjit

¹³² Neni 2.2.6 i Shtojcës së Ligjit

¹³³ Neni 3.1.29 i Shtojcës së Ligjit

¹³⁴ Neni 2.2.7 i Shtojcës së Ligjit

paragrafit 2.6 (fondet e mbetura të likuidimit) apo nenit 2 paragrafit 2.7 (fondet e përkohshme të likuidimit) është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme, AKP-ja e njofton Qeverinë për këtë dhe Qeveria brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike do t'i kthej fondet përkatëse në fondin e mirëbesimit nga i cili janë transferuar¹³⁵.

12.6.Dokumentet mbështetëse për raportet e shpërndarjeve për kreditorët

Raporti i shpërndarjes për kreditorët do të ketë si pjesë përbërëse këto shtojca:

- 1.Memorandumi për shpërndarje për kreditorët;
- 2.Përmbledhja ekzekutive e NSH-së;
- 3.Lista e kërkesave kreditore të parashtruara brenda afatit ligjor, datat e njoftimeve për vendimet e AL-së;
- 4.Shpërndarja e propozuar për kreditorët, përfshirë fondet e rezervuara sipas nenit 42 të Shtojcës së Ligjit;
- 5.Lista e Kreditorëve të propozuar për pagesë;
- 6.Analiza përmbledhëse e shpërndarjes (sipas nevojës);
- 7.Lista e aseteve të pashitura (brenda Kosovës, jashtë Kosovës dhe banesave);
- 8.Lista e llogarive të arkëtueshme;
- 9.Lista e ankesave të kreditorëve dorëzuar në Dhomën e Posaqme ndaj vendimeve të AL-së;
10. Lista e aseteve të shitura; dhe
11. Pasqyra përmbledhëse financiare e llogarisë bankare në likuidim.

Menaxhmenti i AKP-së përcakton nëse ka nevojë për informata shtesë që duhet të përmbaj raportin i shpërndarjes për kreditorët.

12.7.Shpërndarjet për kreditorët e NSH-ve

Secila kërkesë kreditore e parashtruar kundër një NSH-je të veçantë paguhet vetëm nga fondet e gjeneruara nga likuidimi i aseteve të NSH-së përkatëse. Pagesa fillon pas miratimit nga Bordi¹³⁶.

Të gjitha pagesat për trajtimin e kërkesave kreditore do t'u nënshtrohen procedurave të vendosura nga Agjencia në pajtueshmëri me Politikën Financiare të AKP-së të lëshuara sipas nenit 15 dhe nenit 19 të Ligjit për AKP-në.

Sipas nenit 41 të Shtojcës së Ligjit, kërkesat dhe interesat trajtohen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë dhe radhës të përcaktuar me nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Trajtimi i kërkesave dhe interesave që i përkasin një kategorie pasuese të prioritetit më të ulët mund të iniciohen vetëm pas përmbushjes së plotë dhe të tërësishme të kërkesave të kategorisë së mëhershme të prioritetit më të lartë.

¹³⁵ Ligji i AKP-së, neni 19.3.4, neni 2.26 dhe neni 2.2.7

¹³⁶ Ligji i AKP-se Shtojca, Neni 41

Nëse resurset janë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e një kategorie të caktuar, duke përfshirë mbulimin për rezervimet e bëra nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo renditje, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë nga Bordi miratimin për shpërndarje të parakohshme për kreditorët¹³⁷.

Nëse resurset janë të pamjaftueshme për të përmbushur tërësisht të gjitha Kërkesat apo interesat e një kategorie apo niveli të caktuar, përfshirë mbulimin për rezervimet e Autoritetit të Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo niveli, Kërkesat e asaj kategorie apo niveli përmbushen në proporcion me shumën e çdo Kërkese, përfshirë kërkesat për të cilat Autoriteti i Likuidimit ka bërë rezervime, sic përcaktohet në nenin 41.4 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe në ndërlidhje me nenin 42 (Fondet e Rezervuara) të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Në rastet e shpërndarjeve të pjesshme sipas nenit 41.4 të Shtojcës së Ligjit, nëse ende ka ankesa në Dhomën e Posaçme, atëherë raporti i tillë konsiderohet "Raport për Shpërndarje të Përkohshme të Pjesshme për Kreditorët", ndërsa nëse nuk ka ankesa në Dhomën e Posaçme dhe nëse nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar të gjithë kreditorët e aprovuar, atëherë raporti i tillë konsiderohet "Raport Përfundimtar për Shpërndarje të Pjesshme për Kreditorët".

Në rast se më parë ka pasur shpërndarje për kreditorët (të kategorive më të larta siç është 40.1.4 deri 40.1.6 apo shpërndarje të pjesshme të ndonjë kategorie siç është p.sh. 40.1.6 apo 40.1.7) dhe përsëri përgatitet raport i shpërndarjes për kategoritë tjera (për shkak se janë shitur më shumë asete apo ka aktvendim të Dhomës së Posaçme për ankesat e kreditorëve), atëherë raporti i shpërndarjes duhet të përmbajë informata për shpërndarjet e mëparshme: shumat e shpërndara, kategoritë e kreditorëve të paguar dhe numrin e kreditorëve të paguar.

Secili raport i shpërndarjes për kreditorët duhet të përmbajë përmbledhjen (kategoria, shuma, numri i kreditorëve) e kreditorëve të propozuar për pagesë sipas kategorive të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit dhe listën e të gjithë kreditorëve të propozuar për pagesë.

Nuk duhet të bëhet asnjë shpërndarje derisa "Raporti i Rezultatit të Parashikuar" dhe "Analiza Përmbledhëse e Shpërndarjes" të tregojnë se a është e sigurt të veprohet në një mënyrë të tillë. Këto tregojnë nëse burimet e rasteve të likuidimit janë të mjaftueshme për të përmbushur plotësisht apo pjesërisht kategoritë e kërkesave kreditore.

12.8.Shpërndarja përfundimtare për kreditorët e NSH-ve

Me rastin e vendimit përfundimtar nga ana e DHPGJS-së në lidhje me ankesat e Kreditorëve të paraqitura në procedurën e Likuidimit, AL-ja përgatit Raportin e Rezultatit të Parashikuar në lidhje me fondet e mbetura dhe shpërndarjen për kreditorët si dhe shpenzimet e papaguara të AL-së deri në atë moment.

Në rast se mbesin të ardhura nga likuidimi i një NSH-je pasi të jenë zgjidhur të gjitha kërkesat/ankesat e kreditorëve, këto të ardhura transferohen në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës si Fonde të Mbetura të likuidimit¹³⁸.

¹³⁷ Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 41.3

¹³⁸ Ligji i AKP-së neni 2.2.6

Neni 13
PËRMBYLLJA E NSH-së NË LIKUIDIM

13.1. Raporti përfundimtar i përmbylljes së NSH-së në likuidim

1. Autoriteti i Likuidimit brenda 60 ditësh kalendarike pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë, (DHPGJS) nga Autoriteti i Likuidimit në pajtim me nenin 43 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në.
2. Raporti përfundimtar duhet të përmbaj informatat si në vijim:
 - 2.1. Përmbledhje të shkurtër të procedurave të likuidimit:
 - 2.1.1. Emri dhe adresa e NSH-së;
 - 2.1.2. Data e fillimit të likuidimit;
 - 2.1.3. Emërimi i Autoritetit të Likuidimit;
 - 2.1.4. Data e afatit të fundit për dorëzim të kërkesave kreditore;
 - 2.2. Shpenzimet e procedurave të likuidimit (sipas kategorive 1.1 deri 1.3 të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit);
 - 2.3. Lista e kërkesave kreditore të parashtruara brenda afatit ligjor, datat e njoftimeve për vendimet e AL-së;
 - 2.4. Lista e vendimeve të AL-së të ankimuara dhe vendimeve përfundimtare të Dhomës së Posaçme me përmbledhje të shumave për t'iu paguar kreditorëve dhe bartësve të interesit, nëse ka;
 - 2.5. Lista e të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera;
 - 2.6. Regjistrin e pronave të hequra dorë (sipas nenit 18.3 të Shtojcës së Ligjit);
 - 2.7. Regjistrin e pronave jashtë Kosovës të hequra dorë e që i janë transferuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në mirëbesim (sipas nenit 19.4 të Shtojcës së Ligjit);
 - 2.8. Pasqyra përmbledhëse financiare e llogarisë bankare në likuidim;
 - 2.9. Lista e pranimeve dhe pagesave nga llogaria bankare e NSH-së në likuidim;

2.10. Një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave kreditore valide të aprovuara/lejuara, duke shënuar në mënyrë të qartë shumat e shpërndara apo pronën e transferuar për përmbushjen e tërësishme apo të pjesshme të secilës kërkesë kreditore:

2.10.1. Raporti duhet të përmbajë informatën për llojin e pagesës për kreditorët, pagesë e tërësishme apo pagesë e pjesshme për shkak të mungesës së fondeve.

2.11. Lista e kërkesave kreditore të aprovuara/lejuara që nuk janë plotësuar tërësisht dhe që mund të jenë subjekt i shpërndarjes në të ardhmen në rast të realizimit të pasurive që mbahen në mirëbesim nga Republika e Kosovës (sipas nenit 19.4 të Shtojcës së Ligjit);

2.12. Shuma e fondeve të likuidimit të transferuara në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës para se të dorëzohet Raporti Përfundimtar në Gjykatë:

2.12.1. "Fondet tepricë" të likuidimit (sipas nenit 19.3.3 të Ligjit);

2.12.2. "Fondet e përkohshme" të likuidimit (sipas nenit 2.2.6 të Ligjit);

2.12.3. "Fondet e mbetura" të likuidimit (sipas nenit 2.2.7 të Ligjit).

2.13. Një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit të përdorimit të tyre.

Kërkesa Dhomës së Posaçme për aprovimin e përmbylljes së likuidimit për NSH-në përgatitet sipas formularit L29.

13.2. Veprimet pas dorëzimit të kërkesës në DHPGJS për mbyllje të NSH-së

DHPGJS pas pranimit të Raportit Përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit dhe parashtimit të kërkesës për përmbyllje, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh¹³⁹ nxjerr një urdhër të shkruar për mbylljen e procesit të likuidimit nëse është përmbushur ashtu që e gjithë prona dhe asetet e NSH-së janë likuiduar në atë masë që është arsyeshëm e praktikueshme dhe të gjitha fondet e realizuara të jenë paguar apo janë paguar në mënyrë substanciale.

Nëse DHPGJS e kundërshton Raportin Përfundimtar, atëherë AL përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në Gjykatë brenda 30 ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga DHPGJS-ja¹⁴⁰.

DHPGJS-ja shënon në çdo urdhër dispozitën për përmbylljen e procedurës së Likuidimit për lirim të AL ndaj ndonjë obligimi të mëtutjeshëm në lidhje me NSH-në dhe me procedurat e likuidimit.

¹³⁹ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.4

¹⁴⁰ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.3



Gjykata sipas detyrës zyrtare, pas shqyrtimit mund të kundërshtojë Raportin Përfundimtar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të dorëzimit. Nëse dërgohet njoftimi për kundërshtim, Autoriteti i Likuidimit përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në Gjykatë brenda tridhjetë (30) ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga Gjykata¹⁴¹.

13.3. Mbyllja e rastit të ekspedituar të likuidimit

Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, në çdo fazë të procedurës, nëse përcaktohet se të hyrat në fjalë janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e Kërkesave prioritare të përcaktuara në Ligjin e AKP-së Shtojca, neni 40, paragrafi 1, nënparagrafi (1), Gjykata nxjerr vendim për lejimin për mbylljen e rastit të likuidimit¹⁴².

Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, nëse asnjë kreditor nuk ka parashtruar kërkesë brenda afatit për parashtrimin e kërkesave, Gjykata nxjerr vendim për lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit¹⁴³.

Nëse NSH-ja në likuidim nuk ka asete të realizueshme, AL kërkon miratimin e Bordit për të parashtruar kërkesën në Gjykatë për aprovimin e mbylljes së rastit.

13.4. Njoftimi për mbylljen e NSH-së në likuidim

Pas mbylljes së rastit të likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojcës së Ligjit, ndërpritet ekzistimi i Ndërmarrjes dhe Agjencia (*Zyrtari i Rastit në emër të AL-së*) lëshon njoftim [formulari L31] me shkrim lidhur me këtë për Komunën përkatëse, gjykatat përkatëse, Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare, Regjistrin e Pengjeve të Kosovës, Regjistrin e Hipotekave në Kosovë, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, bankën(at) e ndërmarrjes, Administratën Tatimore, Ofruesit e Shërbimeve Publike në nivel Qendror dhe Lokal.¹⁴⁴

Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjensisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.¹⁴⁵

13.5. Pasojat e mbylljes së rastit

Mbyllja e likuidimit të NSH-së ndodh në datën kur Gjykata¹⁴⁶ aprovon raportin përfundimtar të AL dhe si pasojë:

- i) Nuk mund të zbatohen kërkesa kreditore apo të pronësisë kundër AKP-së apo aseteve që kanë qenë të NSH-së¹⁴⁷.

¹⁴¹ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.4

¹⁴² Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 44.2

¹⁴³ Ligji i AKP-së Shtojca Neni 44.3

¹⁴⁴ Neni 45 i Shtojcës së Ligjit.

¹⁴⁵ Neni 43.3 i Shtojcës së Ligjit.

¹⁴⁶ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 44.1

¹⁴⁷ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 47

MF

- ii) Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit lirohen nga detyrat apo përgjegjësitë tjera në lidhje me ndërmarrjen dhe procedurat e likuidimit¹⁴⁸;
- iii) Gjykata miraton pagesat përfundimtare të ndonjë shpenzimi të papaguar të Autoritetit të Likuidimit¹⁴⁹;
- iv) Pas shpërndarjes përfundimtare borxhet e mbetura dhe të papaguara të NSH-së shuhen me ligj dhe çdo veprim për të inkasuar borxhe të tilla të shuara ndalohen, përveç nëse Gjykata e urdhëron atë para mbylljes apo në urdhrin për mbylljen e rastit të likuidimit¹⁵⁰.

13.6. Veprime tjera pas mbylljes së rastit

Pas mbylljes së rastit të likuidimit, përveç njoftimeve publike të parapara me Shtojcën e Ligjit të AKP-së, veprimet e mëposhtme teknike ndërmirren nga Agjencia:

1. Departamenti i Financave dhe Buxhetit i AKP-së e dërgon te AL-ja raportin përfundimtar të pagesave (përmbledhjet dhe detajet e pagesave). Ky raport tregon edhe transferin e fundit (nëse ka pasur) të fondeve të mbetura të likuidimit për Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës dhe që gjendja e llogarisë bankare të likuidimit është zero euro (0 EUR). Ky raport duhet të integrohet në SML;

2. Kryesuesi i AL-së e azhurnon raportin përmbyllës financiar ku përfshihen të gjitha transferet, përfshirë transferet e fondeve të mbetura (nëse ka pasur);

3. Departamenti i Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve e aranzhon publikimin në faqen e internetit të AKP-së këto raporte:

3.1. Raporti përfundimtar për NSH-në e përmbyllur (siç është dorëzuar në Dhomën e Posacme);

3.2. Aktvendimin e Dhomës së Posacme për aprovimin e Raportit Përfundimtar dhe lejimin e mbylljes së NSH-së;

3.3. Raportin përmbledhës financiar.

4. Menaxhmenti e nënshkruan vendimin për shpërbërjen e AL-së.

Dokumentet e mësipërme duhet të vendosen në SML nga Zyrtari i Rastit.

¹⁴⁸ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 46.1.1

¹⁴⁹ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 46.1.2

¹⁵⁰ Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 47

Neni 14
INTERPRETIMI I RREGULLORES

Në të gjitha rastet kur kjo konsiderohet e nevojshme, të gjitha dispozitat, përkufizimet, kualifikimet dhe referencat përkatëse të kësaj Rregulloreje, interpretohen në kontekstin e përgjithshëm të Ligjit të Agjencisë dhe Shtojcës së Ligjit të Agjencisë.

Në çdo rast, pa e specifikuar posaçërisht, nëse autorizime të caktuara nga fushëveprimi i procedurave të likuidimit nuk janë rregulluar ose paraparë në masë të mjaftueshme në këtë rregullore ose krijojnë dilema eventuale të interpretimit, aplikohen dispozitat e Ligjit të Agjencisë dhe Shtojcës së Ligjit të Agjencisë dhe/ose qëndrimet e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë.

Neni 15
HYRJA NË FUQI

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Udhëzuesi i Likuidimit i datës 31 maj 2012 dhe Udhëzuesi për pagesën e tatimit në pronë për ndërmarrjet në likuidim i datës 31 mars 2017 dhe Rregullorja 04/2020.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 28 shtator 2023

Mentor Hyseni



Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Shtojca - Lista e formularëve standard të likuidimit

Nr.	Emri i formularit	Ref. në nenin e rregullores
L01	Dokumenti informues për Bordin	2.2
L02	Vendimi për emërimin e AL-së	3.3
L03	Ndërrimi i anëtarëve të AL	3.3; 3.4
L04	Zëvendësimi i përkohshëm i Kryesuesit të AL-së	3.3; 3.5.1
L05	Konflikt Interesi	3.7
L06	Njoftim Agjencisë për Regjistrimin e Biznesit	5.6; 5.7
L07	Ndërprerja e marrëdhënies së punës për punëtorët e NSH-së	5.5
L08	Njoftimi për fillimin e likuidimit në faqen e internetit të AKP-së	3.13.4
L09	Letër njoftuese bankës së NSH-së	5.7
L10	Letër kreditorëve të njohur (sipas informatave në Departamentin Ligjor të AKP-së) për fillimin e procesit të likuidimit	5.4
L11	Letër kreditorëve të njohur (sipas informatave nga Bilanci i Gjendjes së NSH-së) për fillimin e procesit të likuidimit	5.4
L12	Letër njoftuese për kreditorët	5.4
L13	Njoftimi për fillimin e likuidimit - njoftim për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes	5.2
L14	Dëshmia për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likudim - Dëshmia e Kërkesës	5.4
L15	Dëshmia për parashtrimin e kërkesës pronësore në likudim - Dëshmia e Interesit	5.4
L16	Letër të gjitha gjykatave të rregullta dhe Odës së Përmbaruesve të Kosovës - pezullimi sipas nenit 10 të Shtojcës	5.8
L17	Letër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme - pezullimi sipas nenit 10 të Shtojcës	5.7
L18	Kërkesë për arsyetimin e vonesës në parashtrimin e kërkesës	9.6.2
L19	Kërkesë për informata shtesë nga kreditori	9.2
L20	Vendimi për pranueshmëri të kërkesës	9.4
L21	Vendim për refuzimin e kërkesës	9.4
L22	Vendim për aprovim të pjesshëm të kërkesës	9.4
L23	Vendimi për pagat e papaguara	9.4
L24	Vendim për refuzim të kërkesës për paga të papaguara	9.4
L25	Vendim për pranueshmëri të pjesshme të kërkesës për paga të papaguara	9.4
L26	Letër Kreditorëve të Siguruar	9.4
L27	Letër Kreditorëve të Pasiguruar – pagesa e plotë	9.4
L28	Letër Kreditorëve të Pasiguruar – pagesa e pjesshme	9.4
L29	Kërkesa Dhomës së Posaçme për aprovimin e përmbylljes së likuidimit	13.1
L30	Letër për mungesë apo pamjaftueshmëri të fondeve	9.4
L31	Njoftim për përmbyllje të procesit të likuidimit (apo largimin nga kompetencat e AKP-së)	1.4; 13.4



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Dritan Hoxha, nr. 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 500 400, Fax: + 383 38 248 076, E-mail: info@pak-ks.org, ueb: www.pak-ks.org

PËR: Drejtorët e Bordit të AKP-së

DATE: [SHËNO DATËN E MBEDHJES SË BORDIT]

Emri i Ndërmarrjes: [SHËNO EMRIN E NDËRMARRJES, ME TË GJITHË EMRAT ALTERNATIV DHE NR. FI APO NR. TJETËR TË REGJISTRIMIT]

INFORMACIONE LIDHUR ME NDËRMARRJEN

Statusi i privatizimit Kjo ndërmarrje ka shitur [nuk ka shitur] [ka shitur disa] asete përmes spin-off-it
[NDRYSHO PËR TË REFLEKTUAR GJENDJEN AKTUALE]

Analizë e shkurtër statusore - Ndërmarrja: [SHËNO DETAJET E SHKURTËRA TË STATUSIT/HISTORIA E KPS]

Statusi i kësaj ndërmarrjeje ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së, Departamenti i Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes, dhe Departamenti Ligjor, dhe qëndrimi i tyre është se e njëjta bie nën administrimin e AKP-së sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-034 Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

APO,

Bordi i AKP-së e miratoi statusin e kësaj Ndërmarrjeje me rastin e tenderimit të saj me spin-off në [përfshij vetëm nëse ishte ndërmarrje e pas valës 1 dhe 2 d.m.th. statusi është miratuar pas nëntorit 2004]

Sektori/Baza e klientelës/Gama e produkteve: [SHËNO INFORMATËN]

Tregu/Konkurrenca/Perspektiva ekonomike: [SHËNO INFORMATËN]

Fuqia punëtore – madhësia/detajet tjera relevante: [SHËNO INFORMATËN]

Lokacioni(et): [SHËNO KOMUNËN, RAJONIN, ZONËN KADASTRALE]

Toka dhe ndërtesat: [SHËNO INFORMATËN]

Asetet tjera kyçe: [SHËNO INFORMATËN]

Informacioni financiar: [SHËNO INFORMATËN]

Çështjet kadastrale: [SHËNO INFORMATËN]

Kontratat mbi qiranë: [SHËNO INFORMATËN]

Sigurimi: [SHËNO INFORMATËN]

Çështje tjera që ndikojnë ndërmarrjen: [SHËNO INFORMATËN]

PROPOZIMI PËR LIKUIDIM

Arsyetimi: [SHËNO ARSYETIMIN/DOBINË DHE INTERESIN PUBLIK/TË TJERA]

Propozim: Likuidimi

Obligimet dhe kërkesat: Obligimet dhe kërkesat vijuese janë të njohura deri në datën e shkrimit të këtij raporti përmbledhës, ndërsa pjesa tjetër është vlerësuar. Kërkesat plotësuese është e mundur të parashtrihen pas shpalljes.

[Detyrimet janë kosto direkte (telefoni/tatimi/pagat) që tanimë dihen apo janë parashikuar. Nëse ka borxh për shkak të bankës ose kreditorit që është siguruar, tregoje këtë në një kolon tjetër]

Obligimet €	
Të njohura	Të parashikuara
€0	€0

[Ankesat janë për kostot indirekte siç janë dëmet/kompensimet (p.sh. për pagesën pas largimit të padrejtë nga puna, pronësia e aseteve ose NSh-së, etj.) dhe kur madhësia e ankesës mund të jetë e njohur, vlefshmëria e saj mund të vihet në dyshim. Në përgjithësi përfshini në një rresht përveç nëse ka diçka të veçantë dhe që vlen të paraqitet ndaras]

Kërkesat €			
Të siguruara €		Të pasiguruara €	
Të njohura	Të parashikuara	Të njohura	Të parashikuara
€0	€0	€0	€0

Autoriteti i Likuidimit: Është kërkuar që Drejtori Ekzekutiv të autorizohet që të emërojë anëtarët përkatës (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm)

Komisioni këshillëdhënës : Nuk kërkohet

Mënyra e shitjes: Ankand me oferta të mbyllura.

Depozita e Ofertës Rekomandim: Depozita e ofertës prej €[] për [tokë] apo [nuk rekomandohet depozitë oferte për]

Buxheti i vlerësuar:.....€

Detajet e buxhetit:

Kjo do të azhurnohet/ndryshohet me miratimin e personelit relevant të

Financave të AKP-së

Kodet	Përshkrimi	Shuma
e2	Shpenzimet e Publikimit për caktimin e Likuidimit, kreditorët, etj.	
e2	Shpenzimet e Publikimit të shitjes së aseteve.	
e3	Shpenzimet e tjera të shitjeve me Likuidim (p.sh marrja me qira e sallës për hapjen e ofertave).	
e4	Material për Zyre, tarifa postare.	
e5	Ruajtjen, transportimin e të dhënave të NSh (përfshirë kostot a arkivit)	
e6	Shpenzimet tjera të vogla të likuidimit (para të imta) (këshillë – të jetë së paku 5% e totalit të shpenzimeve të tjera)	
e7	Shpenzimet Gjyqësore	
e8+e9	Ofruesit e Shërbimeve të punësuar për analizimin e ankesave, të dhënave (regjistrimi i, lëvizja e), dhe aktiviteteve të ngjashme. (Shënim: Në qoftë se përdoret ose për "Mirëmbajtja e Aseteve" (e13) ose "Mbrotjen e Aseteve" (e14), atëherë shpenzimet e ofruesve të shërbimeve duhet të regjistrohen nën këto kode alternative)	
e12	Tarifat Profesionale (Avokatët, Ekspertiza Financiare, Shqyrtimin e Ankesave, Ekspert të tjerë)	
e13	Mirëmbajtja e aseteve - Shpenzimet që paraqiten për riparimin ose ruajtjen e aseteve që do të realizohen në të ardhmen (p.sh shembjen apo riparimin e ndërtesave të rrezikshme). Ku kjo përfshinë përdorimin e ofrueseve të shërbimeve, përfshijë shpenzimet për ofruesit e shërbimeve këtu dhe jo në (e8 + e9).	
e14	Mbrojtja e pronës dhe aseteve - Shpenzimet që paraqiten për sigurim ose ruajtje të ngjashme të aseteve që do të realizohen në të ardhmen. Ku kjo përfshinë përdorimin e ofrueseve të shërbimeve, përfshijë shpenzimet për ofruesit e shërbimeve këtu dhe jo në (e8 + e9).	
e15+e16	Qiraja e Pagueshme (p.sh kur epen zyrat me qira, në likuidim)	
e17	Mallrat e Blera (për qëllime të likuidimit p.sh mobile dhe pajisje të nevojshme për zyrën e themeluar për nevojat e ofruesve të shërbimeve për të punuar në çështjet e likuidimit)	
e18	Shërbime të tjera (jo profesionale) të nevojshme për likuidim.	
e19	Uji (shpenzimet që lidhen me pronat e zëna nga ndërmarrjet dhe të përdorura për likuidim - jo për furnizim të pronave të zëna nga banues ose okupues të paligjshëm)	
e20	Rryma (si për ujë)	
e21	Mbeturinat (si për ujë)	
e22	Telekomunikacioni, përfshirë interneti (si për ujë)	

e25	Tatimi Komunal në Pronë (përfshijë një dispozitë për taksë për 1 vit mbi të gjitha asetet e pronës përveç nëse detyrimi i është caktuar ndonjë qiramarrësi me një kontratë qiraje).	
	TOTALI	

REKOMANDIMET PËR NDARJEN E FONDEVE

- Statusi i transformimit: **[vendos kategorinë – shiko emrat me poshtë]**
- Çështje të zhdëmtimit që potencialisht ndikojnë në analizën e ndarjes së fondeve

Analiza financiare

Analiza e Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve dhe Zyrave Rajonale, bazuar vetëm në informacionet që kemi në dispozicion gjerë në këtë moment, tregon se [është e mundshme] [nuk është e mundshme] që do të ketë tepricë nga të ardhurat pas pagimit të kreditorëve.

[SHËNO KATEGORINË]

Lënde "pa transformim"

Transformimet "Masat e përkohshme"

"Gjakova" dhe transformimet e ngjashme.

Masat e tjera të jo-përkohshme/transformimet e jo-përkohshme të trupit

SHTOJÇË [sa për informatë të autorit të raportit për Bordin – JO PËR PËRFSHIRJEN NË RAPORTIN E BORDIT]

Lloji 1: Rastet "Pa transformim": ku nuk janë gjetur dëshmi se entiteti ka qenë ndonjëherë i transformuar.

Lloji 2: Transformimet me "Masa të përkohshme": ku entiteti relevant duket të jetë transformuar gjatë viteve të 90-ta me vendimin e Organit të Përkohshëm në pajtim me Ligjin për veprim në Kushtet e Posaçme (1990) ("Ligji mbi masat e përkohshme") (ku mund të ketë apo të mos ketë dëshmi tjetër të diskriminimit). Duhet të theksohet se derisa AKP-ja nuk ka garanci se gjykata mund ta konsiderojë diskriminues transformimin bazuar thjesht vetëm në ekzistimin e Masave të përkohshme (ende nuk ka vendim të Dhomës së Veçantë përkitazi me ndonjë lëndë të tillë, ndonëse lëndë të tilla ekzistojnë në Gjykatë), AKP-ja beson se është një argument bindës me efekt që transformimet në pajtim me vendimin e Organit të përkohshëm të mos pranohen për qëllime të identifikimit të pronarëve.

Lloji 3: "Gjakova dhe transformimet e ngjashme": aty ku entiteti relevant duket të jetë transformuar sipas ligjeve të RFJ-së (për dallim nga Ligjet e Serbisë) pa përdorimin e "Ligjit mbi Masat e Përkohshme" (dhe persona të caktuar pretendojnë/nuk pretendojnë të kenë aksione në ndërmarrjen e transformuar) dhe ku në shumë raste të tilla udhëheqja ishte shqiptare dhe aksionet në raste të caktuara u ishin dhënë si punëtorëve shqiptarë ashtu edhe atyre serbë. Kjo ka qenë tipike në rastin e Gjakovës. Ka argumente se transformimet e tilla janë jo-valide, por AKP-ja në përgjithësi nuk ka dokumente të mjaftueshme mbështetëse apo argumente të mjaftueshme ligjore bindëse për të konkluduar se transformimet e tilla

duhen apo nuk duhen të pranohen – prandaj, në masën sa këto lëndë parashtrihen para gjykatës, gjasat për argumentim të suksesshëm të asaj se transformimet e tilla nuk duhet pranuar janë qenësisht më të vogla se sa në rastet nga Lloji 2 më lartë.

Lloji 4: Transformimet pa masa të përkohshme/pa organe të përkohshme: aty ku entiteti relevant duket të jetë transformuar në vitet e 90-ta (apo në të vërtetë pas -1999), por pa përdorimin e Ligjit mbi masat e përkohshme ose të Organit të përkohshëm, edhe pse në shumicën e rasteve sipas ligjeve transformuese të Serbisë. Përderisa mund të ekzistojnë disa argumente të shkallëve të ndryshme të bindshmërisë (dhe varësisht nga faktet specifike të rastit) përkitazi me ekzistimin e diskriminimit apo që ndikojnë se transformimi ishte implementuar në mënyrë jo-valide, (siç është moszbatimi i dispozitave në fuqi për transformim të korporatës) AKP-ja në përgjithësi nuk ka pranuar dokumente të mjaftueshme mbështetëse apo argumente të mjaftueshme ligjore që do t'i mundësonin që të vendosë në cilëndo mënyrë se a duhet pranuar transformimin. AKP-ja nuk është e gatshme që, për shembull, të hedhë poshtë një transformim për një shkelje formale të procedurës në transaksionin i cili ka ndodhur 10 apo më tepër vite më parë. Prandaj, në masën sa këto lëndë shtrohen para gjykatës, gjasat për argumentim të suksesshëm se transformimet nuk duhet pranuar janë tejet të vështira të përcaktohen, por me gjasë janë më të vogla se në Llojin 2 më lartë.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Dritan Hoxha, nr. 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 500 400, Fax: + 383 38 248 076, e-mail: info@pak-ks.org, ueb: www.pak-ks.org

VENDIM

për

Emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit

sipas nenit 13.1 dhe 13.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034,
ndryshuar me nenin 19 të Ligjit nr. 06/L-023

Emri i ndërmarrjes: _____

Duke u bazuar në nenin 5 dhe nenin 9 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) si dhe nenin 12 të Shtojcës së këtij Ligji, sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për fillimin e procedurës së likuidimit për ndërmarrjen e lartpërmendur, kjo ndërmarrje është vendosur në likuidim më datë _____.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, bazuar në autoritetin e dhënë sipas nenit 11.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas nenit 13 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me rastin e vendosjes së ndërmarrjes në likuidim e ka autorizuar Menaxhmentin e AKP-së që të emëroj anëtarët e Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore të lartpërmendur (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm të tyre). Sipas nenit 3 paragrafi 1.15 të Ligjit të AKP-së, Menaxhmenti i AKP-së nënkupton Drejtorin Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtorët Ekzekutiv të AKP-së kolektivisht dhe individualisht.

Me këtë vendim, personat në vijim emërohen zyrtarisht nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, anëtarë të Autoritetit të Likuidimit me të gjitha autorizimet e përcaktuara sipas Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 04/L-115.

Personat në vijim emërohen në Autoritetin e Likuidimit:

- _____, Kryesues (personel i OSHP-së);
- _____, Anëtar (personel i OSHP-së);
- _____, Anëtar - Zyrtar i Rastit (personel i AKP-së).

Ky Vendim për emërimin e anëtarëve të AL-së hyn në fuqi më _____ dhe vlen deri më _____.

Sheno emrin

Drejtore Ekzekutive
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Kërkesë për ndërrim të anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit

PËR: Sheno emrin , Drejtor Ekzekutiv
PËRMES: Sheno emrin , Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativa
PREJ: Sheno emrin , Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve
DATA: 03/06/2019
EMRI I NDËRMARRJES: MIT005 KB Klina

Ndryshimet në vijim janë të kërkuara për anëtarët e Autoritetit të Likuidimit:

EMRI	TITULLI	FUNKSIONI BRENDA AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT	DETAJET E KONTAKTIT
LARGO PERSONIN NË VIJIM			
SHENO EMRIN		Kryesues i AL-së apo Anëtar i AL-së	EMAIL ADRESA @pak-ks.org
EMËRO PERSONIN NË VIJIM			
SHENO EMRIN		Kryesues i AL-së apo Anëtar i AL-së	EMAIL ADRESA @pak-ks.org
<u>ARSYEJA PËR NDRYSHIM</u>			
Sheno arsytet e ndërrimit			

DËRGUAR NGA:	Data: Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve
PËRMES:	Data: Zëvendës Drejtor Ekzekutiv - Operativa
APROVUAR NGA:	Data: Drejtor Ekzekutiv - Agjencia Kosovare e Privatizimit



dd mmm yyyy

AUTORIZIM PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM TË KRYESUESIT TË AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT

Në mënyrë që të vazhdohet me punën për NSh-të në likuidim, emërohet një anëtar i Autoritetit të Likuidimit ("i Emëruari") për të shërbyer si zëvendësimit i përkohshëm i Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit në vend të z./znj. _____ i cili ka dhënë njoftimin ("Njoftimi për mungesë të përkohshme") për Autoritetin e Likuidimit, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe për të Emëruarin se nuk do të jetë në dispozicion ose është në pamundësi që të jetë fizikisht i pranishëm përkohësisht për një periudhë të caktuar kohore ("Periudha e Zëvendësimit").

Periudha e Zëvendësimit do të mbulojë ditët vijuese të punës: nga _____ deri më _____.

Prandaj, në bazë të asaj që u tha më lart, z./znj. _____, anëtar i Autoritetit të Likuidimit (personel i OShP-së), emërohet si Kryesues i AL-së për Periudhën e Zëvendësimit, në mënyrë që të ushtroj të gjitha kompetencat dhe autoritetin në cilësi të Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit gjatë Periudhës së Zëvendësimit, në përputhje me Ligjin e AKP-së dhe Shtojcën e Ligjit të AKP-së.

Autorizimi bartet nga: [shëno emrin dhe mbiemrin] Kryesues i Autoritetit të Likuidimit	Autorizimi pranohet nga: [shëno emrin dhe mbiemrin] Anëtar i Autoritetit të Likuidimit
---	---

Shqyrtuar nga: [shëno emrin dhe mbiemrin] Zëvendës Drejtor Ekzekutiv– Operativa Agjencia Kosovare e Privatizimit	Miraturar nga: [shëno emrin dhe mbiemrin] Drejtor Ekzekutiv Agjencia Kosovare e Privatizimit
--	--

Origjinali i autorizimit mbahet në Departamentin e Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve

Ndërsa kopja e autorizimit dorëzohet nga një kopje për:

1. Drejtorin Ekzekutiv;
2. Zëvendës Drejtorin Ekzekutiv– Operativa;
3. Autorizuesin;
4. Personin e Autorizuar;
5. Departamentin e Financave dhe Buxhetit.



KONFLIKTI I INTERESIT DHE RREGULLAT E NDËRLIDHURA PËR AUTORITETET E LIKUIDIMIT TË NSh-ve PËRKATËSE

Hyrje

Likuidimi është proces ligjor dhe financiar i mirënjohur dhe i pranuar anembanë botës. Zakonisht, ai mbikëqyret nga profesionistët e licencuar të likuidimit. Sipas ligjit të AKP-së, AKP-ja ngarkohet që ta zbatojë këtë detyrë në përputhje me ligjin e aplikueshëm. Në procedurën e likuidimit anembanë botës, likuiduesit kanë obligime të caktuara profesionale dhe u detyrohen me detyrime mirëbesimi përfituesve të likuidimit (pronarëve/kreditorëve) dhe, në raste të caktuara, edhe vetë entitetit në likuidim. Prandaj AKP-ja duhet t'i zbatojë likuidimet në përputhje me këtë parim.

Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit duhet t'i kenë parasysh standardet e aplikueshme në Kosovë si dhe ligjin e aplikueshëm, duke përfshirë, në veçanti, parimin për të mos diskriminuar ndonjë grup etnik.

Marrëveshjet e fshehta dhe mashtrimet

Për shkak të rrethanave në Kosovë, duke përfshirë faktin se dokumentet, dosjet dhe dëshmitarët në shumë raste mungojnë, pretendimet janë shpesh herë të vjetra, ekzistojnë lidhje të forta familjare/rajonale dhe ligji komercial nuk është aspak i zhvilluar apo i qartë sa duhet, prandaj ka mjaft hapësirë për marrëveshje të fshehta, mashtrime dhe shkelje të parimeve të përgjithshme të përvijuara më sipër. Zyrtarëve të AKP-së i bëhet me dije këtu se çdo lloj marrëveshjeje e fshehtë mund të konsiderohet shkelje të kontratës së punësimit të zyrtarit të AKP-së me AKP-në (ose në rastin e konsulentit, shkelje të kontratës së atij konsulenti) si dhe e detyrimeve ndaj Autoritetit të Likuidimit. Nëse kuptohet se keni bërë marrëveshje të fshehta, ose keni bërë mashtrime a veprime të ngjashme, do të ndërmerren masat përkatëse, duke përfshirë pushimin e mundshëm të kontratës suaj të punësimit, si dhe, varësisht nga rrethanat, inicimin e ndonjë procedure ndaj jush duke përfshirë edhe atë penale.

Konflikti i interesave

Përveç çështjeve të marrëveshjeve të fshehta, të mashtrimeve e të veprimeve të ngjashme, është po ashtu më rëndësi që zyrtarët e Autoriteteve të Likuidimit të mos ushtrojnë detyra aty ku ka konflikte interesash dhe konflikti i interesave të deklarohet, para se ata të fillojnë me punë në atë Autoritet të Likuidimit.

Nuk ka asgjë të keqe, që të ketë ndonjë konflikt interesi ose marrëdhënie me një pretendues, kreditues, pronar etj. – me rëndësi është që konflikti të kuptohet nga anëtarë i AL-së dhe të deklarohet. Pastaj i takon Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit ose Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së të sigurojë se ky konflikt i interesave nuk ju vë ju, Autoritetin e Likuidimit, procesin e likuidimit ose edhe AKP-në në pozitë të vështirë. Përdorësi i keni deklaruar faktet e lidhura me një konflikt të mundshëm të interesit, nuk duhet të shqetësoheni. Në këtë prizëm, anëtarë i AL-së duhet t'ia shpalojë përsëri Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit çështjet të cilat ndodhen në Formularin e Shpalimit të Interesave tashmë të dorëzuar nga anëtarë i AL-së si dhe të gjitha çështjet e reja të cilat nuk janë të

mbuluara nga ai formular. Shpalimi në një Formular të fundmë të Shpalimit të Interesave nuk është shpalim i mjaftueshëm për këto qëllime.

Në rast paqartësie, anëtarët e Autoritetit të Likuidimit duhet të kërkojnë udhëzime nga Menaxhmenti i AKP-së. Askush nuk mund t'ju fajësojë nëse jeni tepër i kujdesshëm, por nëse kuptohet se keni fshehur informata që çojnë në konflikt interesash, kjo mund të ketë pasoja shumë serioze.

Neni 1. Konflikti i interesave, dhuratat

- 1.1 Anëtarët e emëruar të Autoritetit të Likuidimit për një Ndërmarrje ("Anëtarët") veprojnë vetëm e vetëm në të mirën e interesave të pretenduesve të vlefshëm, kreditorët dhe pronarët si tërësi që mund të kenë të drejtën për të realizojnë pretendimet nga procedurat e likuidimit ("Përfituesit") dhe në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe çdo lloj vendimi të vlefshëm gjyqësor, duke e përfshirë ndjekjen e çdo lloj udhëzimi ndaj vendimit të ligjit të aplikueshëm/gjykatës të dalë nga Departamenti Ligjor i AKP-së.

Anëtarët nuk duhet të ndjekin (drejtpërdrejt apo tërthorazi) a të përpiqen të ndjekin kurrfarë interesi personal ose të veprojnë për të përfituar (drejtpërdrejt apo tërthorazi) çfarëdo përfitimesh financiare a të tjera për veten e tyre, për pjesëtarët e familjes së tyre të ngushtë, për shokët, ose personat e tjerë të lidhur me ta.

Termi "pjesëtarët e ngushtë të familjes" nënkupton:

- (i) babai i anëtarit;
- (ii) nëna e anëtarit;
- (iii) prindërit e (i) dhe të (ii); si dhe
- (iv) çfarëdo pasardhësi të (i), (ii) dhe (iii),
- (v) bashkëshortët e (iv) dhe prindërit e tyre, gjyshërit dhe pasardhësit.

Anëtarët nuk mund të përdorin (drejtpërdrejt a tërthorazi) zyrën e tyre ose postin në Autoritetin e Likuidimit për përfitime (drejtpërdrejt a tërthorazi) të cilindo person ose grupim që nuk është përfituesi.

Anëtarët nuk marrin udhëzime nga asnjë grupim tjetër përveç gjykatës së vlefshme, duke e përfshirë kushtin (por pa u kufizuar në të) që të MOS marrin udhëzime nga:

- Ministrinë e Qeverisë, Departamentet e Qeverisë ose Komunitat;
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Palët e treta.

- 1.2 Anëtarët nuk duhet të vënë veten e tyre nën kurrfarë obligimesh financiare apo të tjera, ose detyrime ndaj individëve a organizatave të jashtme që mund të konsiderohen si me ndikim ndaj tyre në ushtrimin e detyrave zyrtare brenda Autoritetit të Likuidimit dhe AKP-së.
- 1.3 Anëtarëve u ndalohet të ndërmarrin veprime që bien ndesh me interesat e përfituesit dhe të AKP-së. Ky ndalim shtrihet përtej detyrimeve afariste të këtyre anëtarëve.
- 1.4 Anëtarëve u ndalohet të kërkojnë, të pranojnë ose të marrin dhurata ose çfarëdo përfitimesh të tjera për vete ose për ndonjë palë të tretë, nëse kjo në çfarëdo mënyre mund të shihet si diçka që bie ndesh me veprimet e tyre në raport me Autoritetin e Likuidimit dhe procesin e Likuidimit. Termi "*dhuratë*" përfshin jo vetëm shuma parash, por edhe përfitimet e tjera. Këto përfitime të tjera mund të jenë, por pa u kufizuar në to, oferta për punë, ndonjë pushim i paguar, falja e ndonjë borxhi etj.
- 1.5 Ju lutemi ta keni parasysh se perceptimi i transparencës në proces është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë transparenca në proces.

Neni 2. Shpalimi i konfliktit të interesave

- 2.1 Mendohet se ka konflikt interesash me procesin e likuidimit si dhe me vetë përfituesit ai anëtar i cili e ka një pjesëtar të familjes së ngushtë që është pretendues ndaj një Ndërmarrjeje, ose ndaj aseteve të saj, ose ka interes material a financiar ndaj Ndërmarrjes, ose vendos që të përfitojë ndonjë interes material prej saj ose i ka borxh ndonjë detyrim mirëbesimi ndonjë grupimi tjetër që lidhet me Ndërmarrjen ose asetet e saj, duke përfshirë por pa u kufizuar në çdo lloj pretenduesi ndaj Ndërmarrjes ose aseteve të ndërlidhura të saj (qofshin këta pretendues kreditorë ose punonjës ose pretendues të pronësisë);

Konflikti i Interesave më tej mendohet se ekziston nëse pjesëtari i familjes së ngushtë të një anëtari:

- Mban (drejtpërdrejt apo tërthorazi) ose ka të drejtën për të marrë *aksione ose interesa tjera pronësore* për cilindo pretendues ose cilindo nga përfituesit individualë;
- Ka ose i është besuar çfarëdo lloj oferte jozyrtare për ndonjë punë me pagesë ose përfiton *pagesa ose mbështetje tjetër financiare* nga një ose më shumë pretendues ose një a më shumë përfitues individual.

Anëtari i cili i plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen do të quhet "**Anëtar që ka Konflikt**".

- 2.2 Për qëllime të shpalimit të konfliktit, Anëtari që ka Konflikt i deklaron Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit me shkrim (që mund të jetë duke dhënë informacione të mëtejshme/dorëzuar një kopje të Shpalimit të Interesave) të gjitha faktet që çojnë në konflikt interesash kurdo që ai të paraqitet, duke i dhënë hollësitë që i mundësojnë Kryetarit të marrë një vendim të informuar lidhur me atë nëse anëtari me Konflikt është me të vërtetë anëtar që ka Konflikt siç është përcaktuar në nenin 2.1 si dhe çfarë hapash duhen ndërmarrë në raport me konfliktin. Në këtë prizëm, anëtari i AL-së duhet t'ia shpalojë përsëri Kryesuesit të Autoritetit të Likuidimit çështjet të cilat gjenden në formularin e Shpalimit të Interesave të cilin tashmë e ka dorëzuar si dhe të gjitha çështjeve të reja që nuk mbulohen në atë formular. Shpalimi në një formular të paradokohshëm të Shpalimit të Interesave nuk është shpalim i mjaftueshëm për këto qëllime.
- 2.3 Çdo Anëtar që ka Konflikt, para se të emërohet, ia dorëzon Kryetarit të Autoritetit të Likuidimit një listë të çështjeve ose të marrëdhënieve afariste të Ndërmarrjes ku ekzistojnë

konflikte interesash ose ku ato mund të shfaqen, duke i përcaktuar hollësitë e interesit në atë listë. Më pastaj, Anëtari që ka Konflikt ia bën të ditur menjëherë Kryesuesit çdo lloj konflikti interesash që mund të shfaqen gjatë kohës që shërben si anëtar.

- 2.4 Anëtari që ka Konflikt i identifikon çështjet në listën e pretenduesve ose të aseteve, ku mund të shfaqet konflikti i interesave. Pasi t'i ketë shpaluar konfliktet e mundshme të interesave, Kryesuesi merr një vendim se si t'i adresojë ato. Kjo do të varet nga faktet në fjalë. p.sh. nëse një anëtar që ka konflikt ka ndonjë lidhje me pretenduesin, mund të vendoset që ai të mos luajë kurrfarë roli në vlerësimin e atij pretendimi, dhe i njëjti pretendim vlerësohet nga anëtarët e tjerë të Autoritetit të Likuidimit. Nëse konflikti i interesave i anëtarit të Autoritetit të Likuidimit është se ai është pretendues pronësie për një Ndërmarrje, për shembull, i njëjti nuk do të lejohet fare që të marrë pjesë në Autoritetin e Likuidimit.
- 2.5 Anëtarët duhet të parashtrojnë çdo lloj shkeljeje të rregullave të konfliktit të interesave para Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së.

Neni 3. Konfidencialiteti

Anëtarët janë të obliguar ta mbajnë konfidencialitetin e plotë lidhur me të gjitha informatat që i marrin gjatë veprimtarive të tyre duke i përfshirë këtu diskutimet e brendshme të Autoritetit të Likuidimit. Kjo nuk i pengon shpalimet e urdhëruara nga ndonjë gjykatë ose që kërkohen me ligj (për shembull, aty ku autoritetet e hetimeve financiare kanë fuqinë të urdhërojnë që t'u shërbehen informatat e tilla).

Neni 4. Diskualifikimi i Anëtarëve

Kryesuesi i Autoritetit të Likuidimit (dhe në fund Drejtori Ekzekutiv i AKP-së) mbasi të ketë marrë këshilla ligjore, vendos nëse ndonjë interes konfliktuoz, ose shkelja e Neneve 1.1 deri në 1.4, si dhe 2.1, ose 3 e diskualifikon një anëtar nga shërbimi i tij në Autoritetin e Likuidimit. Anëtari pezullohet (suspendohet) nga Autoriteti i Likuidimit derisa Kryesuesi i Bordit të AKP-së ose Drejtori Ekzekutiv i AKP-së të kenë marrë vendimin e tillë.

Neni 5. Publiciteti

- 5.1 Në asnjë rrethanë anëtari i Autoritetit të Likuidimit nuk mund t'u japë shtypit informata ose intervista pa autorizim me shkrim paraprak të Bordit të AKP-së.

Neni 6. Dokumentet dhe Procesverbalet

Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit duhet të garantojnë sigurinë e të gjitha dosjeve dhe dokumenteve të lidhura me pretendimin. Çdo përpjekje për t'i shkatërruar a fshehur informatat e dhëna nga një palë e tretë, duke i përfshirë këtu pretenduesit por pa u kufizuar në ta, do të trajtohet si sjellje e papërshtatshme e personelit që do të çojë në marrjen e masave disiplinore ose edhe ndjekje penale.

Për më tej, me qëllim të mbrojtjes së AKP-së dhe të vetvetes për sjellje të papërshtatshme ose shkelje të ligjit, Autoriteti i Likuidimit mban procesverbale të plota të çdo takimi zyrtar lidhur me të gjitha vendimet si dhe dosjet e të gjitha korrespondencave dhe diskutimeve me pretenduesit, palët e treta si dhe zyrtarët e dikurshëm ose aktualë të Ndërmarrjes.

Neni 7. Ndryshimet dhe interpretimet

Këto rregulla mund të ndryshohen nga Menaxhmenti i AKP-së duke e lëshuar një vendim me shkrim.

Udhëzimet për interpretim do të ofrohen nga Departamenti Ligjor i AKP-së.

Deklaratë

I kam lexuar dhe i kam kuptuar rregullat e përcaktuara më sipër dhe e kam kompletuar deklaratën shoqëruese.

Nënshkrimi: _____

Datë: _____

Emri dhe mbiemri (me shkronja të mëdha): _____